

# ANALIZA E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË 2021-2025

## SHKURTIME

BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
CAMS	Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të Shërbimit të Prokurorisë Shqiptare
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GjK	Gjykata Kushtetuese
GJKKO	Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
GjL	Gjykata e Lartë
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
IPSIS	Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar
IT	Teknologjia e informacionit
KE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
KPrC	Kodi i Procedurës Civile
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PP	Prokuroria e Përgjithshme
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SND	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPAK	Struktura e Posaçme Anti Korrupsion

<b>HYRJE .....</b>	<b>4</b>
<b>ANALIZA E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË 2021-2025 (SND II).....</b>	<b>5</b>
<b>Qëllimi i Politikës 1.....</b>	<b>5</b>
<b>Objektivi specifik 1.2.....</b>	<b>7</b>
Rezultati 1.2.1 .....	8
Rezultati 1.2.2 .....	11
Rezultati 1.2.3 .....	13
<b>Objektivi Specifik 1.3 .....</b>	<b>16</b>
Rezultati 1.3.1 .....	18
Rezultati 1.3.2 .....	19
Rezultati 1.3.3 .....	22
<b>Qëllimi i Politikës 2.....</b>	<b>266</b>
<b>Objektivi specifik 2.1.....</b>	<b>27</b>
Rezultati 2.1.1 .....	28
Rezultati 2.1.2 .....	34
<b>Objektiv specifik 2.3 .....</b>	<b>35</b>
Rezultati 2.3.1 .....	355
Rezultati 2.3.2 .....	388
<b>Objektiv Specifik 2.4.....</b>	<b>40</b>
Rezultati 2.4.1 .....	42
Rezultati 2.4.5.....	45
<b>Objektivi specifik 2.5.....</b>	<b>48</b>
Rezultati 2.5.1 .....	50
<b>Qëllimi i Politikës 3.....</b>	<b>51</b>
<b>Objektivi specifik 3.2.....</b>	<b>53</b>
Rezultati 3.2.1 .....	53
Rezultati 3.2.2 .....	55
Rezultati 3.2.3 .....	5656
Rezultati 3.2.4 .....	58
<b>Qëllimi i Politikës 4.....</b>	<b>59</b>
<b>Objektivi Specifik 4.1 .....</b>	<b>60</b>
Rezultati 4.1.1 .....	62
Rezultati 4.1.2 .....	63
Rezultati 4.1.5.....	66
<b>Objektiv Specifik 4.4.....</b>	<b>67</b>
Rezultati 4.4.4.....	68
<b>ANALIZA E INDIKATORËVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË SND II.....</b>	<b>69</b>
<b>Rëndësia e indikatorëve të parashikuar për SND II .....</b>	<b>70</b>
<b>Analiza e indikatorëve.....</b>	<b>69</b>
Indikator 1.....	70
Indikator 2.....	70
Indikator 3.....	70
Indikator 4.....	71
Indikator 5.....	72
Indikator 6.....	72
Indikator 7.....	73

<b>Indikatori 8</b> .....	74
<b>Indikatori 9</b> .....	74
<b>Indikatori 12</b> .....	75
<b>Indikatori 13</b> .....	76
<b>Indikatori 14</b> .....	77
<b>Indikatori 15</b> .....	78
<b>Indikatori 16</b> .....	79
<b>Indikatori 17</b> .....	80
<b>Indikatori 20</b> .....	80
<b>Indikatori 24</b> .....	81
<b>Indikatori 25</b> .....	82
<b>Indikatori 26</b> .....	82

<b><i>LISTA E REFERENCAVE</i></b> .....	<b>83</b>
---	-----------

## HYRJE

Analiza e Planit të Masave të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 është realizuar në kuadër të projektit “Me Sytënga Drejtësia”, financuar nga programi MATRA i Ambasadës Hollandeze në Shqipëri dhe zbatuar nga Instituti për Studime Publike e Ligjore (ISPL). Projekti përfshin periudhën 2020-2022, periudhë gjatë së cilës u hartua Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025 (SND II) dhe fillon zbatimi i saj pesë-vjeçar.

SND II është vazhdim i SND I dhe zhvillohet e i përgjigjet nevojave të reformës në drejtësi, e konsideruar tashmë nga të gjithë aktorët kombëtarë e ndërkombëtarë si reforma më e rëndësishme aktualisht në Shqipëri. Ecuria dhe rezultatet e kësaj reforme kushtëzojnë në një masë të konsiderueshme procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. E udhëhequr dhe koordinuar nga Ministria e Drejtësisë dhe e mbështetur nga programi Euralius i BE-së, Strategjia Ndër-sektoriale e Drejtësisë 2021-2025, është fryt i një bashkëpunimi mes gjithë institucioneve aktuale të sistemit të drejtësisë, si dhe i një procesi konsultimi me aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë e anatarë të shoqërisë civile shqiptare. Ky dokument strategjik bëhet i zbatueshëm në mënyrë më konkrete përmes një Plani Veprimi të integruar dhe një baterie indikatorësh që do të mundësojnë monitorimin e vlerësimin e zbatimit të tij.

Në këtë kontekst, Instituti për Studime Publike e Ligjore (këtu e më poshtë “ISPL”), si një nga aktorët e interesuar të shoqërisë civile, është angazhuar, në kuadër të projektit “Me Sytë nga Drejtësia”, tëmbështesë dhe tëndihmojnëzbatimin samë efikas të StrategjisëNdërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025, pikësëpari duke iu ofruar institucioneve të drejtësisë dhe aktorëve të tjerë të angazhuar në këtë reformë: një analizë kritike konstruktive për vetë dokumentin strategjik dhe atë operacional (Plani i Veprimit dhe indikatorët e tij); njëbazë metodologjike për një monitorim sa më objektiv e efikas tënjë numri domethënës tëmasave kryesore tëPlanit tëVeprimit; dhe, mbi këtë bazë, një proces monitorimi një-vjeçar të pavarur e objektiv të zbatimit të Planit të Veprimit. Në lidhje me këtë të fundit, metodologjia e përzgjedhur në këtë projekt nuk paragjykon metodologjinë që do të ndjekë qeveria për monitorimin e masave e rezultateve të Planit të Veprimit, por ofron një alternativë që e përforcon dhe ndoshta e plotëson atë. Zbatimi i projektit mbështetet në një bashkëpunim efikas me aktorët institucionalë të SND II.

Si një hap i parë në zbatimin e tij, grupi i ekspertëve të projektit ka përgatitur një analizë të detajuar të dokumentit strategjik 2021-2025, planit të tij të veprimit si dhe të indikatorëve të realizimit të tij. Analiza synon: tëqartësojë për një publik sa më të gjerë kuptimin e qëllimeve, objektivave, rezultateve e masave të SND II; të verë në dukje pikat e forta por edhe elementët e paplotë ose të papërshtatshëm në raport me nevojat e sistemit të drejtësisë; dhe, të sugjerojë përmirësime të mundshme për vendimmarrësit. Gjithashtu, kjo analizëdo të shërbejë si bazë për hartimin e një metodologjie monitorimi dhe bashkëpunimin sa më efikas me institucionet e drejtësisë që janë në fokus të këtij projekti.

Analiza ështëjelluar më poshtëështë strukturuar sipas dokumentit strategjik SND II dhe planit të tij të veprimit, dhe ndjek renditjen e tij, duke përzgjedhur katër (4) qëllimet e politikës, nëntë(9) objektiva specifike, nëntëmbëshjetë (19) rezultate, dyzet e një (41) masa dhe tetëmbëdhjetë(18) indikatorë. Përzgjedhja e bërë nga lista tërësore e SND II bazohet në interesin e vecantë që paraqesin këto objektiva, rezultate, masa e indikatorë për qëllime të monitorimit nga shoqëria civile të progresit të bërë nga institucionet e drejtësisëzbatimin e Strategjisë 2021-2025.

*Tiranë, 23 nëntor 2021*

## ANALIZA E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË 2021-2025 (SND II)

### Qëllimi i Politikës 1

*“Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien”.*

Qëllimi i politikës së parë të Strategjisë Ndërsektoriale në Drejtësi 2021-2025 (SND II) përmban idenë dhe frymën e një pjese thelbësore të reformës në drejtësi, atë që lidhet me strukturën e mekanizmit të ri të prodhuar nga kjo reformë. Ky mekanizëm i ri, i përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e më tej në ligj<sup>1</sup>, parashikon si pjesë të tij disa institucione, konkretisht, Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGj), Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP), Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD), Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (KED) dhe Shkollën e Magjistraturës (ShM), të cilat do të qeverisnin të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor si një pushtet autonom brenda gjyqësorit, pa asnjë ndërhyrje nga pushtetet e tjera. Kështu, u shkëput cdo lloj lidhje e gjyqësorit me Ministrinë e Drejtësisë dhe Presidentin, lidhje që deri para reformës, pengonin pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor. Këto institucione kanë përgjegjësi të specializuara dhe të veçanta për të realizuar disa procese kyç që lidhen me mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë dhe janë hallka komplementare të njëra-tjetrës.

Kështu, KLGj ka në përgjegjësi të tij administrimin dhe menaxhimin e gjyqësorit (kontrollin dhe menaxhimin e buxhetit të tyre të veçantë, administrimin dhe menaxhimin e gjykatave), dhe është organi vendimmarrës për cdo çështje që lidhet me gjyqtarët (përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë dhe emërimin e gjyqtarëve, ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, çështjet disiplinore dhe etike, trajnimin e gjyqtarëve, etj). Përgjegjësitë e KLGj nuk lidhen vetëm me organizimin e gjyqësorit së brendshmi por, në mënyrë të veçantë, ky organ mban peshën e përgjegjësisë funksionimit të pushtetit gjyqësor përballë përdoruesve të gjykatës dhe shoqërisë në tërësi.

KLP, gjithashtu, është organi i qeverisjes së prokurorisë, përgjegjës për cdo vendimmarrje që lidhet me prokurorët (përzgjedhjen e kandidatëve për prokurorë, emërimin e tyre, ngritjen në detyrë dhe vlerësimin e performancës së prokurorëve, çështjet disiplinore dhe etike, etj).

Për të kontrolluar anëtarët e Këshillave, gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve, Prokurorinë e Përgjithshme dhe për të bërë inspektim institucional të gjykatave dhe prokurorive (çështjet që lidhen me rregullat institucionale dhe shërbimet administrative), u krijua ILD, si institucion kushtetues i pavarur, me funksionin ekskluziv procedim disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sipas motos ‘askush s’është i paprekshëm dhe duhet të përgjigjet për shkeljet ligjore’ të gjitha këto veprimtari janë të domosdoshme për të garantuar zbatimin e parimit të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë që duhet të tregojnë të gjithë pjesëtarët e sistemit të drejtësisë. Vetëm një sistem llogaridhënie që funksionon sipas kuadrit ligjor është efikas e transparent dhe që ‘përqafon’ standardet më të mira të llogaridhënies kontribuon në mënyrë të ndjeshme në rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

KED është organi që bën verifikimin e plotësisë të kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë dhe

---

<sup>1</sup>Ligj 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. KED është konceptuar si një organ i pavarur, i cili formohet cdo vit me short dhe synon të ketë natyrën e një organi të specializuar dhe të decentralizuar. Anëtarët e tij, dukeqenëse vijnë normalisht detyrat e tyre në gjykatat apo prokuroritë, prej nga ata vijnë, do të jenë “të ngarkuar” edhe me një detyrë tjetër, e cila për shkak se zgjat pak në kohë, nuk do të mund të krijojë lidhje varësie apo interesi të ndonjë lloj natyre.

Së fundmi, si një ndër organet e qeverisjes së gjyqësorit, është edhe Shkolla e Magjistraturës, e cila, sipas Kushtetutës, është e vetmja portë hyrjeje për në gjyqësor (nëpërmjet procesit të rekrutimit me anë të provimit, bazuar në vakancat e shpallura nga KLGJ dhe KLP) dhe i vetmi institucion përgjegjës për trajnimin e magistratëve në detyrë.

Mirëfunksionimi i këtyre institucioneve është kushti i parë themelor i mirëfunksionimit të gjithë sistemit të drejtësisë.

Qëllimi i Politikës 1 përmban në vetvete dy drejtime: drejtimi i parë kërkon që organet e qeverisjes të punojnë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe standardet evropiane, ndërsa drejtimi i dytë kërkon që organet e qeverisjes të jenë në gjendje të punojnë në mënyrë të plotë, të jenë të pavarura dhe të punojnë me profesionalizëm, efikasitet dhe konform standardeve të llogaridhënies. Pra, nga mënyra sesi është formuluar Qëllimi i Politikës 1, konkludohet që, ndërsa drejtimi i parë lidhet me ushtrimin e funksioneve nga ana e këtyre organeve në përputhje me ligjin dhe standardet evropiane, drejtimi i dytështë më i gjerë. Ky i fundit lidhet me, së pari, funksionimin e tyre në kapacitet të plotë, dhe së dyti, me respektimin e të gjitha parimeve të së drejtës që duhet të udhëheqin punën e këtyre organeve. Parime të tilla si profesionalizmi apo efikasiteti janë parime të përgjithshme që duhet të zbatohen nga të gjitha institucionet e drejtësisë, përfshirë këtu edhe gjykatat dhe prokuroritë e cdo niveli.

Pra, e para, këto institucione, përgjatë katërvjecarit të dytë të strategjisë së drejtësisë, duhet të kenë arritur konsolidimin e tyre tërësor, qoftë në strukturë, legjislacionin që i rregullon, aktet e veta të brendshme rregullatore, etj., dhe e dyta, duhet të prodhojnë rezultate të mirëfillta që lidhen me vendimmarrjet e tyre, rezultate që të tregojnë se këto organe janë të pavarura, profesionale, prodhojnë zgjidhje eficiente për sistemin dhe janë të krijuara mbi bazën e llogaridhënies.

Vlen të theksohet se organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë kanë një karakteristikë themelore: ato nuk synojnë të mbeten thjesht si organe që zgjidhin vetëm problemet e brendshme të sistemit, qoftë të gjykatës apo të prokurorisë. Përkundrazi, ato duhet të jenë në gjendje të kuptojnë nevojat dhe kërkesat që vijnë jashtë gjyqësorit, në mënyrë që t’i shërbejnë drejtësisë dhe qytetarëve të një vendi, t’iu paraprijnë nevojave të sistemit dhe të jenë një hap përpara në zhvillimin strategjik të drejtësisë në një vend. Kërkesa e përdoruesve të gjykatës dhe prokurorisë për të marrë shërbim nga drejtësia është detyrë e organeve të qeverisjes së drejtësisë dhe vlerësojmë se, nëse do të ishte shprehur në Politikën 1, do të shënonte një përparim të vetë Strategjisë për këtë komponent.

Në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020 (SND I) objektivi i parë strategjik ishte shprehur në mënyrë të ngjashme: “Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë”. Nga një krahasim literal i të dy qëllimeve strategjike duket se ato qëndrojnë në të njëjtat parashikime. Megjithatë, sic do të analizohet edhe në vijim, SND II vjen në një moment të ri, kur të gjitha organet e qeverisjes janë ngritur dhe janë duke funksionuar. Për këtë arsye SND II sjell një qartësim të rolit të secilit prej këtyre organeve.

Politika 1 synohet të realizohet duke vendosur tre objektiva specifike kryesorë: 1.1 Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit; 1.2 Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga

analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, legjislacionin për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin; dhe 1.3 Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet Evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, efikasitet dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmbush rregullat dhe standardet përkatëse.

Ky studim ka përzgjedhur për të trajtuar vetëm objektivat specifikë 1.2 dhe 1.3, duke qenë se objektivi i parë specifik vazhdon të jetë lidhur ngushtësisht me organet e vetëqeverisjes, Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA), dhe, edhe sikur kompetencat e tyre t'i kalonin KLGj-së dhe KLP-së, siç e kërkon Kushtetuta, sërish kjo transfertëdo të ishte e shpejtë dhe do të rrezikonte të ishte sipërfaqësore çdo analizë për punën e këtyre organeve në një kohë të shkurtër.

Ndërkohë, dy objektivat e tjerë të përzgjedhur, janë komplementarë me njëri tjetrin dhe japin një pasqyrë më të plotë se si shprehet/kërkohet zhvillimi strategjik i organeve të qeverisjes përgjatë këtij katërvjeçari.

## **Objektivi specifik 1.2**

*“Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në legjislacionin për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin”.*

Ky objektivi nënkupton nevojën që, pas një periudhe tre vjeçare 2017-2020, të bëhet një analizë e funksionimit dhe aktivitetit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë për të parë mundësinë e ndërhyrjeve në ligjin që rregullon këto organe. Ky objektivi, në përmbajtjen e tij, parashikon edhe fushat kryesore ku do të shtrihet analiza, si kompetencat e organeve, transparenca, efikasiteti dhe koordinimi mes tyre.

Së pari, në mënyrën sesi shprehet ky objektivi, përdoren fjalët: përditësim dhe përmirësim. Vlen të përmendet këtu se qëllimi i ndryshimeve në kuadrin ligjor lidhet me përmirësimin e funksionimit të organeve në rastet kur ligji ka penguar ose vështirësuar punën e tyre, si dhe kur aktualiteti i ri kërkon një rishikim të dispozitave ekzistuese. Nuk është detyrë e ligjit të bëjë përditësim, ndaj kjo shprehje nuk i përshtatet natyrës së objektivit dhe duhet shmangur.

Së dyti, nga analiza që i bëhet mënyrës sesi është shprehur ky objektivi, dallohet se ai i ka pararendur se do të duhet të ketë ndryshimet në ligj dhe/apo rregullore, pa pritur ende rezultatet e një analize që do të kryhet rreth legjislacionit të miratuar në 2016 dhe, gjithashtu, nuk ka marrë në konsideratë ndryshimet e fundit të 2021 që prekin elementë të rëndësishëm të funksionimit të sistemit të drejtësisë. Edhe nga mënyra sesi janë shprehur rezultatet e kërkuara dhe masat e parashikuara për arritjen e objektivit, dallohet qartësisht se rishikimi i ligjeve dhe rregulloreve është një ndër synimet e këtij objektivi dhe afati i vendosur për këto ndryshime është viti 2021-2022, pra fillimi i veprimit të SND II. Vlen të kujtohet këtu se ecuria strategjike e sektorit të drejtësisë mbështetet mbi një analizë të thellë të sistemit të mëparshëm dhe ligjet e reformës janë produkt i kësaj analize. Në funksion të Qëllimit të Politikës 1, ky objektivi është i diskutueshëm nëse i shton vlera funksionimit të organeve të qeverisjes së drejtësisë apo vepron në të kundërt, duke prodhuar pasiguri institucionale dhe shkaktuar deri në moslejim të ushtrimit në mënyrë të pavarur, nga legjislativi dhe ekzekutivi, të funksioneve të tyre.

Gjithashtu, funksionimi i mekanizmit, në funksion të strategjisë së ideuar të sistemit të drejtësisë, nuk ka qenë tërësisht funksional përgjatë SND I dhe ende vijon të ketë paplotësi. I tillë është për shembull, rasti i ILD-së, ku akoma nuk është plotësuar institucioni me inspektorë.

Po kështu edhe rastet e KLGJ-së dhe KLP-së, të cilat janë ende duke hartuar kuadrin e brendshëm rregullator tërësisht të ri, pra nuk mund të thuhet se ky kuadër rregullator është maturuar mjaftueshëm për të qenë i gatshëm t'i nënshtrohet një procesi analize e më tej ndryshimit të tij.

Së treti, vetë fokusi i Qëllimit të Politikës 1 qëndron në zbatimin e reformës, në forcimin e kapaciteteve të institucioneve të qeverisjes së gjyqësorit, dhe jo në ridizenjimin e saj. Edhe pse hartuesit e dokumentit strategjik mund të jenë nisur nga një qasje funksionale me synim përmirësimin e elementëve që shikohen si problematikë në ligj (duke mbajtur në konsideratë se një ligj apo rregullore, sado mirë të kenë parashikuar apo sado afër të jenë me arritjen e objektivave të tyre, mund të ketë elementë, të cilët do të duhet të analizohen *ex post* dhe të përmirësohen), vendosja e rishikimeve ligjore si një objektiv më vete, me masa konkrete të parashikuara për institucionet e qeverisjes (analiza e zbatimit të ligjit nga institucionet e drejtësisë, përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit, finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor në dokumentin strategjik 2021-2025), nuk është e përshtatshme. Mosparashikimi në SND II i këtij objektiv sigurisht që nuk do të hiqte dhe as nuk do të zbehte asnjë nismë apo analizë të organeve apo pushtetit ligjvënës për të ndërhyrë në këto ligje, por, ama, do të shmangte idenë se ndryshimi i ligjeve që rregullojnë qeverisjen e gjyqësorit po i nënshtrohet sërish një procesi ndryshimi strategjik.

**Konkluzion:** *Vendosja e rishikimeve ligjore si një objektiv më vete i SND II, me masa konkrete të parashikuara për institucionet e qeverisjes nuk është e përshtatshme. Mosparashikimi në SND II i këtij objektiv nuk do të hiqte dhe as nuk do të zbehte nisma apo analiza të organeve apo pushtetit ligjvënës për të ndërhyrë në këto ligje, por, ama, do të shmangte idenë se ndryshimi i ligjeve që rregullojnë qeverisjen e gjyqësorit po i nënshtrohet sërish një procesi ndryshimi strategjik. Në këtë stad, theksi i Strategjisë duhet të jetë tek zbatimi i kuadrit ligjor dhe detyrat e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Ky kuadër dhe këto detyra janë relativisht të reja dhe duhet lënë kohë e mjaftueshme zbatimi për t'u analizuar në mënyrë domethënëse.*

### Rezultati 1.2.1

*“Struktura e qeverisjes gjyqësore (KLGJ)/legjislacioni i rishikuar/ndryshuar, duke përfshirë por pa u kufizuar në rregulloret e brendshme”.*

Në përmbushje të objektivit 1.2, të analizuar më sipër, parashikohet arritja e tre rezultateve kryesore, që lidhen me rishikimin e strukturës së KLGJ-së, KLP-së dhe ILD-së, legjislacionin e rishikuar apo të ndryshuar të tyre, dhe plotësimin e rregulloreve të brendshme të tyre (për KLP dhe ILD do të analizohet në vijim). Konkretisht, për KLGJ-në, kërkohet që të zhvillohet një proces analize dhe vendimmarrjeje për të paktën tre aspekte të funksionimit të tij: së pari, struktura e këtij organi, së dyti, ligjet që rregullojnë aktivitetin e këtij organi dhe, së treti, rregulloret e brendshme dhe aktet me fuqi të përgjithshme që nxjerr ky organ.

Ky rezultat është në përputhje me objektivin 1.2 dhe përbën një hap pozitiv në drejtim të zbrërthimit në praktikë të këtij objektiv. Rezultati përbëhet nga tre komponentë kryesorë, të cilët do të duhet të merren në analizë më vete, për të bërë më të qartë sesi mund të realizohet ai, prandaj masa duhet të merren në mënyrë që të plotësohen tërësisht kërkesat e këtij rezultati.

E ndërsa këto tre drejtime arrihen të identifikohen, rezultati nuk përmban synimin e analizës së këtyre tre drejtimeve, që është ajo çfarë shpreh objektivin dhe qëllimin e politikës: veprimi i organeve në përputhje me standardet evropiane, me profesionalizëm, efikasitet, transparencë dhe në kushtet e llogaridhënies. Në përfundim, çdo rishikim i strukturës, ligjit apo rregullave të brendshme, do të duhet të ketë si synim përmbushjen e këtyre parimeve, pra

rezutati i dëshiruar do të duhet të ishte një strukturë dhe bazë ligjore që garanton kushtet që KLGj të veprojë me profesionalizëm, efikasitet, transparencë, etj. Edhe pse këto parime i përmban objektivi 1.2, ato duhet të ishin vendosur në mënyrë të shprehur edhe tek secili rezultat.

Parë në këtë këndvështrim, pra se sa analiza e këtyre komponentëve do të prodhojë harmonizim dhe ecuri drejt parimeve të vendosura, suksesi i këtij rezultati është i diskutueshëm.

Në aspektin teorik, KLGj e ka të mundur të vetanalizojë strukturën e saj, ligjin që rregullon veprimtarinë e saj dhe gjithashtu aktet që ka prodhuar deri më tani. Në aspektin praktik, duke pasur parasysh ecurinë e veprimtarisë së këtij organi, kur mbledhja e parë e tij është bërë në 20 dhjetor 2018, kohën e gjatë që i është dashur për hartimin e dokumentave të rëndësishëm të brendshëm, afërsisht një vit ose më shumë<sup>2</sup>, etj., rrezikon që ky kontroll nga ana e KLGj-së të jetë më tepër formal sesa substancial, përderisa këto akte të reja nuk janë maturuar e testuar për një kohë të gjatë në praktikë, pra nuk kanë pasur mundësinë të prodhojnë rezultate të mjaftueshme. Si rregull, cdo analizë e mëpasshme, *ex post*, e ligjeve apo rregulloreve, kërkon një periudhë zbatimi të ligjit apo rregullores, e më tej mund të nisë procesi i monitorimit të zbatimit dhe, së fundmi, të bëhet analiza e këtij zbatimi dhe të dalin rezultate konkrete nëse ka ose jo nevojë për ndryshim<sup>3</sup>.

**Konkluzion:** Rezultati i parashikuar është në përputhje me objektivin, megjithatë, është e diskutueshme nëse ai do të shërbejë Politikës 1. Kjo për arsye sepse, si rishikimi i ligjit që rregullon KLGj-në, edhe rishikimi i akteve nënligjore të nxjerra nga ky organ, edhe pse janë të mundshme për tu realizuar, analiza që ato do të prodhojnë do të jetë e mangët. Kjo lidhet drejtpërdrejtë me kohën e pamjaftueshme për të prodhuar një analizë të plotë mbi problemet që mund të ketë shkaktuar ligji apo aktet nënligjore në funksionimin e këtij organi si pjesë e organeve të sistemit të drejtësisë.

### Masa 1.2.3

*“Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLGj, konsultimi dhe miratimi i akteve”.*

Kjo masë parashikon rishikimin, pas një procesi analize lidhur me statusin dhe strukturën qeverisëse të KLGj<sup>4</sup>, e kuadrit ligjor lidhur me funksionet dhe përgjegjësitë që ka KLGj në përmbushje të misionit të saj për të mirëqeverisur sistemin gjyqësor në Shqipëri. Gjithashtu kjo masë parashikon edhe konsultimin dhe miratimin e akteve të reja që do të vijnë si rrjedhojë e këtij procesi. Pra, kjo masë parashikon tre veprimtari të njëpasnjëshme: e para, finalizimin e rishikimit të kuadrit ligjor, që do të thotë sigurimin e një vendimmarrjeje të brendshme lidhur me analizën dhe rezultatet/propozimet e dala prej saj, të cilat do të duhet të kenë parashikuar ndryshimet konkrete në ligj dhe rregullore; e dyta, realizimin e një procesi konsultimi me

---

<sup>2</sup>Vendim i KLGj nr.264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”; Vendim i KLGj nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”; Vendim i KLGj nr.316, datë 14.09.2020, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat disiplinore në këshillin e lartë gjyqësor”; Vendim i KLGj nr. 622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”; Vendim i KLGj nr. 171, date 22.04.2021, “Për miratimin e Kodi i etikës gjyqësore”, etj;

<sup>3</sup> OECD (2018), Ex-post assessment of regulation: Practices and lessons from OECD countries, OECD Publishing, Paris, fq. 11;

<sup>4</sup>Plani i veprimit të SND II, masa 1.2.1 dhe 1.2.2;

aktorë të përfshirë në proces që plani i veprimit i SND II nuk i detajon; dhe e treta, miratimi i ndryshimeve të akteve apo i akteve të reja.

Veçanërisht për dy veprimtaritë e fundit të parashikuara në këtë masë, konsultimin dhe miratimin e akteve, duke qenë se në rezultatin dhe objektivin nga buron kjo masë parashikohet edhe ndryshimi i ligjit që prek KLGj-në, masa duhet të kishte parashikuar së paku Ministrinë e Drejtësisë, por edhe Kuvendin gjithashtu. Vetë ligji 115/2016, në nenet 71 dhe 93 të tij, parashikon dy raste bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Konkretisht, ligji parashikon se Ministri i Drejtësisë koordinon zhvillimin dhe zbatimin e politikave shtetërore dhe të strategjisë sektoriale të sektorit të drejtësisë dhe është përgjegjës për përgatitjen e projektakteve ligjore në fushën e drejtësisë, për të cilat merr edhe mendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu, ligji parashikon se Këshilli i Lartë Gjyqësor bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë për të siguruar përputhjen e planeve strategjike dhe buxhetore të sistemit gjyqësor, të miratuara nga Këshilli, me politikat shtetërore dhe strategjinë sektoriale të sektorit të drejtësisë. Konkretisht, KLGj: a) shqyrton funksionimin e rregullave të procedurës gjyqësore civile, penale ose administrative; b) bën rekomandime për ndryshimin e rregullave të procedurës gjyqësore civile, penale ose administrative; c) jep përgjigje për kërkesat e ardhura nga ministrat për të dhënë mendim mbi një projektligj ose ndonjë çështje tjetër që mund të ndikojë mbi sistemin gjyqësor ose gjykatat; dhe ç) mund të japë mendim mbi një projektligj ose ndonjë çështje tjetër që mund të ndikojë mbi sistemin gjyqësor ose gjykatat, duke ia drejtuar një ministri ose ndonjë organi tjetër. Si përfundim, KLGj i propozon Ministrinë të Drejtësisë ushtrimin e nismës për ndryshime ligjore në lidhje me çdo çështje që është nën përgjegjësinë e tij.

Vlen të theksohet se edhe sipas instrumentit IPA III (2021-2027), për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ku parashikohen detyrimet e shtetit shqiptar të lidhura me financimin që bëhet nga fondet e BE, për KLGj dhe KLP parashikohet se ato do të duhet të forcojnë kapacitetet për rregullat që ato krijojnë dhe zbatojnë për zhvillimin e karrierës, ndërsa për çështje të analizës dhe ndryshimeve të legjislacionit parashikohet forcimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë.

Për këtë masë nuk parashikohet indikator, por monitorim me anë të raportimit nga institucioni përgjegjës.

**Konkluzion:** *Kjo masë e përmbush rezultatin, është në linjë të objektivit specifik të vendosur, por ka nevojë për plotësimin e institucioneve, të cilat do të duhet të marrin pjesë në këtë masë. Që masa të mund të realizohet nuk mjafton vetëm puna e KLGj-së, e cila është përgjegjëse vetëm për fazat e para, ato të studimit, analizimit dhe propozimit/këshillimit, por duhet të zgjidhen detyrat konkrete të institucioneve të tjera të përfshira. Nëse masa është realizuar apo jo, kjo do të duhet të kërkohet nga disa institucione njëherësh (MD dhe Kuvendi).*

## Rezultati 1.2.2

*“Struktura e qeverisjes së Prokurorisë(KLP)/legjislacioni i rishikuar/ndryshuar, duke përfshirë por pa u kufizuar në rregulloret e brendshme”.*

Rezultati i dytë që parashikon përmbushjen me sukses së objektivit 1.2, të analizuar më lart, është që KLP, pas një procesi analize, të rishikojë legjislacionin që rregullon veprimtarinë e saj, rregulloret e brendshme të saj dhe aktet e tjera me fuqi të përgjithshme dhe strukturën e KLP-së, që nënkupton organizimin e saj të brendshëm.

Së pari vlen të silllet në vëmendje se, në ndryshim nga funksionimi i gjyqësorit, sistemi i prokurorisë, parashikon një ndarje të kompetencave mes KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme, ku KLP ka përgjegjësi vetëm nëgarantimin e pavarësisë, llogaridhënies,

disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, dhe jo në menaxhimin apo administrimin dhe buxhetin e zyrave të prokurorisë, përgjegjësi këto që i përkasin Prokurorisë së Përgjithshme. Pra, cdo analizë që lidhet me KLP-në në këtë punim, do të mbajë parasysh këtë ndarje të funksioneve, edhe pse për objektiva dhe masa të caktuara këto dy organe kontribuojnë njëherësh më mirëfunksionimin e sistemit të prokurorisë.

Për analogji me rezultatin e parashikuar në rastin e KLGj-së, edhe në rastin e KLP-së, rezultati nuk përmban synimin e analizës së legjislacionit, strukturës dhe akteve të saj, që është ajo cfarë shpreh objektivi dhe qëllimi i politikës: veprimi i KLP-së në përputhje me standardet evropiane, me profesionalizëm, efikasitet, transparencë dhe në kushtet e llogaridhënies. Në përfundim, cdo rishikim i strukturës, ligjit apo rregullave të brendshme, do të duhet të ketë si synim përmbushjen e këtyre parimeve, pra rezultati i dëshiruar do të duhet të ishte një strukturë dhe bazë ligjore/nënligjore që garanton kushtet që KLP të veprojë me profesionalizëm, efikasitet, transparencë.

Gjithashtu, edhe për KLP-në vlen i njëjti arsyetim lidhur me mundësinë reale të arritjes së këtij rezultati. Këtu mbajmë në konsideratë se, edhe në rastin e KLP-së, ngritja e vonuar e këtij institucioni<sup>5</sup>, vështirësitë infrastrukturore, që e kanë bërë të vështirë punën me efikasitet<sup>6</sup>, dhe fillimi vetëm në 2019 nga nxjerrja e akteve, disa prej të cilëve janë të fundit të vitit 2019<sup>7</sup>, kanë prodhuar një situatë faktike që aktet që mund të vlerësohen kanë afërsisht dy vite që janë në veprim, kohë e shkurtër kjo për të bërë një analizë të plotë të efektshmërisë së tyre apo nevojës për përmirësim. Ky arsyetim është i njëjtë me analizën e bërë më sipër për rastin e KLGj-së.

**Konkluzion:** Rezultati i parashikuar është në përputhje me objektivin, megjithatë, është e diskutueshme nëse ai do të shërbejë Politikës 1. Kjo për arsye sepse, si rishikimi i ligjit që rregullon KLP-në, edhe rishikimi i akteve nënligjore të nxjerra nga ky organ, edhe pse janë të mundshme për t'u realizuar, analiza që ato do të prodhojnë do të jetë e mangët. Kjo lidhet drejtpërdrejtë me kohën e pamjaftueshme për të prodhuar një analizë të plotë mbi problemet që mund të ketë shkaktuar ligji apo aktet nënligjore në funksionimin e këtij organi si pjesë e organeve të sistemit të drejtësisë.

### Masa 1.2.7

*“Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor të lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP”.*

Kjo masë ka të njëjtin formulim si masa e parashikuar për KLGj dhe kalon në të njëjtin proces analize, parashikuara në masat 1.2.5 dhe 1.2.6, sic parashikohet për KLGj. Kështu, edhe në rastin e KLP parashikohet rishikimi i statusit dhe strukturës qeverisëse të KLP, të kuadrit ligjor lidhur me funksionet dhe përgjegjësitë që ka KLP në përmbushje të misionit të saj për të

<sup>5</sup>KLP është krijuar me vendim nr. 1, datë 19.12.2018;

<sup>6</sup>KLP ka punuar në mungesë mjedisesh dhe ka pasur në dispozicion disa zyra pune, të lëshuara përkohësisht nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, dhe vetëm në vitin 2020 u vendos në ambiente të përshtatshme pune në godinën Poli i Drejtësisë”, informacion i marrë nga Raporti vjetor 2019 i KLP, aksesuar nga: [www.klp.al](http://www.klp.al);

<sup>7</sup>Rregullore “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, miratuar me Vendimnr. 171, datë 27.09.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

mirëqeverisur sistemin e prokurorisë në Shqipëri. Gjithashtu kjo masë parashikon edhe konsultimin dhe miratimin e akteve të reja që do të vijnë si rrjedhojë e këtij procesi.

Për çështjet e vendimmarrjeve të brendshme të institucionit (strukturë, organikë dhe akte të KLP-së), kjo masë është e plotë dhe e qartë, pasi KLP mund dhe ka për detyrë t'i çmojë vetë këto elementë sesa përputhen me nocionin e mirëqeverisjes, që përfshin veprimin e KLP në kushtet e transparencës, pavarësisë, llogaridhënies, etj. Për çështjet që lidhen me ndryshimet ligjore, kjo masë, do të duhet të kishte parashikuar si institucion përgjegjës, së paku, Ministrinë e Drejtësisë dhe Kuvendin. Vetë ligji 115/2016, në nenet 169 dhe 187, parashikon se është Ministri i Drejtësisë institucioni përgjegjës për përgatitjen e projektakteve ligjore në fushën e drejtësisë penale pasi ka marrë mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. KLP nxjerr dhe miraton akte administrative individuale, në lidhje me statusin profesional të prokurorëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore; akte administrative kolektive, në lidhje me statusin e të gjithë prokurorëve ose zyrtarëve të administratës gjyqësore; akte normative nënligjore, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me efekt të përgjithshëm detyrues mbi të gjithë prokurorët, administratën e prokurorisë, personat privatë dhe organet publike, si dhe akte për miratimin e rregullave të brendshme procedurale. Në veçanti, rregullat procedurale mund të përfshijnë dispozita në lidhje me koordinimin e veprimtarisë së komisioneve, angazhimin e ekspertëve në punën e Këshillit, shpërndarjen dhe ndarjen e përgjegjësisë të administratës së Këshillit, kuorumin e nevojshëm për mbledhjet e komisioneve, rregulla për publikimin e informacioneve për procedimet e Këshillit, etj.

Në analizën që do t'i bëhet zbatimit ose jo të masës do të duhet të merren parasysh vetëm këto akte, që janë tagër i drejtpërdrejtë i KLP-së. Për çështjet e tjera që lidhen me ligjin, do të duhet të parashikohen MD dhe Kuvendi.

**Konkluzion:** *Kjo masë e përmbush rezultatin, është në linjë të objektivit specifik të vendosur, por ka nevojë për plotësimin e institucioneve, të cilat do të duhet të marrin pjesë në këtë masë. Që masa të mund të realizohet nuk mjafton vetëm puna e KLP-së, e cila është përgjegjëse vetëm për fazat e para, ato të studimit, analizimit dhe propozimit/këshillimit, por duhet të zgjidhen detyrat konkrete të institucioneve të tjera të përfshira. Nëse masa është realizuar apo jo, kjo do të duhet të kërkohet nga disa institucione njëherësh (MD dhe Kuvendi).*

### Rezultati 1.2.3

*“Strukturat e llogaridhënies (ILD)/legjisllacioni i rishikuar/ndryshuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në rregulloret e brendshme”.*

Rezultati i tretë që parashikon përmbushjen me sukses të Objektivit 1.2, të analizuar më lart, është që ILD, pas një procesi analize, të rishikojë legjisllacionin që rregullon veprimtarinë e saj, rregulloret e brendshme të saj dhe aktet e tjera me fuqi të përgjithshme, si dhe strukturën e ILD-së, që nënkupton organizimin e saj të brendshëm.

Edhe ky rezultat ka të njëjtën përmbajtje si rezultatet që kërkohen për KLGj dhe KLP. Megjithatë, problemi i kalimit të një kohe të mjaftueshme për të bërë këtë analizë të ligjit dhe akteve nënligjore, apo strukturës dhe organikës së ILD në funksion të veprimit në transparencë, efikasitet dhe llogaridhënie të këtij organi, është edhe më evident, pasi ILD është organi më i ri i formuar dhe që ende nuk është plotësuar për të qenë tërësisht efektiv<sup>8</sup>. Për

---

<sup>8</sup>ILD nisi nga puna vetëm në shkurt të vitit 2020 dhe ka qenë problematike bërja efektive e këtij institucioni për shkak të mungesës së inspektorëve, veçanërisht atyre magjistratë. Edhe rekrutimi i inspektorëve jo-magjistratë ka qenë i vështirë, dhe deri më tani ILD ka vendosur lejimin e kandidimit për njëmbëdhjetë kandidatë.

shkak të këtyre problematikave, ILD bëri edhe propozime për ndryshime të ligjit<sup>9</sup>, propozime të cilat nuk morën miratim për t'u përfshirë në ndryshimet që ju bë ligjit 115/2016.

E vetmja masë që parashikohet nga Plani i Veprimit në përmbushje të pjeshme të këtij rezultati është Masa 1.2.11 "Rishikimi dhe konsolidimi i rregulloreve të brendshme të ILD-së". Të gjitha masat që parashikohen për ILD-në kanë një kohëzgjatje deri në vitin 2022, afat shumë i shkurtër ky si për të iniciuar procesin e analizës, kur mbajmë në konsideratë se aktet e ILD kanë më pak se një vit që aplikohen, ashtu edhe për të arritur në konkluzione lidhur me efektshmërinë e tyre apo ndryshimet e nevojshme që mund të përmirësonin funksionimin e ILD-së.

Rezultati i parashikuar për ILD-në është një hap më tej i rezultatit të mëparshëm të vendosur në SND I (2016-2020), sipas të cilit parashikohej "Krijimi i një inspektorati të vetëm të pavarur përgjegjës për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të zhvilluar shërbime të tjera inspektimi në gjykata dhe prokurori në përputhje me standardet evropiane" dhe si masë konkrete parashikohej edhe "hartimi i rregullave dhe manualeve të brendshme". Por, vonesa në ngritjen e këtij organi dhe në funksionimin e tij, e bën të vështirë ecurinë e këtij rezultati në vitet 2021-2022.

Referuar Pasaportës së Indikatorëve të SND I një nga Indikatorët (përkatësisht nr.2) kishte të bënte me përmirësimin e administrimit të ankesave kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas afateve të reja ligjore. Në këtë dokument përcaktohen edhe targetet për ILD-në si dhe metodat e verifikimit. Përkatësisht, për 2019 do të verifikoheshin procedurat e brendshme, manualët e inspektimit, mbrojtja e të dhënave dhe aksesit në publik, 10 inspektorë të punësuar, ndërtesa, etj. Si rezultat, për 2020/2021 indikatori do të ishte numri i ankesave të marra dhe të përpunuara, të cilat pjesëtohen me numrin e ankesave të marra deri në 30 nëntor të vitit përkatës. Përpunimi nënkupton: vendim përfundimtar të arsyetuar nga ILD për hapjen ose jo të hetimit, mbylljen pas verifikimit *prima facie* ose rrëzimin e ankesës.

Objektivat në Pasaportën e Indikatorëve kishin të bënin me sistemin e ankesave si çelësi për të kuptuar mirëfunksionimin e sistemit llogaridhënës. Kjo nënkupton pavarësi në ushtrimin e detyrës, transparencë në mënyrën se si trajtohen ankesat, efikasitet në menaxhimin e tyre, koordinim me KLGJ dhe KLP, si dhe harmonizim të procedurave midis magistratëve gjyqtarë dhe atyre prokurorë. Për të gjitha këto nevojitet koha e duhur për të parë jetësimin e tyre. Vetëm gjatë zbatimit të sa më sipër, ILD mund të jetë në gjendje të kuptojë/vlerësojë se sa e pengon ligji të ushtrojë funksionet sipas standarteve të lartpërmendura dhe sa janë faktorë të tjerë që ndikojnë (psh. rekrutimi i inspektorëve magistratë, sidomos gjyqtarë, që deri tani nuk kanë shfaqur interes të kandidojnë për këtë pozicion). Krijimi i një trupe profesionale inspektorësh (juristë, gjyqtarë dhe prokurorë) garanton pavarësi në ushtrimin e kompetencave, transparencë dhe efikasitet në procesimin e ankesave.

Edhe pse ekziston koherencë e sigurt, që do të thotë se aktivitetet e rradhitura janë kushte të nevojshme dhe të mjaftueshme për të arritur objektivat specifike, Objektivi Specifik 1.2 krijon pjesërisht lidhje të natyrshme/harmonikeme parashikimet e SND I dhe Pasaportës së Indikatorëve të saj. Kjo është një zgjidhje e diktuar nga rrethanat pasi gjatë jetëgjatësisë së SND I, ILD nuk ishte krijuar ende dhe Objektivi Specifik, Rezultatet dhe Masat nuk arritën të jetësohen gjatë vlefshmërisë së asaj Strategjie. Në thelb ato ishin vetëm 'parashikime në letër'. Nisur nga kjo situatë, hartuesi i Strategjisë ka menduar t'i integrojë ato parashikime në SND II, për sa kohë ka gjykuar që ato janë të vlefshme, duke ri-konsideruar/rivlerësuar disa aspekte.

---

<sup>9</sup>Dy ndërhyrjet kryesore të propozura lidheshin, së pari me heqjen e raportit ndërmjet inspektorëve jomagjistratë me ata magistratë, por duke lënë një radhë preference të atyre që vijnë nga radhët e magistratëve, dhe, së dyti, njehsimin e pagave të të gjithë inspektorëve bazuar në detyrën e njëjtë të cilën ata ushtrojnë dhe në garancitë e njëjta që ligji duhet të japë.

Rivlerësimi ka ardhur edhe si pasojë e rolit që ka luajtur vetë ILD gjatë hartimit të SND II, duke dhënë 'input' konkret në hartim dhe duke komentuar aspekte të saj nisur nga problematikat/sfidat që kanë lindur nga zbatimi i kuadrit ligjor. Tashmë ka një 'zë konkret në tavolinën e Strategjisë' që duhet marrë në konsideratë. Për më tepër vlen të theksohet që vetë ILD e ka miratuar strategjinë e saj institucionale. Ndërkohë që SND I është hartuar/konceptuar në një kohë kur ILD ekzistonte vetëm në letër dhe Objektivat, Rezultatet dhe Masat kishin karakter më abstrakt.

Edhe parashikimi paraprak i bërë nga Plani i veprimit IPA III, e parashikon përmirësimin e rregullave mbi karrierën dhe kontrollin e magistratëve në një afat kohor deri në 2027.

**Konkluzion:** Parë në tërësi, edhe pse ky rezultat duket në linjë të objektivit dhe në përputhje me të dhe është në kronologji me SND I, suksesi i këtij rezultati është i diskutueshëm. Shtrirja e tij në kohë duhet të jetë më e gjatë. Bashkërisht edhe me rezultatet e tjera të analizuara për KLGj dhe KLP, vlerësohet se këto rezultate janë në funksion të arritjes së Objektivit Strategjik të vendosur. Dyshimet që mund të ekzistojnë në lidhje me rezultatet, në fakt lidhen me vetë qëllimin e Objektivit Specifik 1.2; ushtrimi i kompetencave nga institucionet në përputhje me kërkesat e zbatueshme dhe standardet evropiane (në mënyrë që ato të jenë të pavarura dhe punojnë me profesionalizëm, efikasitet dhe ruajnë standardet e llogaridhënies) nuk nënkupton domosdoshmërisht rishikimin e legjislacionit. Kjo pasi prezumohet që kuadri ligjor i miratuar në 2016/2017 ofron garancitë për pavarësi, profesionalizëm, efikasitet dhe standarde llogaridhënieje.

#### **Masa 1.2.9**

*"Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me ILD".*

Kjo masë ka të njëjtin formulim si masat 1.2.5, 1.2.6, 1.2.7 të parashikuara për KLGj dhe KLP. Duket që hartuesi i Strategjisë i ka kushtuar rëndësi ruajtjes së të njëjtave standarde për të tre institucionet e drejtësisë.

Kjo masë (pra 1.2.9) dhe ajo në vijim (1.2.10) duket sikur janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Në thelb, synohet të përgatiten dy lloj analizash. Fillimisht do të përgatitet analiza e zbatimit të reformës në sistem për ILD-në, dhe, pastaj, gjetjet/rekomandimet e kësaj analize do të pasqyrohen eventalisht në analizën për rishikimin e ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e ILD-së (masa 1.2.10).

Mbetet e paqartëse cili institucion do t'a bëjë këtë analizë, vetë ILD apo një strukturë tjetër e barazlartuar që do të analizojë edhe punën e institucioneve të tjera të drejtësisë, krahas ILD-së. E themi këtë, pasi puna e ILD-së edhe pse mund të analizohet në mënyrë të veçantë, ajo duhet parë edhe në këndvështrimin e vendimmarrjeve të KLGj-së dhe KLP-së. Këshillat janë institucionet vendimmarrëse mbi propozimin dhe hetimin e kryer nga ILD. Tërësia e aktiviteteve të të tre institucioneve mund të japë një tablo të qartë mbi zbatimin e reformës për ILD-në për sa i takon llogaridhënies, përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit.

**Konkluzion:** Nisur nga sa më sipër në lidhje me rezultatin e synuar (përditësimi i legjislacionit që nënkupton rishikim të ligjeve ose akteve nënligjore), vlerësohet që këto masa janë në vetvete të përshtatshme për sa kohë do të merren në funksion të këtij Rezultati dhe Objektivit Strategjik. Gjithsesi mbetet për t'u vlerësuar 'momenti' kur do të kryhet ky përditësim, duke pasur parasysh jetëgjatësinë e shkurtër të ILD-së dhe, për rrjedhojë, edhe të zbatimit të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e këtij institucioni.

### Masa 1.2.10

*“Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të ILD ( draft-propozimet)”*

Për sa i takon kësaj mase, duke qenë se ka lidhje të natyrshme me masën 1.2.9, i referohemi analizës së mësipërme.

Gjithsesi, që kjo masë të jetësohet, vlerësohet e nevojshme edhe përfshirja e institucioneve të tjera në fazën e analizës mbi veprimtarinë e ILD-së; për më tepër që ILD është e kufizuar në hapësirën për propozime ligjore, pasi ndryshimet ligjore ose mund të vijnë si iniciativë ligjore e MD-së, ose si propozim deputetësh, bazuar në sugjerime konkrete të paraqitura nga vetë ILD në Kuvend. Procedura të tilla parlamentare hasen shpesh në Kuvend. Në të gjitha rastet ndryshimet e propozuara nga vetë ILD do t'i nënshtrohen procesit të konsultimit publik me institucione të tjera të drejtësisë, ekzekutivin, shoqërinë civile, partnerë, etj., sipas rastit. Më tej, miratimi tyre bëhet me 3/5 të deputetëve të Kuvendit.

**Konkluzion:** *Realizimi i masës (për sa i përket ndryshimeve ligjore) varet nga një sërë faktorësh (teknikë dhe vullnet politik), duke përfshirë arritjen e një shumice parlamentare të nevojshme pasi ndryshimi në Ligjin nr.115/2016 mund të bëhet vetëm me shumicën prej 3/5 e deputëteve të Kuvendit të Shqipërisë. Për rrjedhojë kjo masë nuk mund të jetë ekskluzivisht përgjegjësi e ILD-së.*

### Masa 1.2.11

*“Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të ILD-së”*

Masa 1.2.11 i referohet rishikimit dhe konsolidimit të rregullave të brendshme të ILD-së. Kjo masë përmban dy elementë: *rishikim dhe konsolidim*. Rishikimi nënkupton një proces analize të brendshme, me pasojë (për sa kohë gjetjet e përligjin) ndërhyrje në aktet nënligjore të vetë ILD-së. Duke qenë se bëhet fjalë për rregullat e brendshme, institucioni ka mundësinë (kupto: edhe fleksibilitetin) që t'i ndryshojë ato sa herë shfaqet nevoja.

Konsolidimi është një proces i shtrirë në kohë, rezultatet e të cilës vijnë pas një periudhe kohe dhe vendimmarrjeje të caktuar.

Për nga mënyra se si është formuluar kjo masë duket më shumë ‘një rezultat’ sesa një masë. Rezultati për këtë objektiv strategjik është përditësimi i legjislacionit që nënkupton rishikim të ligjeve ose akteve nënligjore. Për më tepër, duke patur parasysh jetëgjatësinë e ILD-së, kohën që duhet për zbatimin e kuadrit ligjor, efektet që priten të vijnë, si dhe afatet e strategjisë që synohet të miratohet, duket sikur kjo masë është pak e nxituar dhe nuk përputhet tërësisht në portofolin e masave. Për sa më sipër, sugjerohet rivlerësimi i kësaj mase, ose duke e zëvendësuar me një masë tjetër, ose duke e hequr tërësisht nga ‘seria e masave’.

**Konkluzion:** *Kjo masë duket më shumë si ‘një rezultat’ sesa një masë. Në cdo rast, sugjerohet rivlerësimi i kësaj mase, në mënyrë që të jetë më realiste në funksion të Objektivit Strategjik dhe rezultateve që priten të arrihen, ose zëvendësimi i saj me një masë tjetër.*

### Masa 1.2.12

*“Përgatitja e një plani operacional të ILD për trajtimin e ankesave të prapambetura”*

Masa tjetër që parashikohet i referohet hartimit të një plani operacional të ILD-së për trajtimin e ankesave të prapambetura. Kjo masë lidhet me atë që ishte parashikuar në SND I si target në Pasaportën e Indikatorëve. Duke qenë se ILD është krijuar në vitin e fundit të SND I, natyrshëm që kjo masë mbeti e porealizuar dhe është përfshirë në listën e masave për SND II.

Metodologjia që do të përdoret për trajtimin e 'backlog' merr një rëndësi të veçantë që mund të ndërlihet edhe me masat 1.2.9. si dhe 1.2.10. Ndërlidhja me këto masa mund të krijojë mbivendosje dhe konfuzion në zbatimin e Strategjisë, prandaj riformulimi me qëllim saktësimin mund të jetë një hap i nevojshëm.

**Konkluzion:** Sugjerohet rivlerësimi i kësaj mase dhe harmonizimi me masat 1.2.9 dhe 1.2.10 në mënyrë që të mos krijohet mbivendosje dhe konfuzion në zbatimin e Strategjisë.

### Objektivi Specifik 1.3

*Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, eficientë dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmbush rregullat dhe standardet përkatëse.*

Objektivi 1.3 është në përputhje me Qëllimin e Politikës 1. Madje në dukje është objektivi që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbushjen e kësaj politike.

Objektivi përfshin veprimtarinë e tre institucioneve, përkatësisht KLGJ, KLP dhe ILD. Ai ka në fokus kryesor fuqizimin/konsolidimin e organeve të qeverisjes së drejtësisë sipas standardeve evropiane. Ky fuqizim do të orientohet në dy drejtime: Së pari, krijimin dhe zhvillimin e kapaciteteve për kryerjen e veprimtarisë së këtyre institucioneve me pavarësi, eficientë dhe standarde profesionale. Së dyti, shërbimet që këto institucione ofrojnë në respektim të kompetencave të tyre, për gjyqësorin dhe prokurorinë, të përmbushin rregullat dhe standardet e fushës respektive.

Parakusht për funksionimin me pavarësi, eficientë të institucioneve të qeverisjes së drejtësisë, si dhe për ofrimin nga ana e tyre të shërbimeve sipas standardeve është konsolidimi i tyre. Ky i fundit nënkupton njëkohësisht si burime të duhura financiare dhe infrastrukture, ashtu edhe kapacitete të përshtatshme njerëzore për zhvillimin sipas standardeve të shërbimeve për administrimin dhe menaxhimin e sistemit gjyqësor, dhe atë të prokurorisë. Kuptohet se sa më të konsoliduara të jenë institucionet aq më shumë rriten garancitë që ato do të ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të pavarur, me eficientë dhe në përputhje me standardet më të mira profesionale. Për rrjedhojë, edhe ushtrimi kompetencave të dhëna nga Kushtetuta dhe ligji për këto organe si emërimet, promovimet, transferimet, verifikimet, procedimet disiplinore dhe inspektimet, do të jenë pasojë e një procesi meritokracie, duke ndikuar në rikthimin e besimit të publikut në sistem.

Ky Objektiv rrit besueshmërinë në veprimtarinë e këtyre institucioneve. Pavarësia dhe paaënësia në zbatimin e legjislacionit mbi emërimin, transferimin dhe promovimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe këshilltarëve ligjorë, si dhe transparencën në procedurat e aplikuar, do të rriste besimin tek KLGJ dhe KLP. Nga ana tjetër, operimi i këtyre organeve në përputhje me standardet e fushës, do të kishte si produkt final vetë rritjen e eficientës së sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë. Gjithashtu, hetimet që kryhen nga ILD duhet të jenë tërësore, të plota, të bazuara në fakte dhe prova, si dhe transparente. Ato duhet të kryhen të pa-ndikuara nga influenca të jashtme apo të brendshme, duke bërë vlerësim sa më objektiv të situatës. Vetëm të gjitha këto së bashku do të ndikojnë në besimin e qytetarëve në këto institucione dhe në vetë sistemin e drejtësisë. Pra, do të mund të kishim dhe realizimin e një prej qëllimeve kryesore të Reformës në Drejtësi.

Objektivi është formuluar në një fjali të vetme që krijon premisa për paqartësi. Në këtë aspekt, sugjerojmë shmangien e një nga termave fuqizim/konsolidim, sa kohë mbartin të njëjtin kuptim. Gjithashtu sugjerojmë që termi "krijimi dhe zhvillimi i kapaciteteve" të rishihet,

pasi sa kohë institucionet janë ngritur e janë funksionale, faza e krijimit të kapaciteteve duket të jetë tejkaluar dhe, në këtë moment, më tepër kemi të bëjmë me zhvillim të mëtejshëm e rritje të kapaciteteve. Në funksion të qartësisë të gjuhës mund të shihet dhe pjesa “*ofrimin e shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmbush rregullat dhe standardet përkatëse*”, sa kohë që nuk del shumë qartë ndryshimi i saj me pjesën e dytë të fjalisë (“*të kryejnë aktivitetin me pavarësi, efikasitet dhe standarde profesionale*”). Qartësimi i gjuhës do të bënte më të kuptueshëm edhe vetë Objektivin në raport me rezultatet e pritshme prej tij apo masat respektive.

Objektivi ka relevancë në raport me nevojat aktuale dhe të ardhmen e afërt të sistemit të drejtësisë. Aktualisht jemi në fazën kur institucionet janë ngritur, kanë infrastrukturë dhe burime, si dhe, në një masë të konsiderueshme, kanë plotësuar bazën e tyre ligjore, si përsa i përket rregullave të funksionimit të tyre, ashtu edhe në raport me rolin dhe kompetencat që kanë kundrejt gjyqësorit dhe sistemit të prokurorisë. Në këtë fazë, i rëndësishëm është konsolidimi i tyre nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve, plotësimit me burime aty ku ka nevojë për KLGJ, KLP, ILD, si dhe aplikimi me paanësi, pavarësi dhe transparencë i rregullave mbi emërimet, promovimet dhe transferimet, etikën profesionale, procedimet disiplinore, inspektimet, etj. Realizimi i këtij objekti brenda kohëzgjatjes së Strategjisë vlerësohet si realist dhe lidhet me pritshmëritë e publikut për një sistem drejtësie të pavarur dhe cilësor.

Më tej konstatohet që ky objektivi specifik ka qenë pjesërisht i tillë tek SND I. Konkretisht, Objektivi 1 parashikonte: *Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë*. Në thelb, të dyja formulimet, si e Objektivit 1.3 tek SND II, ashtu edhe ajo e Objektivit 1 tek SND I nënkuptojnë të njëjtën gjë, pavarësisht se SND I përdorte një term më gjithëpërfshirës. Për rrjedhojë, ky mbetet një objektivi në harmoni me nevojat dhe në vijimësi të politikave në sistemin e drejtësisë.

Gjithashtu, Objektivi Specifik 1.3 është edhe në koherencë me dokumentet strategjike të vetë organeve të përfshira në të: KLGJ, KLP dhe ILD.

Ai përkon me Planin Strategjik të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit për Sistemin Gjyqësor 2018 - 2020, konkretisht me Synimin 2 dhe 4 të tij, të cilët parashikojnë si objektiva të KLGJ-së, përkatësisht “Përmirësimi i standardeve të ekselencës gjyqësore, zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të tyre në praktikë” dhe “Fuqizimi i kapaciteteve të brendshme të KLGJ-së.”

Koherencë vërehet edhe midis këtij objekti dhe objektivit të parashikuar në Programin 1 të KLP-së: *Administrimi i karrierës së prokurorëve bazuar në performancën profesionale të secilit*, si dhe në Programin 3: *Përgjegjshmëria e prokurorëve e garantuar përmes sistemit disiplinor* të “Planit strategjik 2021 - 2024 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

Vërehet gjithashtu një lidhje edhe me Planin Veprimit dhe Planin Strategjik të Zyrës së ILD-së 2020-2022, konkretisht Objektivi Strategjik 1, i cili parashikon: *Fuqizimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale*; si dhe me Objektivin 2: *Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standartet ndërkombëtare*.

Të gjitha këto Objektiva të sipërcituara shkojnë në të njëjtën linjë me Objektivin Strategjik të SND II. Kjo nënkupton se është një objektivi i përbashkët, puna për arritjen e të cilit është në vijimësi.

Ky objektivi do të finalizohet në 3 rezultate të pritshme, të cilat do të analizohen në vijim dhe që janë në koherencë me të. Me realizimin e objektivit do të mundësohet që së pari KLGJ, KLP dhe ILD të konsolidohen, me kapacitete dhe burime të nevojshme për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisë, dhe së dyti, në funksion të kësaj premise, kompetencat e tyre në raport me gjyqësorin dhe prokurorinë të ushtrohen sipas standardeve përkatëse të kërkuara.

Ajo që vërehet si mangësi në trajtimin tërësor të këtij objekti është mungesa e masave konkrete të parashikuara për arritjen e të gjithë qëllimeve të synuara dhe mungesa e indikatorëve që do t'a bënte të matshëm progresin e bërë në lidhje me vetë Objektivin. Këto mungesa do të trajtohen në vijim, por duhet theksuar që paplotësia e tyre ndikon në realizimin faktik të tij.

**Konkluzion:** *Objektivi Specifik 1.3 është në përputhje me Qëllimin e Politikës 1. Ai është gjithashtu në të njëjtën linjë vijimesie edhe me Objektivin Strategjik 1 të SND I. Objektivi përputhet edhe me objektivat e reformës në drejtësi, një nga qëllimet e së cilës ka qenë ushtrimi i kompetencave nga institucionet e drejtësisë, në pavarësi të plotë (nga pushtetet e tjera), në mënyre eficiente dhe në përputhje me standardet profesionale (që nënkupton emërimet, ngritje në detyrë dhe transferimet bazuar në parime të meritokracisë dhe transparencës), si dhe kryerja e verifikimeve/hetimeve përkatëse, procedimeve disiplinore dhe inspektimeve bazuar në një kuadër ligjor të qartë, transparent dhe llogaridhënës. Ajo që mund të rishikohet në këtë objektivi është gjuha, e cila në funksion të qartësisë të saj, siç u sugjerua më sipër, do të mundësonte një kuptim më të saktë për drejtimit e këtij objekti dhe do të krijonte koherencë më të madhe me masat dhe rezultatet e pritshme të cilat do të analizohen më poshtë. Nga ana tjetër, për realizimin në praktikë të tij do të ishte e nevojshme plotësimi me masa shtesë, të cilat do të mundësonin aplikimin në praktikë të tij. Gjithashtu për matjen e progresit në arritjen e këtij objekti, do të ishte e nevojshme që SND II të shtonte indikatorët që do të masnin çdo rezultat të shprehur në këtë Objektivi (shih analizën në vijim)*

### **Rezultati 1.3.1**

*"Kapacitetet (duke përfshirë proceset, aftësitë dhe menaxhimin) dhe burimet (financiare, pajisje dhe infrastrukturë) të KLGJ-së janë të përshtatshme për të zbatuar aktivitetet e saj. KLGJ emëron, promovon dhe transferon numrin e kërkuar të gjyqtarëve dhe/ose të këshilltarëve ligjorë sipas rregullave dhe standardeve të kërkuara dhe të miratuara".*

Ky rezultat lidhet specifikisht me KLGJ, si një ndër institucionet e përfshira në Objektivin 1.3.

Me përmbushjen e Objektivit 1.3 rezultati i pritshëm për KLGJ do të orientohet në dy drejtime. Së pari, do të kemi të bëjmë me një institucion të konsoliduar, me kapacitete dhe burime të nevojshme për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi. Së dyti, në funksion të kësaj premise, kompetencat që i janë dhënë këtij institucioni në raport me gjyqësorin do të ushtrohen sipas standardeve përkatëse të fushës.

Aktualisht KLGJ në këto vite të para të funksionimit është duke rritur kapacitetet dhe performancën e saj. KLGJ ka ngritur strukturat përbërëse, ka rekrutuar staf dhe ka infrastrukturë që i ka mundësuar të krijojë bazën e nevojshme ligjore për ushtrimin e aktivitetit të saj. Ajo ka miratuar një sërë vendimesh për kriteret e emërimit, transferimit dhe ka përcaktuar standarde mbi matjen e performancës dhe sistemin e karrierës<sup>10</sup>. Përgjatë kohëzgjatjes së SND II, rritja e kapaciteteve dhe zbatimi i përgjegjësi me paanësi, bazuar në parimet e meritokracisë dhe transparencës, do të mundësojë arritjen e objektivit për fuqizimin e këtij organi dhe veprimin në përputhje me standardet e fushës. Për këtë Rezultati 1.3.1 është logjik dhe në koherencë me Objektivin 1.3, si dhe me gjendjen aktuale.

---

<sup>10</sup>Shih për më tepër aktet e miratuara në <http://klgj.al/akte-normative-nenligjore/>

Rezultati është në vijim të parashikimeve të SND I, por edhe në linjë logjike me rezultatet e pritshme të masave në zbatim të Planit të Veprimit 2019-2021 të SND 1 (konkretisht të masave 1 dhe 3 të nënobjektivit 1/a, si dhe masës 1 të nënobjektivit 1/b)

Ky rezultat është në fakt edhe pritshmëri e përmbushjes së masave të caktuara në synimet 2 (2.1 1) dhe 3 të Planit Strategjik të KLGJ-së për Sistemin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë 2019-2020.

Rezultati 1.3.1 është logjik dhe vlerësohet si i nevojshëm dhe i pritshëm referuar synimeve që ka Politika 1 dhe Objektivi 1.3. Megjithatë elementët e vendosur në këtë rezultat që orientojnë kuptimin e kapaciteteve, pra pjesa *“duke përfshirë proceset, aftësitë dhe menaxhimin”* mbetet e paqartë. Këtë vështirësi e thekson edhe mungesa e plotësisë së masave që janë parashikuar në funksion të arritjes së këtij rezultati. Për arritjen e tij, SND II ka parashikuar si masë vetëm *“Përfundimi i procedurave të emërimit, promovimit, transferimit të magjistratëve të diplomuar nga SHM”*. Përveçse e pasaktë në formulim, siç do të analizohet në vijim, masa duket të ndikojë pjesërisht në arritjen e këtij rezultati. Për këtë arsye, SND II rekomandohet ose të shtojë masa për t'a bërë rezultatin realist, ose të ndërlihdë këtë rezultat me masat eventuale që KLGJ parashikon të përfshijë në Planin e saj Strategjik për vitet në vijim, të cilin është duke e hartuar.

Në SND II, aktualisht nuk janë të përcaktuar indikatorë për matjen e këtij rezultati. Referuar Plan Veprimit të SND I për 2019-2021, për matjen e progresit të tij është parashikuar si indikator: *“% e gjyqtarëve dhe prokurorëve që besojnë se gjyqtarët janë emëruar / ngritur në detyrë, transferuar, përveç aftësisë dhe përvojës në dy vitet e fundit (vlera të veçanta për gjyqtarët dhe prokurorët)”*. Përfshirja e indikatorit *“% e gjyqtarëve që besojnë se gjyqtarët janë emëruar / ngritur në detyrë bazuar në meritokraci dhe sistemin e karrierës”*, lidhur me pjesën e gjyqësorit, do të jepte në mënyrë sasiore dhe cilësore perceptimin mbi arritjen e rezultatit për pjesën e zbatimit të standardeve në ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe do e bënte atë më realist. Për të matur burimet e përshtatshme financiare një indikator mund të ishte *“% e buxhetit të shtetit dedikuar KLGJ në raport me projektbuxhetet e propozuara prej vetë institucionit”*. Për pjesën e matjes së kapaciteteve një indikator matës do të ishte *“% e këshilltarëve/administratës së KLGJ-së që janë trajnuar mbi detyrat e tyre funksionale”*. Ndërkohë indikatorë të tjerë, që do të tregojnë shkallën e përmbushjes së këtij rezultati, do të jenë në varësi të masave që duhet të parashikohen për rritjen e kapaciteteve dhe infrastrukturës.

**Konkluzion:** Rezultati është i nevojshëm dhe i përgjigjet Objektivit Specifik 1.3. Ai duhet të qartësojë elementet që nënkuptojnë kapacitetet me qëllim identifikimin e masave dhe indikatorëve për matjen e tyre. Gjithashtu, hartuesit duhet të konsultojnë me KLGJ masat që do të përcaktohen e që duhet të ndërmerren me qëllim arritjen plotësisht të këtij rezultati. Gjithashtu sugjerojmë që për monitorimin e këtij rezultati të përfshihen si indikatorë: *“% e gjyqtarëve që besojnë se gjyqtarët janë emëruar / ngritur në detyrë bazuar në meritokraci dhe sistemin e karrierës”*, *“% e buxhetit të shtetit dedikuar KLGJ në raport me projektbuxhetin e parashikuar dhe propozuar prej vetë institucionit”*, si dhe *“% e këshilltarëve/administratës së KLGJ-së që janë trajnuar mbi detyrat e tyre funksionale”*.

### Rezultati 1.3.2

*“Kapacitetet (duke përfshirë proceset, aftësitë dhe menaxhimin) dhe burimet (financiare, pajisje dhe infrastrukturën) e KLP-së janë të përshtatshme për të zbatuar aktivitetet e saj, dhe KLP emëron, promovon dhe transferon numrin e kërkuar të prokurorëve dhe/ose të këshilltarëve ligjorë sipas rregullave dhe standardeve të kërkuara dhe të miratuara.”*

Ky rezultat mban parashikime të njëjta me Rezultatit 1.3.1, dhe ka në fokus KLP-në. Ai prezumon se me përmbushjen e Objektivit 1.3, për pjesën e KLP, rezultati i pritshëm do të orientohet në dy drejtime. Së pari, do të kemi të bëjmë me një institucion të konsoliduar, me kapacitete dhe burime të nevojshme për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive. Së dyti, në funksion të kësaj premise, kompetencat që i janë dhënë këtij institucioni në raport me prokurorinë do të ushtrohen sipas standardeve përkatëse të fushës.

KLP-ja është institucion funksional prej vitit 2018, në konsolidim e sipër të kapaciteteve dhe performancës së saj. Ky institucion është drejt finalizimit të plotë të bazës ligjore për emërimin, transferimet, promovimet, matjen e performancës së prokurorëve, procedimeve disiplinore në sistemin e prokurorisë<sup>11</sup>. Gjithashtu transparenca në vendimmarrje, vlerësohet si një ndër arritjet më të rëndësishme të këtij institucioni. Në vijim të punës së deritanishme, përgjatë kohëzgjatjes së SND II, pritet rritja e kapaciteteve dhe zbatimi i përgjegjësive në raport me prokurorinë me paanësi, bazuar në parimet e meritokracisë. Kjo do të mundësojë arritjen e objektivit për fuqizimin e këtij organi dhe veprimin në përputhje me standardet e fushës. Për këtë Rezultati 1.3.2 është në përputhje me Objektivin 1.3, i pritshëm dhe në koherencë me realitetin.

Ky rezultat është në vijimësi të rezultateve të synuara nga SND I dhe në Planin e Veprimit të SND I për vitet 2019–2021 të SND 1 (konkretisht rezultateve tëmasës 1 të nënobjektivit 1/a, si dhe masës 1 të nënobjektivit 1/b.)

Po kështu, rezultati është rrjedhojë logjike me rezultatet e synuara të Programit 1 “*Administrimi i karrierës së prokurorëve bazuar në performancën profesionale të secilit*” parashikuar nga Plani Strategjik i KLP për vitin 2021-2024.

Sa i takon formulimit, vlen i njëjti sugjerim si për rezultatit më sipër. Mbeten për t’u qartësuar elementët e përcaktuar si komponentë përbërës të kapacitetit të institucionit.

Lidhur më këtë Rezultat, SND II nuk përmban masë konkrete që ndikon në rritjen e kapaciteteve apo lidhur me burimet e KLP-së. Edhe në këtë rast, si për KLGj-në, e vetmja masë e parashikuar i referohet asaj 1.3.1 “*Përfundimi i procedurave të emërimit, promovimit, transferimit të magjistratëve të diplomuar nga SHM*”. KLP, megjithëse ka parashikuar në Planin Strategjik të saj si rezultat të pritshëm “*Administrimin e karrierës së prokurorëve bazuar në performancën profesionale të secilit*”, nuk ka të parashikuara masa konkrete që lidhen drejtpërdrejt me rritjen e kapaciteteve apo burimeve. Për këtë arsye, duhet një koordinim me KLP, mbi masat që do duhet të ndërmerren për realizimin me sukses të të gjithë komponentëve të këtij rezultati.

Ndërkohë vjen i njëjti sugjerim si më sipër mbi indikatorët e matjes së Rezultatit 1.3.2. SND II, aktualisht nuk ka të përcaktuar indikatorë për matjen e këtij rezultati. Edhe në këtë rast mund të shërbejë si indikator: “*% e prokurorëve që besojnë se ata janë emëruar / ngritur në detyrë bazuar në meritokraci dhe sistemin e karrierës*”, i cili, lidhur me pjesën e prokurorisë, do të jepte në mënyrë sasiore dhe cilësore perceptimin mbi arritjen e rezultatit për pjesën e zbatimit të standardeve në ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe do e bënte atë më realist. Për të matur burimet e përshtatshme financiare një indikator mund të ishte “*% e buxhetit të shtetit dedikuar KLP në raport me projektbuxhetin e propozuar prej vetë institucionit*”. Për pjesën e matjes së rritjes së kapaciteteve (aftësitë) si indikator mund të shërbente “*% e këshilltarëve/administratës së KLP-së që janë trajnuar mbi detyrat e tyre funksionale*”. Ndërkohë indikatorë të tjerë, që do të tregojnë shkallën e përmbushjes së këtij rezultati, do të jenë në varësi të masave të cilat duhet të parashikohen për rritjen e kapaciteteve dhe infrastrukturës.

---

<sup>11</sup>Shih Raportin Vjetor të KLP për vitin 2020 të KLP, fq 9-10

**Konkluzion:** Rezultati është i pritshëm dhe i përgjigjet objektivit 1.3. Ai duhet të qartësojë elementet që nënkuptojnë kapacitetet, me qëllim kuptimin më të qartë të tij, si dhe për identifikimin e masave dhe indikatorëve për matjen e tyre, të cilat do ta bënin këtë rezultat realist. Gjithashtu hartuesit duhet të konsultojnë me KLP masat që do të shërbejnë për arritjen e këtyre rezultateve. Gjithashtu, sugjerojmë që për monitorimin e këtij rezultati të përfshihen si indikatorë: “% e prokurorëve që besojnë se prokurorët janë emëruar / ngritur në detyrë bazuar në meritokraci dhe sistemin e karrierës”, “% e buxhetit të shtetit dedikuar KLP-së në raport me projektbuxhetin e parashikuar dhe propozuar prej vetëinstitucionit”, si dhe “% e këshilltarëve/administratës së KLP-së që janë trajnuar mbi detyrat e tyre funksionale”.

### **Masa 1.3.1**

*“Përfundimi i procedurave të emërimit, promovimit, transferimit të magjistratëve të diplomuar nga SHM”*

Kjo masë është e vlefshme për të dyja rezultatet 1.3.1 dhe 1.3.2, nisur nga fakti se gjyqtarët dhe prokurorët emërohen, promovohen, transferohen respektivisht nga KLGJ dhe KLP pas diplomimit të tyre nga SHM. Kjo masë nga mënyra sesi është hartuar ngjan më tepër me një rezultat sesa një masë në vetvete, e për këtë duhet të riformulohet. Së pari, procesi i emërimit, promovimit apo transferimit të magjistratëve është një proces i vazhdueshëm dhe i përvitshëm dhe duhet të rishkruhet për të shmangur natyrën e saj si një proces i vetëm (që vjen prej përdorimit të fjalës “përfundimi”). Së dyti, kryerja e procedurave të emërimit, promovimit, transferimit të magjistratëve të diplomuar nga SHM, përbën një detyrë funksionale bazë të këtyre institucioneve dhe jo detyrimisht çon në arritjen e rezultatit për kryerjen e kësaj detyre (emërimit, promovimit, transferimit të magjistratëve të diplomuar nga SHM) sipas standardeve. Së treti, rezultati 1.3.1 dhe 1.3.2 fokusohet ndër të tjera edhe tek kapacitetet dhe burimet e institucioneve të KLGJ dhe KLP dhe kjo masë e vetme nuk përmbush Rezultatet e mësipërme në tërësinë e tyre. Për këtë arsye, duhet të shoqërohet me masa që çojnë në rritjen e burimeve dhe kapacitetet në të gjithë elementët apo komponentët që përmendin Rezultatet 1.3.1 dhe 1.3.2 dhe Objektivi 1.3. Aktualisht masa të tilla konkrete nuk ka në Planin Strategjik të KLP, ndërkohë që Plani strategjik i KLGJ është në fazën e hartimit.

Një masë e cila mund të ndikonte në emërimin, promovimin dhe transferimin e magjistratëve sipas rregullave dhe standardeve të kërkuara dhe të miratuara mund të jetë: *Rritja e transparencës së vendimmarrjes në procesin e emërimeve, transferimit dhe promovimeve të tyre.* Një masë e tillë është e parashikuar aktualisht në Plan Veprimin e SND I për vitin 2018-2021.

Gjithashtu, pavarësisht se rezultatet fokusohen vetëm tek kapacitetet e KLGJ dhe KLP, situata aktuale në të cilën gjendet sistemi gjyqësor dhe i prokurorisë, si pasojë e uljes së numrit të përgjithshëm të magjistratëve, si dhe për shkak të mosmiratimit ende të hartës gjyqësore, mund të rezultojë në mosarritjen e rezultateve të mësipërme vetëm me këtë masë. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh se këtë vit (2021) nuk do të ketë emërimet fillestare nga KLGJ dhe KLP për shkak të mospasjes së pranimeve për këtë qëllim në vitin 2018-2019. Përrjashtim bëjnë këshilltarët ligjorë, të cilët e kanë kryer kursin 1 vjeçar.

**Konkluzion:** Duhet parë mundësia e riformulimit të kësaj mase për t'a përshtatur me Rezultatet 1.3.1 dhe 1.3.2, konkretisht, me kryerjen e aktiviteteve të KLGJ-së dhe KLP-së për emërimin, promovimin dhe transferimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe/ose të këshilltarëve ligjorë sipas rregullave dhe standardeve të kërkuara dhe të miratuara . Gjithashtu, kjo masë duhet të shoqërohet me masa shtesë që synojnë konsolidimin e institucioneve si në drejtim të kapaciteteve ashtu edhe burimeve dhe transparencës. Lidhur me këtë të fundit sugjerojmë të përfshihet si

masë“Bërja transparente e procesit tëvendimmarrjes lidhur me emërimet, transferimet dhe promovimet e magistratëve”.

### Rezultati 1.3.3

*“Kapacitetet e ILD-së (duke përfshirë proceset, aftësitë dhe menaxhimin) dhe burimet (financiare, pajisje dhe infrastrukturë) janë forcuar dhe konsoliduar dhe ky institucion ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur, efikase dhe profesionale, duke zhvilluar procesin e verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare. Këto aktivitete do të kryhen siç do të shihen të nevojshme për funksionimin e duhur të gjyqësorit dhe të prokurorisë dhe në përputhje me kërkesat ligjore, kuadrin rregullator dhe standardet e kërkuara.”*

Edhe ky rezultat, ashtu si dy të tjerët më sipër, lidhet me prezumimin se me përmbushjen e Objektivit 1.3 rezultati i pritshëm për ILD-në do të orientohet në tre drejtime. Së pari, kapacitetet dhe burimet e ILD do të jenë të përshtatshme për të zhvilluar aktivitetin sipas kuadrit kushtetues dhe ligjor. Së dyti, bazuar në këto premisa ky institucion do të kryejë funksionet e tij në mënyrë të pavarur, efikase dhe profesionale, duke zhvilluar procesin e verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare. Së treti, (megjithëse nuk rezulton qartë) veprimtaria e këtij institucioni do të ndikojë në funksionimin e gjyqësorit dhe prokurorisë, sipas legjislacionit dhe standardeve të kërkuara përkatëse që lidhen me llogaridhënien. Lidhur me këtë të fundit do të sugjerohet qëllimet e gjyqësorit të përfshihen në Objektivat dhe Rezultatet e parashikuara në funksion të Qëllimit të Politikës 2, e cila i dedikohet performancës së sistemit gjyqësor. Gjithashtu, fjalia e fundit mban parashikime të përgjithshme dhe paqarta. Duket sikur pjesa “siç do të shihen të nevojshme”, lë një marzh subjektiviteti për ILD- në, edhe pse mund të mos jetë ky qëllimi. Për këtë arsye, fjalia e tretë mund të rishikohet në funksion të qartësisë së saj, por edhe pa tejkalar Qëllimin e Politikës 1 dhe Objektivin Specifik 1.3.

Sa i takon formulimit të këtij rezultati, vlen i njëjti sugjerim si për dy rezultatet paraardhëse. Mbeten për t’u qartësuar elementët e përcaktuar si komponentë përbërës të kapacitetit të institucionit.

ILD është institucion i ngritur dhe funksional prej shkurtit të vitit 2020. Gjatë kësaj faze fillestare të funksionimit të tij është plotësuar pjesërisht organika me inspektorë dhe ndërkohë është thuar se plotësuar organika me stafin administrativ. Gjithashtu ILD ka plotësuar në një masë të madhe bazën ligjore të organizimit, funksionimit të saj dhe ushtrimit të kompetencave të dhëna nga ligji dhe Kushtetuta. Po ashtu janë ndërmarrë një sërë aktesh dhe masash për adresimin e backlog-ut të trashëguar nga KLD<sup>12</sup>. Në këtë moment është e rëndësishme ngritja e mëtejshme e kapaciteteve të institucionit dhe performanca në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare. Në këtë aspekt Rezultati i parashikuar duket koherent dhe i domosdoshëm.

Pavarësisht pasaktësive të lartpërmendura, Rezultati 1.3.3 përmban një rregullim që është në linjë vazhdimësie me parashikimet e SND I. Ai është vijim logjik i arritjes së objektivave të parashikuar në “Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020 -2022”, si dhe të një sërë masash të parashikuara në këtë të fundit, me qëllim arritjen e këtyre objektivave.

Sa i përket masave të këtij rezultati, SND II ka parashikuar një sërë të tillash që mundësojnë realizimin e tij. Siç do të analizohet në vijim, duhet të vlerësohet koherenca e

<sup>12</sup>Shih për më tepër: <https://ild.al/sq/legjislacion/akte/>

këtyre masave në raport me parashikimet strategjike dhe shkallën e realizimit të tyre në Planin e Veprimit të ILD-së, me qëllim që të kemi një koherencë më të madhe midis këtyre dy dokumenteve strategjike dhe për t'i bërë rezultatet sa më realiste.

Për arritjen e këtij Rezultati SND II, parashikon dy indikatorë: Së pari, “% e procedurave të filluara disiplinore për ankesat kundër gjyqtarëve ose prokurorëve” dhe, së dyti, “Treguesi i zgjidhjes së çështjeve të prapambetura për disiplinën e ankesave të paraqitura në ILD”. Të dy këta tregues masin eficiencën e këtij organi, por nuk japin të dhëna të plota mbi zbatimin e standardeve nga ana e tij. Ashtu si tek Rezultatet më sipër, si indikator mund të shërbenin sondazhet e kryera me trupën e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të llogaritur përqindjen e atyre që mendojnë se ILD ka ose nuk ka respektuar gjatë standardet në procesin e verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit. Ndërkohë masa dhe tregues për pjesën e konsolidimit të kapaciteteve dhe burimeve gjejmë në Planin e Veprimit të Zyrës së ILD.

**Konkluzion:** Rezultati është i domosdoshëm dhe i përgjigjet Objektivit Specifik 1.3. Ai duhet të qartësojë elementet që nënkuptojnë kapacitetet, me qëllim kuptimin më të qartë të tij, si dhe për identifikimin e masave dhe indikatorëve për matjen e tyre. Gjithashtu për t'a bërë sa më realist këtë rezultat duhet një koherencë më e madhe mes masave të parashikuara për arritjen e tij dhe afateve të parashikuara në Planin e Veprimit të ILD apo shkallës së realizimit të tyre. Ndërkohë që masa dhe tregues për pjesën e konsolidimit të kapaciteteve dhe burimeve gjejmë në Planin e Veprimit të Zyrës së ILD, sugjerojmë që, në kuadër të monitorimit të zbatimit të SND II, të përfshihet si indikator (bazuar në sondazhet e kryera me trupën e gjyqtarëve dhe prokurorëve) “përqindja e gjyqtarëve/prokurorëve që mendojnë se ILD ka/nuk ka respektuar gjatë standardet në procesin e verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit”.

### Masa 1.3.2

*“Përfundimi i procedurave të emërimit të inspektorëve magistratë dhe jo-magjistratë pranë ILD, si dhe përfundimi i rekrutimeve të stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*

Masa e lartpërmendur, së bashku me ato të renditura më poshtë përbëjnë hapat e nevojshëm që duhen ndjekur në funksion të realizimit të Rezultatit 1.3.3. Ajo duhet të ndërmerret me qëllim përmbushjen e Rezultatit 1.3.3 dhe arritjen e synimeve të Objektivit Specifik 1.3.

Masa 1.3.2, e renditur e para ka, të bëjë me përfundimin e procedurave të rekrutimit të stafit (emërim të inspektorëve magistrat/jo magistrat si dhe të administratës mbështetëse). Pa plotësimin e vakancave në burimet njerëzore, ILD nuk mund të jetë tërësisht funksionale në kryerjen e kompetencave që i ka caktuar ligji. Kjo masë krijon vijim të natyrshëm edhe me masat (aktivitetet) që ishin parashikuar në SND I, ku në aktivitetin 1.03 parashikohej rekrutimi i punonjësve<sup>13</sup>. Edhe SND I e ka vlerësuar se rekrutimi së bashku me infrastrukturën (godina duke përfshirë mobilimin, pajisjet përkatëse të IT) janë kushte bazë për krijimin dhe funksionimin e institucionit. Ndërkohë kjo masë është në koherencë me masën “Plotësimi i vendeve vakante në Institucion”, parashikuar në kuadër të Objektivit Specifik 1.2 “Sigurimi i autonomisë financiare dhe administrative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” të parashikuar në Planin e Veprimit të këtij Institucioni. Afati për realizimin e kësaj mase sipas Plan veprimit të ILD është 2020-2021. Për këtë arsye, duhet rivlerësuar përmbushja e saj në përputhje me gjendjen aktuale. Ndërkohë ILD ka dhe indikatorë për matjen e saj, të dhënat e të cilëve mund të huazohen për matjen e realizimit të saj.

<sup>13</sup>[https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/278-2016\\_fletore\\_zyrtare\\_SND.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/278-2016_fletore_zyrtare_SND.pdf)

**Konkluzione:** Duke qenë se ILD ka ende vakanca në strukturën e saj, si për inspektorë ashtu edhe për staf administrativ, masa vlerësohet si e duhur dhe në përputhje me situatën aktuale me qëllim arritjen e rezultatit të kërkuar për ILD-në.

### Masa 1.3.3

*“Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të inspektorëve të drejtësisë nëpërmjet trajnimeve specifike për pozicionet e punës”.*

Masa 1.3.3 përbën hapin e mëtejshëm që lidhet me rritjen e kapaciteteve të inspektorëve/stafit. Është shumë e rëndësishme që stafi të njohë mirë dhe të kuptojë drejtë kuadrin ligjor, metodologjinë e inspektimit, teknikat e hetimit, etj. Kjo mund të arrihet nëpërmjet trajnimeve të dedikuara për aspekte të ndryshme të punës në varësi edhe të detyrës përkatëse (inspektime të menjëhershme në raste dyshimesh shkeljesh etiko-profesionale apo inspektimet tematike që duhen parashikuar kohë më parë). Gjatë vitit të parë të ekzistencës, ILD ka organizuar dhe ka përfituar nga donatorë të ndryshëm shumë trajnime të dedikuara për kuptimin e drejtë të katalogut të shkeljeve disiplinore, standarteve të GJEDNJ-së për procedurat disiplinore ndaj magjistratëve, etj. Me kalimin e kohës, numri i lartë i trajnimeve gjatë viteve të para të ekzistencës së institucionit, natyrshëm do të fillojë të ulet, pasi konsiderohet që stafi është trajnuar në nivel të kënaqshëm për të ushtruar detyrat. Në këtë aspekt rëndësi i duhet kushtuar trajnimeve vijuese mbi rritjen e performancës dhe efikasitetit, në përputhje me nevojat. Kjo masë përkon me Objektivin Specifik 1.5 *“Rritja e njohurive dhe aftësive profesionale të inspektorëve dhe nëpunësve civilë, në mënyrë që secili prej tyre, në pozicionin përkatës, të përmbushë në mënyrë eficiente detyrat e tij funksionale”* të Planit Strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020 -2022. Ndërsa aktiviteti *“Ngritje e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve specifike për pozicionet e punës”*, shihet si një masë që ka afat të fundit 2021, ndërkohë që bashkëpunimi me ASPA, Shkollën e Magjistraturës dhe ekspertët e huaj për ofrimin e trajnimeve dhe konceptimi i termave të trajnimit shihen si aktivitete vijuese.

Në këtë aspekt mund të themi që ngritja e kapaciteteve është drejt realizimit, ndërkohë që objektiv mund të jetë forcimi i mëtejshëm i kapaciteteteve nëpërmjet trajnimeve vazhduese lidhur me rritjen e performancës së stafit.

**Konkluzion:** Nisur nga sa më sipër, mund të jetë e nevojshme të riformulohet masa duke patur parasysh jetëgjatësinë e ILD-ë, dhe momentin e miratimit të SND II, pasi kjo mund të përbëjë një masë të përmbushur pjesërisht dhe që nuk ka relevancën që mund të mendohej që kishte, sidomos për pjesën e ngritjes së kapaciteteve. Për rrjedhojë, kjo masë mund të zëvendësohet me një masë më realiste që lidhet me trajnimet e vazhdueshme për forcimin dhe rritjen e mëtejshme të kapaciteteve. Për më tepër që synimi i SND II sipas hartuesve të saj është të mos dublojë masat e strategjive sektoriale<sup>14</sup>.

### Masa 1.3.4

*“Përgatitja e raporteve të analizës së grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit”.*

Në pikën 1.3.4 vlerësohet si masë e nevojshme kategorizimi i ankesave të mbartura. Kjo nuk është gjë tjetër veçse hartimi i një metodologjie për adresimin e backlog-ut. Nga mënyra se si është formuluar duket sikur ka një mbivendosje me masën 1.2.12 të përmendur

---

<sup>14</sup>Shih SNDII, faqe

më sipër (1.2.12 “Përgatitja e një plani operacional të ILD-së për trajtimin e ankesave të prapambetura”).

Gjithashtu kjo masë përkon edhe me Planin Strategjik të ILD 2020-2022, konkretisht me masën 1 “Ngritja e grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera”, si dhe “Shqyrtimi me prioritet i ankesave sipas gjetjeve të grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit,” të cilat janë në përmbushje të Objektivit Specifik 2.4 “Rritja e numrit të ankesave të trajtuara në përputhje me afatet ligjore. Këto masë janë përkatësisht me afat përfundimtar dhjetor 2020 dhe mars 2021. Për këtë arsye duhet rishikuar relevanca e masës 1.3.4 me veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe gjendjen aktuale të trajtimit të backlog-ut.

Gjithashtu sugjerojmë që strategjia duhet të ndajë në objektiva të posaçëm, llogaridhënien e gjyqësorit, pjesë e të cilës janë dhe vendimet e marra në kuadër të proceseve disiplinore, adresimi i ankesave, shqyrtimi i backlog-ut, me vetë rritjen e kapacitetit të ILD-s-së dhe kryerjen e veprimtarisë sipas standardeve. Kërkohej një ndarje më e qartë mes Objektivit 1.3 dhe llogaridhënies së gjyqësorit të përfshirë në masat në kuadër të Objektivit 2.4.

**Konkluzion:** Për sa më sipër sugjerohet rishikim/riformulim i kësaj mase në raport me masën 1.2.12 si dhe me masat e parashikuara në Planin Strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020 -2022, për të shmangur çdo paqartësi në zbatim, si dhe për relevancë me gjendjen aktuale. Gjithashtu sugjerojmë një ndarje më të qartë mes Objektivave, Masave dhe Rezultateve që lidhen me forcimin e kapaciteteve të ILD-së, me ato që lidhen me llogaridhënien e gjyqësorit (qëreflektohet ndër të tjera edhe në vendimet e dhëna nga ILD për shkeljet disiplinore), të parashikuara në kuadër të Qëllimit të Politikës 2.

### Masa 1.3.5

*“Përgatitja e ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin infrastrukturor dhe logjistik të ILD për pajisjen me ambiente pune/logjistike për të gjithë numrin e punonjësve të ILD”.*

Siç u tha më sipër, ILD ka vetëm diçka më shumë se ‘një vit jetë’. Masa tjetër, 1.3.5 ka të bëjë me aspekte infrastrukturorë dhe logjistike. Garantimi i infrastrukturës së nevojshme është thelbësor në ushtrimin e funksioneve, duke pasur parasysh problematikat që kanë hasur shumë institucione të qeverisjes së sistemit në fillimet e veprimtarisë së tyre. Kjo masë shkon në harmoni me masat e lartpërmendura dhe lidhet me aktivitetin 1.03 a. të SND I.

Edhe pse kjo masë është në vetvete e nevojshme, lind pyetja sa relevante është kjo aktualisht duke pasur parasysh që ILD ka tashmë godinën e saj me elementët infrastrukturorë të nevojshëm. Për më tepër në Planin e Veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022 masat nën Objektivin Specifik 1.1 “Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të hapësirave mjedisive, pajisjeve dhe kushteve të punës” janë me afat dhjetor 2020, mars 2021 dhe mars 2022. Prandaj kjo masë duhet të rishihet në raport me masat dhe afatet e parashikuara në Plan Veprimin e ILD-së me qëllim relevancën në mes dy dokumentave, si dhe me gjendjen aktuale.

**Konkluzion:** Sugjerohet të vlerësohet relevanca e kësaj mase përkundrejtë zhvillimeve dhe ecurisë kohore që prej krijimit të ILD-së, si dhe për mos krijuar mbivendosje me masat e parashikuara në Planin Strategjik të ILD-së.

## Qëllimi i Politikës 2

*“Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane”.*

Qëllimi i Politikës 2 lidhet me efektin që ka sjellë në gjyqësor reforma në drejtësi. Meqenëse në Qëllimin e Politikës 1 është siguruar një mekanizëm i ri, i ndryshëm nga i mëparshmi, i analizuar si problematik pasi nuk siguronte paanësi, efikasitet, transparencë, llogaridhënie, etj., mekanizmi i ri, nëpërmjet institucioneve të reja dhe ligjeve të reja, do të duhet të ketë efekte pozitive në sistemin gjyqësor.

Këto efekte të dëshiruara shprehen qartë në Qëllimin e Politikës 2 dhe lidhen me performancën e gjyqësorit në tërësi. Gjyqësori do të duhet të ndërtojë një marrëdhënie sa më transparente me publikun dhe përdoruesit e tij, të jetë i aksesueshëm për palët, të veprojë shpejt në kohë dhe të jetë efikas. Gjithashtu, Qëllimi i Politikës 2 orienton se në përmbushjen e këtyre standardeve do të duhet të merret parasysh ligji shqiptar dhe standardet evropiane.

SND I parashikonte një objektiv strategjik thuajse të njëjtë, Objektiv Strategjik 3: “Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane”. Ky parashikim duket se përshtatet plotësisht me linjën e ndjekur nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020, sipas të cilës, gjyqësori duhet të ishte transparent dhe duhet të fitonte besimin e publikut. Megjithatë, SND I, nën këtë objektiv strategjik, parashikonte edhe masa që lidheshin me aksesin e publikut<sup>15</sup>. Ndërkohë që në Strategjinë e re është hartuar një objektiv specifik më vete, Objektiv Specifik 2.3, i cili lidhet vetëm me rritjen e profesionalizmit të gjyqësorit. Pra, duket se në Strategjinë e re, kërkesa që është shtuar ndaj gjyqësorit lidhet me rritjen e aftësisë profesionale të tij, gjë që duhet të ishte shprehur edhe në formulimin e Qëllimit të Politikës 2. Kjo është një kërkesë tejet e rëndësishme dhe me pasoja afatgjata dhe parashikimi i saj në mënyrë të shkruar, e më tej zberthimi i saj në objektiva dhe masa konkrete, është i domosdoshëm.

Rëndësia e kësaj politike vihet re edhe në përcaktimin e pesë objektivave specifikë<sup>16</sup>, katër prej të cilëve do të analizohen në vijim për shkak të rëndësisë së tyre për funksionimin e sistemit të drejtësisë. Ky studim nuk ka marrë në analizë vetëm objektivin që lidhet me

---

<sup>15</sup>SND I, në objektivin strategjik 3, parashikonte disa masa: ‘3.01.Përmirësimi i legjislacionit me qëllim përmirësimin e efikasitetit të procedurave gjyqësore në veçanti nëpërmjet: -përmirësimit të sistemit të njoftimeve;-sigurimit të mjeteve që parandalojnë shtyrjen e gjykimeve,- futjes së procedurave të përshpejtuara; - kriterëve të filtrimit; -kërkimit të arsytimit në të njëjtën kohë me vendimin e gjykatës / me shpalljen e vendimit; 3.02.Krijimi i një sistemi të arsyeshëm dhe proporcional të tarifave gjyqësore për të siguruar financimin e shërbimeve të drejtësisë, si dhe garantimin e aksesit në gjykatë; 3.03. Krijimi i një sistemi të drejtë dhe funksional të ndihmës juridike falas për individët dhe grupet në nevojë; 3.04. Përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet gjykatës dhe medias dhe sigurimi i aksesit të publikut tek informacioni në rastet e interesit publik”;

<sup>16</sup>Politika 2, Objektiv specifik 2.1 “Objektiv Specifik 2.1. Rishikimi i kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe efikasitetin”; Objektiv specifik 2.2 “Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese (GJK), sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj profesional, në mënyrë transparente dhe efektive”; Objektiv specifik 2.3 “Rritja e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë, duke siguruar një numër të përshtatshëm të magistratëve dhe këshilltarëve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri”; Objektiv specifik 2.4 “Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët” dhe Objektiv specifik 2.5 “Aksesi efektiv në drejtësi i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme”.

Gjykatën Kushtetuese, për shkak të karakterit të saj të veçantë jashtë sistemit gjyqësor tre shkallësh dhe rregullave të veçanta që lidhen me gjykimin në GjK.

Nisur nga mënyra se si është formuluar, duket se fokusi i këtij qëllimi politik është 'gjyqësori' dhe jo 'sistemi i drejtësisë', edhe pse ekziston njëlidhje me prokurorinë dhe organizmin e saj, si përshembull në rastin e miratimit të hartës gjyqësore, e cila impakton drejtpërdrejtë edhe funksionimin e prokurorisë.

**Konkluzion:** *Qëllimi i Politikës 2 ka një peshë të vecantë në Strategji dhe një rëndësi të madhe për këtë studim, për shkak të rezultateve konkrete që kërkon përmbushja e tij. Për këtë arsye, sugjerohet të plotësohet formulimi i tij me kërkesën për profesionalizëm të gjyqësorit.*

## Objektivi specifik 2.1

*"Rishikimii kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin, sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe eficientë".*

Objektivi 2.1 parashikon momentin e parë të ndërhyrjes që duhet bërë në funksion të rritjes së performancës së gjyqësorit dhe në funksion të aksesit në gjyqësor dhe që lidhet me rishikimin e gjithë ligjeve që prekin apo ndikojnë në zbatimin e këtyre parimeve. Ligji është mjeti i parë, në dorë të organit dhe të individit, që parashikon detyrimet dhe garanton të drejtat në përmbushjen e këtyre detyrimeve. Parimet apo standardet që kërkon të vendosë për sistemin gjyqësor ky objektivi kërkojnë që të bëhet një vlerësim i thelluar i një numri të madh ligjesh, materiale dhe procedurale, dhe në pjesën më të madhe, ligje organike, të një rëndësie themeleore për të drejtën në Shqipëri. Njëketo ligje duhen identifikuar se cilat janë ato rregullime që ndikojnë në rritjen e aftësisë profesionale të gjyqësorit, ato që ndikojnë në aksesin në gjyqësor, ato që lidhen me transparencën dhe ato që e bëjnë sistemin të jetë më eficient. Kjo nuk është një detyrë e lehtë, kur kihet parasysh se këto parime qëndrojnë në dispozita që jo detyrimisht i referohen parimit, por qëndrojnë në konceptin e zgjidhjeve që ligjvënësi i ka dhënë instituteve të ndryshme të së drejtës, dhe shpesh herë dalin e interpretohen nga qëllimi dhe fryma e ligjit.

Në një vështrim të, së paku, ligjeve kryesore që rregullojnë këto parime, arrijmë të identifikojmë disa prej tyre. Kështu, çështjet që lidhen me aftësitë profesionale, do të duhet të kërkojnë në ligjet që rregullojnë kushtet dhe kriteret për të qenë gjyqtar/prokuror, trajnimin, karrierën, vlerësimin, etj. Këtu merret parasysh ligji 115/2016 dhe ligji 96/2016. Gjithashtu, çështjet e profesionalizmit të gjyqësorit lidhen edhe me profesionalizmin e administratës gjyqësore, duke nisur nga kancelari, si nëpunësi më i lartë gjyqësor, e deri tek çdo nëpunës që e ka statusin e nëpunësit civil gjyqësor.

Çështjet që lidhen me aksesin në gjykatë dhe transparencën janë çështje që lidhen me ligjet procedurale (Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative), ndërsa për gjykimin në Gjykatën Kushtetuese janë çështje që lidhen me ligjin "Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

Ndërsa çështjet që lidhen me eficientë janë si çështje të ligjeve procedurale, ashtu edhe të ligjeve materiale (Kodi Civil, Ligji për Shoqëritë Tregtare), pasi këto të fundit parashikojnë mjete të posaçme që mund të përdoren nga palët/gjykata dhe që lidhen me eficientë e gjykatës. Gjithashtu, eficientë rregullohet edhe nga ligjet mbi organizimin e gjyqësorit apo prokurorisë (Ligji 115/2016, Ligji 98/2016, Ligji 97/2016).

Pra, vërehet se kuadri ligjor, i cili do të duhet të rishikohet për të parë mundësinë e përmirësimit të tij në funksion të transparencës, aksesit, eficientë dhe cilësisë në gjyqësor, është shumë i gjerë. Megjithatë, rëndësia që dikton ky proces dhe nevoja që këto ligje të jenë të

harmonizuara, si ndërmjet tyre, edhe me standardet ndërkombëtare, e bën të nevojshme që kjo analizë të jetë sa më e plotë dhe sa më shteruese.

Lidhur me koherencën e këtij Objektiv, duke qenë se në maj 2021 hynë në fuqi ndryshimet e fundit, të cilat prekën një pjesë të madhe të këtyre ligjeve të lartpërmendura dhe kishin në fokus, në vecanti, mirëfunksionimin, zhbllokimin dhe bërjen e gjyqësorit eficient, edhe me pak burime, duhet thënë se ky kontroll do të duhet të nisë të paktën në vitin 2023, duke lënë hapësirën e nevojshme që ndryshimet që iu bënë ligjeve të japin efektet e tyre.

Për përmbushjen e këtij objektiv janë parashikuar dy Rezultate: i pari lidhet me rishikimin e disa ligjeve procedurale dhe materiale që ndikojnë në vendimmarrje dhe në procedurën e ndjekur nga gjyqtari, pra kompetenca tërësisht gjyqësore, dhe; i dyti lidhet me rishikimin e ligjeve mbi organizmin e pushtetit gjyqësor dhe plotësimin e disa hapësirave me akte nënligjore që lidhen me funksionimin e gjykatave në aspektin institucional, duke pasur në vëmendje administratën gjyqësore.

Ky parashikim është i saktë pasi, sic është analizuar më lart në pjesën e analizës së Qëllimit të Politikës 2, synimet që kërkohet të arrihen përmes saj përfshijnë ligje të natyrave të ndryshme. Analiza e tyre më vete ndihmon në kuptimin, strukturimin dhe nxjerrjen e rekomandimeve mbi ndryshime të mundshme.

**Konkluzion:** *Parimet apo standardet që kërkon të vendosë për sistemin gjyqësor ky objektiv kërkojnë që të bëhet një vlerësim i thelluar i një numri të madh ligjesh, materiale dhe procedurale, dhe në pjesën më të madhe, ligje organike, të një rëndësie themeleore për të drejtën në Shqipëri. Rëndësia që dikton ky proces dhe nevoja që këto ligje të jenë të harmonizuara, si ndërmjet tyre, edhe me standardet ndërkombëtare, e bën të nevojshme që kjo analizë të jetë sa më e plotë dhe sa më shteruese. Duke qenë se në maj 2021 hynë në fuqi ndryshimet e fundit, të cilat prekën një pjesë të madhe të këtyre ligjeve dhe kishin në fokus, në vecanti, mirëfunksionimin, zhbllokimin dhe bërjen e gjyqësorit eficient, edhe me pak burime, ky kontroll do të duhet të nisë të paktën në vitin 2023, duke lënë hapësirën e nevojshme që ndryshimet që iu bënë ligjeve të japin efektet e tyre. Për përmbushjen e këtij objektiv janë parashikuar dy Rezultate, të cilat nëse do të plotësohen më tej (shih analizën e rezultateve më poshtë) dhe do të arrihen, e përmbushin plotësisht Objektivin Specifik 2.1.*

### Rezultati 2.1.1

*“Kodi i Procedurës Civile, Ligji për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe Kodit Familjes të rishikuar për të rritur transparencën dhe efikasitetin dhe për të siguruar aksesueshmërinë, duke dekurajuar paraqitjen e çështjeve të pabazuara”.*

Rezultati 2.1 kërkon që të realizohet një rishikim i disa ligjeve procedurale dhe materiale për të riparë dispozitat që parashikojnë respektimin e parimit të transparencës, dispozitat që rregullojnë çështjet e aksesit në gjykatë, apo dispozitat që lidhen me bërjen e gjykatës efikase, përfshirë rastet kur gjykata pengohet për të qenë efiçente për shkak të kërkesave të pabazuara në merita dhe që vonojnë punën e saj.

Ky rezultat është në përputhje me objektivin që synohet të arrihet, por nuk është i plotë kur iu referohet ligjeve që do të duhet të analizohen, në mënyrë që të plotësohet përmbushja e një komponenti të Objektivit Specifik dhe Qëllimit të Politikës 2.

Kështu, ky rezultat parashikon rishikimin e Kodit të Procedurës Civile, Ligjit për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe Kodit të Familjes, por nuk parashikon ligje të tjera bazë që do të duhet domosdoshmërisht t'i nënshtrohen rishikimit për të parë ndikimet që mund të ketë në rregullimet që lidhen me transparencën, aksesin dhe efikasitetin. Të tilla ligje bazë janë Kodi i Procedurës Penale, Kodi Civil dhe Ligji “Për shoqëritë

tregtare". Të tre këto ligje parashikojnë dispozita specifike që rregullojnë çështjet që synon Rezultati 2.1. E ndërsa për Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Civil nuk ka asnjë dyshim se pse duhet të jenë pjesë e rishikimit, për shkak të rolit të tyre primar në rregullimin e procesit gjyqësor, në balancimin e të drejtave të palëve dhe gjykatës, në konceptimin dhe dhënien jetë të parimeve nëpërmjet rregullave të detyrueshme, afatave, njoftimeve, penaliteteve, etj., vlen të theksohet edhe arsyeja për të cilën duhet t'i ishte nënshtruar të njëjtës analizë edhe Ligji "Për shoqëritë tregtare". Së pari, sepse ky ligj, përveçse është ligj material, përmban dispozita të caktuara të natyrës procedurale që lidhen drejtpërdrejtë me disponimin e gjykatës, të cilat ndikojnë në efikasitetin e saj, dhe, së dyti, sepse mosmarrëveshjet tregtare përbëjnë një numër të madh të mosmarrëveshjeve para gjykatës, gjë që e shton ndikimin e rregullave që e normojnë ecurinë e gjyqësorëve për këto mosmarrëveshje.

**Konkluzion:** Ky rezultat është në përputhje me objektivin që synohet të arrihet, por nuk është i plotëkur iu referohet ligjeve që do të duhet të analizohen. Ai nuk ka parashikuar të gjithë ligjet që kanë ndikim thelbësor në përmbushjen e tij, të tilla si Kodi i Procedurës Penale, Kodi Civil dhe Ligji "Për shoqëritë tregtare". Njëherësh me parashikimin e tyre, në Rezultat duhet të ishin parashikuar edhe masat konkrete për rishikimin e këtyre ligjeve, në mënyrë të ngjashme me masat e parashikuara për ligjet që janë afishuar tashmë si pjesë e Rezultatit.

### Masa 2.1.2

*"Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të KPrC".*

Kjo masë parashikon hapat që duhet të ndiqen nga Ministria e Drejtësisë për të ndryshuar Kodin e Procedurës Civile me synim për të lehtësuar, ndihmuar dhe nxitur bërjen efektive të disa parimeve që kërkohen nga ky kod, por edhe nga sistemi i drejtësisë në përgjithësi dhe që lidhen me transparencën, aksesin në gjykatë dhe efikasitetin gjyqësor.

Kjo masë është e domosdoshme për t'u realizuar në përmbushje të Rezultatit 2.1 pasi ligji është kufizimi i parë i funksionimit në praktikë të këtyre parimeve. Kështu, dispozitat që lidhen me njoftimet, afatet e ngritjes së kërkesave, afatet e ankimeve, kushtet e depozitimit të padive, vendimet e ndërmjetme gjatë procesit gjyqësor, rastet e konflikteve të kompetencave, mjetet që disponon gjykata ndaj disponimeve abuzive të palëve, parashikimet lidhur me tarifat gjyqësore, marrëdhëniet me palët e treta në proces, si mbrojtësit, etj., ndikojnë drejtpërdrejtë në bërjen efektive të gjykatave, rritjen e aksesit në to dhe veprimet të tyre në kushtet e një transparence të plotë ndaj përdoruesit të gjykatës.

Për realizimin e kësaj mase është parashikuar se do të përmbillet veprimi brenda vitit 2023 dhe, më pas, brenda vitit 2025, do të analizohet sesa efektive ishin ndërhyrjet. Do të ishte më realiste që për realizimin e kësaj mase të parashikohej fundi i vitit 2025 pasi duhen marrë në analizë efektet që do të prodhojnë ndryshimet e fundit të KPrC që hyn në fuqi në maj të vitit 2021, të cilat u realizuan duke pasur si synim rritjen e efektivitetit të gjykatave të të gjitha niveleve, por nga ana tjetër, prekën edhe parimin e kontradiktorialitetit përpara gjykatës, duke lejuar më shumë raste se kur gjykata e realizon procesin në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve. Kalimi i një kohe të arsyeshme, të paktën dy vjetare nga momenti i hyrjes në fuqi të tyre, është e nevojshme për të nisur analizën mbi këto ndryshime, ndërsa analiza e propozimeve të reja mund të jenë gati në mbyllje të vitit 2025.

**Konkluzion:** Kjo masë është e domosdoshme për t'u realizuar në përmbushje të Rezultatit, por afati i vendosur për realizimin e masës duhet të ishte më i gjatë. Kjo lidhet me ndryshimet e KPrC që hynë në fuqi në maj të vitit 2021. Pamjaftueshmëria e kohës për të analizuar ndikimin e ligjit

të ri, e më tej arritja e konkluzioneve, rrezikon që t'a shndërrojë këtë masë në jo-realiste dhe jo-efektive.

### Masa 2.1.5

*“Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të KF”.*

Kjo masë, e njëjtë në formulim edhe në arsyet e parashikimit të saj në përmbushje të Rezultatit 2.1, parashikon hapat që duhet të ndiqen nga Ministria e Drejtësisë për të ndryshuar Kodin e Familjes me synim për të lehtësuar, ndihmuar dhe nxitur bërjen efektive të disa parimeve që kërkohen nga ky kod, i cili ka dispozita edhe të karakterit material, por edhe të karakterit procedural dhe si të tilla ndikojnë në shqyrtimin gjyqësor me eficiencë, në transparencë dhe që i jep akses palëve në proces.

**Konkluzion:** Analiza e KF dhe propozimi i ndryshimeve të mundshme është një masë e domosdoshme pasi KF është komplementar me KPrC në çështje të procesit gjyqësor, dhe ndryshimet në këto kode duhet të ecin paralelisht dhe të jenë të harmonizuara. Duke qenë se KF nuk i është nënshtruar ndryshimeve së fundmi<sup>17</sup>, një analizë e tij, brenda afatit që parashikon masa (2022-2023), vlerësohet e arsyeshme dhe e përshtatshme.

### Masa 2.1.8

*“Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të Ligjit për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

Kjo masë, gjithashtu, është e njëjtë si në formulim edhe në arsyet e parashikimit të saj në përmbushje të Rezultatit 2.1, me dy masat e tjera të analizuar më sipër. Ligji për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative është ligji bazë procedural që rregullon procesin e gjykimit administrativ, gjykim i vecantë në Shqipëri, si për nga karakteristikat e këtij gjykimi, edhe për nga gjykatat kompetente.

Kjo masë parashikon hapat që duhet të ndiqen nga Ministria e Drejtësisë për të ndryshuar këtë ligj me synim për të lehtësuar, ndihmuar dhe nxitur bërjen efektive të gjykatave administrative, rritjen e transparencës dhe forcimin e garancive lidhur me aksesin e palëve në proces. Ajo është e domosdoshme për t'u realizuar në përmbushje të Rezultatit pasi vetë ligji është ai që kufizon, nëpërmjet normimit dhe detyrueshmërisë së tij, të drejtat e palëve dhe përdoruesve të gjykatës administrative, nga njëra anë, dhe të drejtat për të disponuar të gjykatës, nga ana tjetër.

Për realizimin e kësaj mase është parashikuar viti 2023, ndërsa brenda vitit 2025 është planifikuar se do të përmbillet analiza mbi efektivitetin e ndërhyrjeve. Do të ishte më realiste që për realizimin e kësaj mase të parashikohej fundi i vitit 2025, pasi duhen marrë në analizë efektet që do të prodhojnë ndryshimet e fundit të ligjit që hyri në fuqi në maj të vitit 2021, të cilat u realizuan duke pasur si synim rritjen e efektivitetit të gjykatave administrative të dy shkallëve të para dhe Kolegjit administrativ në Gjykatën e Lartë. Kalimi i një kohe të arsyeshme, të paktën dy vjetare nga momenti i hyrjes në fuqi të tyre, është i nevojshëm për të nisur analizën mbi këto ndryshime dhe do të jetë e mundur që vetëm në përfundim të vitit 2025 të mund të dalin konkluzione lidhur me ndryshimet e nevojshme në ligj.

---

<sup>17</sup>Ndryshimet e fundit janë bërë me ligjin nr. 134/2015, date 05.12.2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9062, date 8.05.2003, “Kodi i Familjes”.

**Konkluzion:** Kjo masë është e domosdoshme për t'u realizuar në përmbushje të Rezultatit, por afati i vendosur për realizimin e masës duhet të ishte më i gjatë. Kjo lidhet me ndryshimet e Ligjit për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative që hynë në fuqi në maj të vitit 2021. Pamjaftueshmëria e kohës për të analizuar ndikimin e këtyre ndryshimeve, e më tej arritja e konkluzioneve, rrezikon që ta shndërrojë këtë masë në jorealiste dhe joefektive.

**Konkluzion për të tre masat:** Të tre masat e përfshira në këtë analizë, e marrin vlerën e tyre të vërtetë nëse kalojnë në një proces të gjerë dhe real konsultimi e diskutimi. SND II parashikon që procesi i analizës dhe ndryshimeve të mundshme do të drejtohet prej Ministrisë së Drejtësisë, por do të ketë si institucione pjesëmarrëse edhe KLGJ, KLP, PP dhe gjykatat. Do të jenë shumë të rëndësishme masat reale që do të merren nga MD për të krijuar një bashkëpunim të frytshëm mes këtyre aktorëve. Eksperiencat e ndryshimeve të fundit të majit 2021, nuk ishin shumë pozitive në këtë aspekt, për shkak të ndryshimeve thelbësore nga njëra anë, dhe moskrijimit të bindjes se këto ndryshime erdhën si rrjedhojë e një konsultimi të gjerë, duke pasur parasysh edhe kohën shumë të shpejtë që iu desh MD për t'i hartuar, diskutuar e miratuar. Do të jetë shumë me interes për këtë studim të ndjekë dhe monitorojë hapat konkretë që do të ndiqen për përmbushjen e këtyre masave.

## Rezultati 2.1.2

*“Dispozitat ligjore në lidhje me sistemin gjyqësor të ndryshuara për të lejuar organizimin kompetent, transparent dhe efikas të proceseve gjyqësore dhe për të tërhequr staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Përfshirja e legjislacionit specifik për të siguruar transparencën dhe efikasitetin e proceseve që ndiqen nga administrata gjyqësore, menaxhimin efikas të performancës cilësore të stafit të administratës gjyqësore dhe zotërimi i financimit të mjaftueshëm për çdo mbulim kostosh”.*

Ky rezultat synon përfundimin e kapaciteteve të gjykatës në aspektin institucional. Edhe nga mënyra se si është shkruar Rezultati, arrihen të identifikohen dy qëllime kryesore dhe komplementare që synohen prej tij: së pari, duhet të analizohen, rishikohen dhe ndryshohen ligjet që lidhen me funksionimin e gjyqësorit, dhe së dyti, duhet të nxiten mekanizmat e duhur ligjorë dhe nënligjorë e institucionalë, në funksion të rregullimit dhe menaxhimit të vazhdueshëm të punës së administratës gjyqësore, përfshirë edhe kontrollin e cilësisë.

Ligji bazë që rregullon organizimin dhe funksionimin e sistemit të gjykatave në Shqipëri, organizimin e tyre të brendshëm, funksionimin e administratës së gjykatave dhe statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë është ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Megjithatë, edhe ligje të tjera parashikojnë dispozita komplementare që lidhen me specifika të institucionit që këto ligje rregullojnë. Kështu përsëri, ligji 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” parashikon dispozitë të posaçme për punonjësit e administratës gjyqësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar (neni 44 dhe 45 i ligjit). Gjithashtu, ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon detyrim për kancelarin e gjykatës (nëpunësi më i lartë civil gjyqësor) për të vendosur në dispozicion të nëpunësit përgjegjës që po ushtron kontroll ndaj një magjistrati të caktuar në atë gjykatë, kushtet e nevojshme për ushtrimin e detyrës (neni 91 i ligjit). Një rol shumë të madh në përcaktimin e ecurisë së funksionimit të gjykatave ka edhe KLGJ, e cila përmes akteve me fuqi të përgjithshme dhe udhëzimeve të saj, ka të drejtë dhe detyrim të normojë mënyrën sesi gjykatat do të duhet të veprojnë për çështje të caktuara, apo formën e akteve që ato do të duhet të nxjerrin dhe zbatojnë.

Është e rëndësishme që, pasi ka kaluar një kohë nga hyrja në fuqi e këtyre ligjeve, të analizohen dispozitat që parashikojnë këto ligje se sa përputhen me njëra-tjetrën, sa në harmoni janë dhe se sa janë në gjendje që, duke u përdorur nga organe të ndryshme, të japin produktin e dëshiruar në praktikë. Është po ashtu shumë e rëndësishme që, në zbatim të ligjit, institucionet e ngarkuara të përgatisin bazën nënligjore dhe të sigurojnë procesin e llogaridhënies për nëpunësit civilë gjyqësorë.

Përmbushja e këtij rezultati, sipas planit të masave, do të realizohet në dy pjesë, analiza e ligjit dhe akteve do të bëhet brenda vitit 2021 dhe përgatitja e ndryshimeve ose akteve të reja brenda vitit 2022, ndërkohë që në fund të vitit 2025 është menduar të bëhet analiza e plotë dhe tërësore e akteve të prodhuara, për të parë se sa ato kanë qenë efikase dhe kanë arritur të forcojnë transparencën dhe efikasitetin e gjykatave, si dhe nëse administrata gjyqësore ka arritur të rrisë nivelin e performancës së saj nëpërmjet rritjes së cilësisë në ofrimin e shërbimit/përmbushjen e detyrave.

Kjo ndarje në kohë nuk duket të jetë shumë realiste për shkak se peshën më të madhe në realizimin e këtij rezultati do të duhet t'a mbajnë plotësimi i kuadrit nënligjor dhe rregullimi i kuadrit ligjor ekzistues, në rast se vihen re pengesa që çënojnë mirëadministrimin e gjykatave. Duke pasur parasysh ritmet me të cilat ka vepruar KLGj në nxjerrjen e udhëzimeve për gjykatat<sup>18</sup> dhe gjithashtu, ndryshimet e fundit të ligjeve që hyn në fuqi në maj të vitit 2021 që prekin edhe çështje të karakterit strukturor të gjykatave, për shembull vendosja e figurës së ndihmësit në gjykatat e rretheve gjyqësore, është thuajse e pamundur që të krijohet gjithë kuadri mbështetës në një kohë kaq të shkurtër. Gjithashtu, në funksion të këtij rezultati duhet parë edhe krijimi i hartës së re gjyqësore. Është iluzive të pretendohet se ende pa pasur të qartë shpërndarjen e gjykatave, do të mund të bëhen politika dhe rregulla të përgjithshme e afatgjata me ndikim real në çështjet e administrimit të drejtësisë dhe efikasitetit të gjykatave.

Ajo çfarë dallohet qartë si mangësi në planin e masave që përmbushin këtë rezultat është se asnjë masë nuk parashikon rishikimin e legjislacionit bazë, ashtu sic e kërkon Rezultati dhe Objektivi Specifik të sipëranalizuar. Të gjitha masat e parashikuara i referohen analizës, ndryshimeve dhe plotësimit vetëm të legjislacionit sekondar. Pra, këto masa nuk arrijnë dot t'a plotësojnë tërësisht rezultatin. Nëse marrim vetëm një shembull, plotësimin me staf të kualifikuar të gjyqësorit, kërkesë e këtij rezultati, është e pamundur të pranosh se për të arritur këtë mjaftojnë vetëm ndryshime dhe plotësime të akteve nënligjore, në një kohë që kriteret për pozicionet e punës, trajtimi financiar, etj., janë pjesë e ligjeve bazë. Është me vend të përmendet rasti i ndihmësve ligjorë, vendet vakante për të cilët nuk po arrihet dot të plotësohen, për arsye që, më së shumti lidhen me ligjin, me mënyrën sesi ai e ka rregulluar këtë kategori, duke mos e diferencuar ndjeshëm në hyrjen në sistem nga magjistratët, por duke e diferencuar thelbësisht në trajtimin që i bëhet atij në punë.

**Konkluzion:** Rezultati është në përputhje me Objektivin Specifik 2.1 dhe Politikën 2, por ai nuk është realist për shkak të kohës së shkurtër që i është lënë në dispozicion organeve të plotësojnë kuadrin e tyre nënligjor, për shkak të mosmarrjes në konsideratë të kohës së nevojshme që do të duhet për të prodhuar ndryshimet e bëra rishikimi dhe për shkak të mos-harmonizimit të këtyre afateve me zgjidhjen e çështjes së hartës së re gjyqësore, e cila është kyçe në mirëadministrimin dhe efikasitetin e gjykatave.

---

<sup>18</sup>Vendim i KLGj, nr. 78, datë 30.05.2019 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit"; Vendim i KLGj nr. 47, datë 11.02.2021 "Për miratimin e "Udhëzuesi "Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave".

### Masa 2.1.11

*“Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së rregullave standarde për funksionimin e gjykatave”.*

Kjo masë parashikon që KLGj do të përgatisë, brenda vitit 2022, një paketë rregullash standarde lidhur me procese të ndryshme të administrimit të gjykatave në të gjitha nivelet, duke nisur nga rregullat për caktimin e numrit të gjykatave dhe të gjyqtarëve që do të jenë pjesë e një gjykate (neni 15 dhe neni 22 i ligjit 98/2016), tek rregullat për krijimin e seksioneve dhe trupave gjykues (neni 23 i ligjit 98/2016), rregullat për programin dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short (neni 25 i ligjit 98/2016), rregullat për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës (neni 28 i ligjit 98/2016), rregullat për marrëdhëniet me publikun, etj.

Kjo masë iu referohet vetëm rregullave standarde, vendimeve dhe udhëzimeve që nxjerr KLGj, dhe jo ligjeve, për dispozitat që ato përmbajnë për funksionimin e gjykatave. Për këtë arsye, sikundër është shpjeguar edhe më lart, kjo masë e përmbush pjesërisht rezultatin, vetëm për pjesën e legjislacionit sekondar.

Lidhur me afatin e parashikuar për plotësimin e kësaj mase, viti 2022, duket se ky afat është shumë i afërt, nëse marrim në konsideratë kohën që i është dashur KLGj për të prodhuar akte të tilla, numrin e madh të akteve që KLGj duhet të përgatisë dhe specifikave të tyre dhe për më tepër, në kushtet kur përcaktimi i hartës së re gjyqësore është elementi i parë bazë që do të përcaktojë edhe strategjinë dhe politikbërjen e gjyqësorit në shpërndarje burimesh njerëzore dhe infrastrukture.

Kjo është arsyeja pse harta e re gjyqësore ishte parashikuar për t’u përmbushur brenda SND I (objektivi 1.04) dhe mospërmbushja e saj brenda kohës së veprimit të SND I, deri në 2020, sjell pasojën që këto masa, në funksion të hartës së re, të mos jenë të natyrshme as në 2022.

**Konkluzion:** *Kjo masë e përmbush pjesërisht Rezultatin, vetëm për pjesën e legjislacionit sekondar (rregullave standarde, vendimeve dhe udhëzimeve) dhe jo ligjit, sic kërkohet nga Rezultati. Gjithashtu kjo masë nuk garanton se do të jetë e mundshme dhe efektive në afatin e parashikuar nëse marrim në konsideratë përvojën e deritanishme dhe boshllëkun e madh dhe thelbësor që ka shkaktuar mungesa e hartës së re gjyqësore.*

### Masa 2.1.13

*“Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së legjislacionit dytësor mbi nëpunësit civilë gjyqësorë”.*

Kjo masë parashikon përgatitjen dhe miratimin e të gjitha akteve nënligjore nga KLGj, në bashkëpunim me gjykatat, që do të rregullojnë çështjet që lidhen me nëpunësit civilë gjyqësorë. Është e rëndësishme të theksohet se ligji bën një ndarje të kompetencave, në rastin e nëpunësve civilë gjyqësorë, ndërmjet KLGj dhe Këshillit të gjykatës.

KLGj është përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e të gjitha shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor (neni 36 i ligjit 98/2016). Gjithashtu, KLGj miraton edhe rregulla standarde që lidhen me shërbimet e gjykatës dhe kushtet që duhet të plotësojnë nëpunësit civilë gjyqësorë (neni 41 i ligjit 98/2016). KLGj miraton me vendim rregulla të hollësishme për vlerësimin paraprak, krijimin, përbërjen dhe kompetencat e Komisionit të Pranimit, si dhe për procedurën e vlerësimit për nëpunësit civilë gjyqësorë (neni 54 i ligjit 98/2016), lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë (neni 57 dhe 58 i ligjit 98/2016) dhe për

procedurën për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor (neni 82 i ligjit 98/2016). Gjithashtu, KLGj është përgjegjëse edhe për miratimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e përllogaritjes së numrit të kandidatëve për kancelarë që pranohen në programin e formimit fillestar, të ofruar nga Shkolla e Magjistraturës, dhe verifikimin e kandidatëve që pranohen në provimin e pranimit (neni 53 i ligjit 98/2016).

Ndërkohë, është Këshilli i gjykatës ai që merr vendime direkte për statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, miraton strukturën dhe organikën e administratës së gjykatës (sipas modelit të miratuar nga KLGj), bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës dhe KLGj për çështje që lidhen me formimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civilë gjyqësorë, etj. Gjithashtu, Këshilli i Gjykatës duhet të organizojë rregullisht takime me përdoruesit e gjykatës në funksion të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë (neni 38 i ligjit 98/2016) dhe përgjigjet për ecurinë e punës së nëpunësit civil gjyqësor të caktuar për marrëdhëniet me publikun pranë gjykatës.

Kjo është një masë shumë e rëndësishme, me ndikim të drejtpërdrejtë dhe të dukshëm në performancën e gjykatës. Për këtë arsye, përmbushja e saj në një kohë sa më të shpejtë është tejet e rëndësishme për pushtetin gjyqësor dhe besimin e publikut në drejtësi. Sipas planit të veprimit të SND II, kjo masë duhet të realizohet brenda vitit 2022. Për analogji me masën 2.1.11, edhe vështirësitë që lidhen me mundësinë e realizimit brenda këtij afati kohor të masës, janë të njëjta dhe mund t'a bëjnë të pamundur përmbushjen e saj. Vlen të tërhiqet vëmendja se, deri më tani, KLGj ka prodhuar një udhëzim, konkretisht Udhëzimin nr. 85, datë 11.03.2021 "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur".

**Konkluzion:** *Kjo masë është në përputhje me Rezultatin dhe Objektivin Specifik dhe ka një rëndësi të madhe në përmbushjen me sukses të tyre. Megjithatë, edhe pse kjo është një masë e ngutshme dhe do të ishte tejet pozitive përmbushja e saj në afatin e caktuar, sërish nëse marrim në konsideratë përvojën e deritanishme të KLGj-së në nxjerrjen e akteve dhe boshllëkun e madh dhe thelbësor që ka shkaktuar mungesa e hartës së re gjyqësore, është e pasigurtë nëse kjo masë është realiste dhe nëse do të jetë efektive nëse realizohet në një kohë kaq të afërt.*

**Konkluzion për të dy masat:** *Në të dy masat e analizuara, organi që mbart peshën kryesore në përmbushjen e tyre është KLGj dhe si pjesëmarrës janë parashikuar gjykatat. Është e rëndësishme që në vijim të studimit të analizohet dhe monitorihet se cilat do të jenë hapat që do të ndjekë KLGj për të krijuar bashkëpunim dhe diskutim me gjykatat. Kjo lidhet me faktin se ndryshimet e reformës në drejtësi kishin si qëllim të tyre fuqizimin e brendshëm të gjykatave (një parashikim në reflektim të kësaj ideje përshembull është krijimi i Këshillit të gjykatës) dhe është shumë me interes të shihet sesi KLGj dhe gjykatat do të bashkëpunojnë mes tyre në funksion të shërbimit më të mirë ndaj qytetarit.*

### **Objektiv specifik 2.3**

*"Rritja e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit ligjor i cili siguron ecjen drejt praktikave Evropiane dhe cilësisë në fushën ligjore duke siguruar një numër të përshtatshëm të magjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë të trajnuar për gjyqësorin dhe prokurorinë në sistemin e drejtësisë në Shqipëri".*

Objektivi Specifik 2.3 plotëson një nga kërkesat e Qëllimit të Politikës 2, atë të rritjes së aftësisë profesionale të gjyqësorit, duke përcaktuar edhe mënyrat se si do të realizohet kjo. Konkretisht, Objektivi Specifik kërkon, së pari, rritjen e efikasitetit të sistemit të trajnimit dhe, së dyti, rritjen e aftësisë profesionale të Shkollës së Magjistraturës në ofrimin e trajnimit për

magjistratët. Synimi i objektivit është që magjistratët (gjyqtarë dhe prokurorë) dhe këshilltarët ligjorë të trajnohen në mënyrë cilësore dhe të drejtohen drejt praktikave evropiane.

Objektivi duhet të kishte parashikuar në mënyrë të shprehur edhe trajnimin e nëpunësve civilë gjyqësorë për dy arsye: së pari, sepse nëpunësit civilë gjyqësorë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e gjykatës apo zyrës së prokurorisë, dhe së dyti, sepse është pikërisht reforma në drejtësi ajo që i dha një rëndësi të shtuar kategorisë së nëpunësve që punojnë në gjykata dhe prokurori, ku përveç statusit të ri si nëpunës civilë gjyqësorë, për një pjesë të nëpunësve u përcaktua një sistem i ri rekrutimi dhe trajnimi. I referohemi këtu kancelarëve të gjykatave dhe prokurorive, të cilët do t'i nënshtrohen provimit në Shkollën e Magjistraturës për të hyrë në sistem dhe do të ndjekin Program Formimi Fillestar dhe Vazhdues (përgjatë detyrës) pranë Shkollës.

Ky objektiv është aktual dhe tejet i rëndësishëm për t'u përmbushur pasi ka ndikim të jashtëzakonshëm në cilësinë e drejtësisë për vitet që do të vijnë. Këtu kemi parasysh se gjyqësori po ripërtërihet në pjesën më të madhe të tij për një kohë të shkurtër, për shkak të ikjes nga sistemi të gjyqtarëve dhe prokurorëve si pasojë e vetingut dhe plotësimit të vendeve nga Shkolla e Magjistraturës. Njëkohësisht, hapat e shtetit shqiptar drejt BE premtojnë për një pozicion të ri, më të afërt të Shqipërisë me BE, gjë që imponon jo vetëm harmonizim të ligjit, por edhe kuptim dhe zbatim të përafuar të tij. Magjistrati shiptar do të duhet të nisë të mendojë si magjistrat evropian në mënyrë që të jetë në koherencë me të gjitha zhvillimet sociale dhe ekonomike të vendit.

Nëse shohim rezultatet që synohen të arrihen në SND II, ato janë në linjë me çfarë parashikon Objektivi. Konkretisht, rezultati i parë lidhet me përmirësimin e kurrikulave për magjistratët në detyrë, pra duke synuar që ato të bëhen më efikase dhe më cilësore, dhe, rezultati i dytë lidhet me studimin dhe kërkimin në legjislacionin e BE dhe në fushën e të drejtave të njeriut.

Edhe në SND I parashikoheshin një sërë masash lidhur me Shkollën e Magjistraturës dhe përgjithësisht të fokusuar në analizën e nevojës dhe rishikimin e kurrikulave, por edhe rritjen e studimit dhe kërkimit në Shkollë dhe forcimin e kapaciteteve të Shkollës. Pra, Strategjia e Drejtësisë nuk ka ndryshuar shumë nga një fazë e parë e saj (SND I) tek tjetra (SND II), por kjo nuk duhet parë si mungesë zhvillimi, përkundrazi është pikërisht zhvillimi i qëndrueshëm i këtij komponenti ai që kërkon shtrirjen e tij më të gjatë në kohë. Këtu duhet të marrim në konsideratë një pjesë e madhe e përgjegjësisë sa i takon sistemit të trajnimit, ligji 115/2016 ia ka ngarkuar bashkërisht organeve të qeverisjes (KLGj dhe KLP), Shkollës së Magjistraturës dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Konkretisht, këto organe duhet të ndërveprojnë në procesin e hartimit të nevojave për trajnim dhe më tej duhet të miratojnë aktivitetet dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve e prokurorëve në këto aktivitete.

Njëkohësisht ky objektiv është në përputhje me Strategjinë e vetë Shkollës së Magjistraturës dhe me Strategjinë kundër korrupsionit, si dhe në koherencë me kërkesat e IPA III, e cila e shtrin zbatimin e saj deri në vitin 2027.

**Konkluzion:** Objektivi është në përputhje me Qëllimin e Politikës 2 dhe me strategjinë e Shkollës së Magjistraturës, si dhe është i harmonizuar me aktet e tjera strategjike që lidhen me cilësinë e drejtësisë. Ky është një objektiv aktual dhe suksesi në realizimin e tij do të ndikojë në drejtësinë e viteve që do të vijnë. Vlerësohet që nëse ky objektiv do të përmbante edhe nëpunësit civilë gjyqësorë, ai do të ishte më i plotë në drejtim të cilësisë dhe performancës së sistemit të drejtësisë.

### Rezultati 2.3.1

*“Kurrikula të Programit të Trajnimit Vazhdues të SHM të përmirësuara dhe përditësuara”.*

Ky rezultat parashikon se nëpërmjet përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të kurrikulave të trajnimit të vazhduar (në detyrë) do të rritet efikasiteti i aktiviteteve trajnuese dhe cilësia e ofruar e tyre e si rrjedhojë cilësia e performimit të sistemit të drejtësisë. Kjo lidhje është logjike dhe e qëndrueshme, ndaj është hapi i parë drejt realizimit të objektivit.

Megjithatë, duket se rezultati nuk e ka interpretuar mirë objektivin kur ka lënë jashtë trajnimin fillestar, pra momentin kur kemi kandidatë për magistratë. Trajnimi fillestar, program i gjatë tre vjeçar, nuk ka pse të shkëputet si komponent kur flitet për cilësinë e drejtësisë. Për më tepër, në kushtet kur në këto vite dhe të paktën në dy vitet e ardhshme numri i kandidatëve për magistratë është/do të jetë shumë i lartë, ndikimi i formimit të tyre tre vjeçar përgjatë këtyre viteve do të jetë treguesi i parë i cilësisë së drejtësisë në vitet që do të vijin. Përderisa objektivi nuk bën një ndarje kur i referohet trajnimit, edhe rezultati nuk duhet të parashikonte vetëm trajnimin vazhduar, por edhe atë fillestar, i cili, në mënyrë të vazhdueshme, ka nevojë për përmirësim dhe përditësim. Pra, në mënyrën si është formuluar dhe me masat që parashikon, një pjesë prej të cilave do të analizohen në vijim, ky rezultat nuk e përmbush plotësisht këtë komponent të objektivit specifik. Për këtë arsye, kërkohet një rishikim në formulimin e rezultatit dhe parashikimin e masave konkrete lidhur me trajnimin e kandidatëve për magistratë.

Lidhur me mundësinë reale të realizimit në kohë të rezultatit, duke qenë se ai parashikon një numër të madh masash (2.3.1-2.3.11), me afate të ndryshme të realizimit të tyre, kjo analizë do të bëhet njëherësh me masën. Në tërësi, afatet e vendosura për realizimin e rezultatit janë të mundshme për të dhënë produkt.

**Konkluzion:** Rezultati do të duhej të kishte pjesë të tij edhe Programin e Formimit Fillestar për shkak të rëndësisë thelbësore që ka ky program në formimin e magistratëve. Në kushtet aktuale, ky program merr një vlerë akoma më të madhe për shkak të numrit të madh të magistratëve që pranohen në këtë program dhe që do të bëhen pjesë e sistemit brenda tre viteve. Pra Rezultati e përmbush Objektivin Specifik 2.3 në mënyrë të pjesshme.

### Masa 2.3.8

*“Përgatitja dhe unifikimi i metodologjisë së re për trajnimin e vazhdueshëm bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë”.*

Kjo masë parashikon hartimin e një metodologjie të re për realizimin e sesioneve të trajnimit me synim unifikimin e saj dhe duke e përputhur me kërkesat e standardeve evropiane të trajnimit gjyqësor. Kjo është një kërkesë e domosdoshme në funksion të rritjes së cilësisë së trajnimeve e cila garanton që, së pari, ekspertët do të ndjekin të njëjtën linjë metodologjike në realizimin e aktiviteteve trajnuese. Kjo nuk përbën një kufizim të lirisë së tyre akademike, por përkundrazi, duke qenë se kjo metodologji e re do të kalojë “testin” e verifikimit të hartimit të saj në përputhje me standardet evropiane, ajo përbën një garanci më shumë për të pasur një uniformitet të qëndrueshëm në mënyrën sesi realizohen trajnimet. Së dyti, hartimi i një metodologjie të re, të përputhur me standardet evropiane, rrit jo vetëm cilësinë e trajnimit për pjesëmarrësit, por edhe për trajnerët, dhe duke pasur parasysh se trajnerët në Shkollën e Magistraturës janë në masën 90 % gjyqtarë dhe prokurorë në detyrë, të të gjitha shkallëve të sistemit, atëherë, kjo metodologji ndikon drejtpërdrejtë edhe në nivelin e angazhimit të tyre, në qasjen cilësore ndaj trajnimeve dhe në aftësimin e tyre në këtë drejtim.

**Konkluzion:** Kjo masë është në përputhje me Rezultatit 2.3.1 dhe Objektivin Specifik 2.3. Gjithashtu, është një masë e avancuar në krahasim me masat e parashikuara në SND I dhe ka

*ndikim të madh në forcimin e kapaciteteve të Shkollës në drejtim të ofrimit të trajnimit gjyqësor, përgjegjësi ekskluzive e saj, e parashikuar në ligj.*

### **Masa 2.3.11**

*“Përgatitja e programeve të trajnimit vazhdues në përputhje me standardet evropiane”.*

Kjo masë parashikon hartimin e programeve të trajnimit vazhdues. Nga mënyra sesi kjo masë është shprehur nuk është e qartë nëse i referohet programit të formimit vazhdues si tërësia e trajnimeve të parashikuara në një vit akademik, apo programit të cdo trajnimit më vete. Ky është një përcaktim i rëndësishëm dhe duhet të ishte mjaft i qartë, pasi vetë kërkesat, metodologjia dhe procesi se si hartohet programi i përvitshëm është tërësisht e ndryshme nga kërkesat dhe metodologjia që përdoren në trajnimet e vecanta.

I vetmi element që mund të përdoret në këtë rast për të bërë një shpjegim të masës në favor të variantit të parë, sipas të cilit kjo masë i referohet programit të plotë 1-vjeçar të formimit vazhdues, është përfshirja si institucione pjesëmarrëse të KLGj, KLP dhe PP. Këto organe janë të detyruara të bashkëpunojnë aktivisht me Shkollën e Magjistraturës në funksion të hartimit të programit (kalendarit) të formimit vazhdues cdo vit akademik duke dhënë mendimin e tyre për tema të caktuara me interes të vecantë për t’u përfshirë në programin e formimit vazhdues. Duke marrë për bazë këtë variant mund të vijojmë me analizën e masës.

Hartimi i programit të formimit vazhdues është një ndër proceset më të rëndësishme që zhvillon Shkolla e Magjistraturës, si për nga koha që i kushtohet (procesi nis në muajin prill të cdo viti dhe përmbyllet në muajin shtator), rrethi i subjekteve të përfshirë për mendim dhe konsultim (të gjithë pjesëmarrësit në aktivitetin e programit të formimit vazhdues, partnerët ndërkombëtarë dhe kombëtarë, KLGj, KLP, PP), diskutimi i projekt programit (Këshilli pedagogjik i Shkollës) e deri tek formaliteti në finalizimin e tij dhe të cdo ndryshimi që mund t’i bëhet programit në vijim të vitit akademik (cdo vendimmarrje bëhet nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, si për aktivitetet e parashikuara edhe për përcaktimin e ekspertëve)<sup>19</sup>. Për shkak se ky program ndikon drejtpërdrejtë në formimin e vazhdueshëm të magjistratëve në detyrë, ai duhet të jetë shumë efikas dhe të sigurojë se çështjet e trajtuara janë të vlefshme për magjistratët, nxisin dëshirën e tyre për t’u thelluar dhe janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjeve apo dilemave profesionale gjatë ushtrimit të detyrës.

Kërkesë tjetër që kërkon kjo masë është që ky program të hartohet në përputhje me standardet ndërkombëtare të trajnimit gjyqësor. Për t’a realizuar këtë, Shkolla e Magjistraturës duhet të hulumtojë mbi standardet evropiane në fushën e trajnimit gjyqësor dhe të mudësojë implementimin e tyre në programin që harton.

Një ndër kërkesat kryesore të BE është pikërisht përshtatja e programeve të trajnimit vazhdues për të qenë sa më efikase dhe ndikuese në punën e magjistratit. Ato konceptohen si një e drejtë e magjistratit në detyrë dhe bazohen pikërisht në vullnetin që duhet të ketë magjistrati për t’u trajnuar në çështje të rëndësishme të punës së tij. Edhe pse ligji shqiptar parashikon detyrimin e magjistratëve për të marrë pjesë në formimin vazhdues dhe kjo pjesëmarrje ka ndikim të drejtpërdrejtë në vlerësimin që do t’i bëhet magjistratit nga KLGj dhe KLP, sërish Shkolla e Magjistraturës detyrohet të ofrojë një program të përshtatshëm dhe të bazuar në nevojën dhe interesin e tij. Pra, kërkesat që duhet të plotësojë programi i formimit vazhdues janë shumë të larta dhe realizimi me sukses i këtij programi reflekton drejtpërdrejtë suksesin e Shkollës në ushtrimin e detyrave të saj përballë sistemit të drejtësisë.

---

<sup>19</sup>Regullore e brendshme e Shkollës së Magjistraturës.

**Konkluzion:** *Kjo masë është relevante me Rezultatit dhe aktuale. Edhe parashikimi i vitit 2022 si afati i përmbushjes së kësaj mase është një afat i arsyeshëm dhe i mundshëm për të prodhuar rezultat. Megjithatë kjo masë duhet të ishte formuluar më qartë dhe t'i referohej programit vazhdues për një vit akademik.*

### Rezultati 2.3.2

*“SHM e transformuar në një qendër informacioni burimore në lidhje me të drejtën e BE-së dhe legjislacionin evropian për të drejtat e njeriut si dhe rritja e kapaciteteve për kërkime dhe publikime”.*

Ky rezultat parashikon që Shkolla e Magjistraturës, si institucioni i vetëm i autorizuar nga Kushtetura dhe ligji për të siguruar trajnimin e kandidatëve për gjyqtarë/prokurorë, do të zgjerojë aktivitetin e saj edhe në kërkim, studim dhe publikim. Ky rezultat është në përputhje me objektivin dhe realizon “më të mirën” e tij: siguron ecjen drejt praktikave Evropiane dhe cilësisë në fushën ligjore.

Edhe pse objektivi kërkon që kjo të realizohet nëpërmjet trajnimit, ky rezultat e tejkalon objektivin, duke i zgjeruar mënyrat sesi Shkolla do t'a realizojë këtë. Ky zgjerim vjen në të njëjtën linjë parashikimi që bën edhe vetë Strategjia e Shkollës së Magjistraturës, ku një vend të rëndësishëm e zë pikërisht forcimi i kapaciteteve të saj si një institucion që jo vetëm trajnon, por që del me produkte të mirëfillta studimore-shkencore, nëçështje të rëndësishme për të drejtën. Elementi i parë që është identifikuar se ku do të duhet të japë rezultat ky ridimensionim i Shkollës është legjislacioni evropian dhe ai për të drejtat e njeriut dhe pikat e takimit me ligjin shqiptar.

Është e rëndësishme që të realizohen studime dhe publikime, me vlera praktike për sistemin e drejtësisë në Shqipëri, për përjasjen e parimeve ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare në tërësi, me rregullimin dhe interpretimin e tyre sipas ligjit shqiptar. Deri më tani, punimet kryesore në këtë fushë janë kryesisht të karakterit akademik. Kontributi që do të duhet të japë Shkolla e Magjistraturës do të ketë një karakter më praktik, që do të orientojnë përdoruesit e së drejtës për fusha të caktuara, me anë të studimit dhe produkteve të herëpashershme, të vecanta, duke mundur në këtë mënyrë, në afat të gjatë, një zhvillim të qëndrueshëm të së drejtës.

Ky rezultat kërkon që Shkolla të forcojë kapacitetet në këtë drejtim, duke përfshirë këtu, forcimin e kapaciteteve të saj organizative për të ngritur një strukturë të përshtatshme për t'a realizuar këtë veprimtari, dhe, njëkohësisht, zgjerimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore që lidhen me ekspertizën në të cilën do të mbështetet kjo punë studimore dhe produktet e saj.

Megjithë sa shpjeguar për rezultatit e kërkuar, kur shohim masat që ka parashikuar Plani i Veprimit të SND II, gjithsej dy masa që do të analizohen në vijim, nuk krijohet bindja se ato janë të mjaftueshme për të përmbushur Rezultatit, pasi nuk duket sikur kanë në fokus forcimin e burimeve njerëzore dhe atyre infrastrukturore/logjistike, të cilat janë thelbësore për realizimin e kësaj veprimtarie.

**Konkluzion:** *Ky rezultat e tejkalon Objektivin pasi për realizimin e tij nuk mjafton vetëm veprimtaria e Shkollës në fushën e trajnimeve, por kërkohet veprimtari e mirëfilltë studimore dhe publikimi. Gjithashtu, masat e parashikuara për përmbushjen e rezultatit nuk janë të mjaftueshme, pasi ato kanë lënë jashtë fokusit elementë të domosdoshëm për realizimin e studimit dhe publikimit, siç janë burimet njerëzore dhe infrastrukturore e logjistike, pa të cilat, përmbushja e rezultatit është thujse e pamundur.*

### Masa 2.3.14

*“Përgatitja dhe miratimi i metodologjisë së studimeve dhe botimeve të SHM në përputhje me standardet evropiane”.*

Kjo masë parashikon realizimin e hapit të parë në drejtim të funksionimit të strukturës që do të realizojë studimin dhe kërkimin në Shkollë me qëllim botimin e materialeve shkencore në fusha të ndryshme të së drejtës. Konkretisht Shkolla e Magjistraturës duhet të hartojë një metodologji që do të ndiqet nga vet ajo dhe nga çdo grup pune, të cilit do t’i ngarkohet studimi i një instituti/çështje të së drejtës. Kërkesa që parashikon kjo që kjo metodologji të hartohet në përputhje me standardet evropiane.

Megjithatë duket se vetëm hartimi i metodologjisë nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur Rezultatin dhe nuk i jep zhvillim as vetë kësaj mase.

Duke qenë se përmbushja e Rezultatit lidhet edhe me çështje të organizimit të kapaciteve organizative njerëzore dhe të infrastrukturës e logjistikës, metodologjia do të ishte e dyta në radhë si orientuese e punës së strukturës së ngritur për këtë qëllim. Kjo është e nevojshme për shkak të faktit se jemi përballë një detyre të re që synohet të sjellë një transformim gradual në mënyrën sesi operon deri më sot Sektori i Publikimeve në Shkollë. Pra, kjo masë, në mënyrë që të konsiderohet e plotë, do të duhet të parashikojë edhe forcimin e kapaciteteve organizative, burimeve njerëzore të institucionit dhe rritjen e kapaciteteve infrastrukturore e logjistike që do të duhet të vendosen në dispozicion për realizimin e kësaj veprimtarie.

**Konkluzion:** *Kjo masë është në përputhje me Rezultatin dhe plotëson një pjesë të tij, atë të aspektit metodologjik që do të duhet të ndiqet nga struktura e ngritur për qëllime të analizës dhe publikimit. Përmbushja e Rezultatit lidhet edhe me çështje të organizimit të kapaciteve organizative njerëzore dhe të infrastrukturës e logjistikës. Metodologjia do të ishte e dyta në radhë si orientuese e punës së strukturës së ngritur për këtë qëllim. Sa i përket aspektit metodologjik, afati i vendosur, viti 2022, duket realist dhe i mundshëm për t’u realizuar.*

### Masa 2.3.15

*“Krijimi i bazës së të dhënave të lektorëve dhe trajnerëve të SHM që kanë njohuri mbi ligjin e BE-së”.*

Kjo masë parashikon që Shkolla e Magjistraturës duhet të krijojë një bazë të të dhënave për lektorët dhe trajnerët që ajo mund të përdorë në funksion të realizimit të aktivitetit të saj studimor shkencor me fokus të drejtën e BE-së.

Kjo masë është e paplotë dhe nuk përmbush rezultatit sa i takon ekspertizës në realizimin e kësaj veprimtarie. Së pari, për të bërë analizën e ligjit të BE nuk do të duhen vetëm ekspertë që njohin ligjin e BE-së, por edhe ekspertë që analizojnë ligjin shqiptar në çështjet ku do të bëhet një analizë krahasimore e të dy ligjeve. Së dyti, duke qenë se Shkolla e Magjistraturës mbështetet më shumë në ekspertizën e gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, dhe duke qenë se këto publikime kanë në fokus, së pari, sistemin gjyqësor, baza e funksionimit të kësaj veprimtarie do të jenë magjistratët. Mungesat e deritanishme të lidhjes së gjyqësorit shqiptar me ligjin e BE-së do të kërkojnë forcim të kapaciteteve të ekspertizës. Për këtë arsye kjo masë do të duhej të parashikonte mundësitë e zhvillimit të aftësive/kapaciteteve të trajnerëve të Shkollës në këtë drejtim.

Gjithashtu, nëse me togfjalëshin “bazë të dhënash”, masa ka synuar të parashikojë edhe hedhjen e materialeve studimore apo materialeve që mund t’iu vijnë në ndihmë studiuesve, sërish kjo duhet të kishte dalë e qartë në formulimin e masës.

Parashikimi i një afati të gjatë për zbatimin e kësaj mase, viti 2025, nuk është e qartë ku mbështetet, pasi nga formulimi i masës duket sikur ajo mund të plotësohet qysh në vitin 2021 e të përditësohet në vijim.

Edhe pse, sic është analizuar më lart, forcimi i kapaciteteve të ekspertizës është komponenti më i rëndësishëm, pa të cilin asnjë aktivitet nuk mund të realizohet në drejtim të kërkimit, studimit e publikimit, ky komponent nuk është parashikuar në asnjë masë në mënyrë të qartë e të saktë. Një riformulim i masës është i nevojshëm, në të kundërt, të dyja masat, 2.3.14 dhe 2.3.15, edhe sikur të realizohen, do të mbeten iluzive në raport me qëllimin e parashikimit të Objektivit dhe Rezultatit.

**Konkluzion:** *Kjo masë është e paplotë dhe nuk përmbush rezultatin sa i takon ekspertizës në realizimin e kësaj veprimtarie. Ajo duhet të parashikonte mundësitë e zhvillimit të aftësive/kapaciteteve të trajnerëve të Shkollës në këtë drejtim në mënyrë që t'i shërbente realisht rezultatit që kërkohet të arrihet.*

**Koment i përbashkët** për masat që lidhen me rezultatin 2.3.2: *Shkolla e Magjistraturës, në Strategjinë e vet institucionale 2019-2023, ka parashikuar në mënyrë më konkrete do të përmbushet ky rezultat, përshembull, nëpërmjet analizave të vazhdueshme të hulumtimit dhe jurisprudencës përmes botimeve në baza periodike; nëpërmjet komenteve elektronike, mendimeve dhe informacioneve mbi ligjet dhe praktikën gjyqësore pas punës kërkimore përkatëse; përmes botimeve të aksesueshme për të gjithë aktorët dhe praktikantët e ligjit; aktiviteteve të shtuara të kërkimit dhe përkthimit, etj. Studimi do të duhet të orientohet më shumë prej Strategjisë së brendshme të ShM për të analizuar dhe monitoruar përmbushjen e këtij rezultati.*

#### **Objektivi Specifik 2.4**

*“Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët. (Shënim: Aktivitetet që kanë të bëjnë me KLGJ si autoritet qeverisës në drejtësi janë integruar në këtë Objektiv Specifik për shkak të karakterit të integruar të sistemit gjyqësor. Rezultatet e pritshme të poshtëshënuara reflektojnë qëllimet strategjike të shkruara në planin strategjik të KLGJ).”*

Për nga mënyra se si është formuluar, Objektivi Specifik 2.4 përfshin sistemin gjyqësor në tërësi (pra të tre shkallët e sistemit gjyqësor). Ai orientohet në dy drejtime: Së pari, në funksion të rritjes së *“efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor. Së dyti, në funksion të “ofrimit për qytetarët të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme”*. Në këtë këndvështrim, ky objektivi është në përputhje me Qëllimin e Politikës 2.

Ky Objektiv është në përputhje me objektivat e Reformës në Drejtësi dhe kuadrin ligjor që rregullon qeverisjen dhe organizimin e funksionimit e pushtetit gjyqësor. Efektiviteti dhe efikasiteti janë objektiva të qëndrueshme në kohë, të cilat arrihen nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm. Në këtë aspekt, ky objektivi është aktual. Çelësi i suksesit të tij është identifikimi i saktë i masave të cilat i përshtaten gjendjes aktuale në të cilën ndodhet sistemi i gjyësorit.

Ky Objektiv është pjesërisht i njëjtë me atë të SND I ‘Objektivi 1: *Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë*’. Objektivi ka patur fokus më të gjerë, duke përfshirë tërë sistemin e drejtësisë. Kjo është një zgjidhje e diktuar nga rrethanat pasi në momentin e hartimit të SND I, organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë nuk ishin bërë ende funksionale. Pas krijimit të institucioneve, fokusi ka qenë miratimi i kuadrit nënligjor të akteve që rregullon veprimtarinë e vetë KLGJ. Më tej, Gjykata e Lartë nuk ka qenë funksionale, dhe një pjesë e sistemit gjyqësor (niveli i apelit) është prekur

ndjeshëm nga procesi i rivlerësimit kalimtar. Prandaj Objektivi Specifik, Rezultatet dhe Masat e atëherëshme nuk arritën të realizohen gjatë vlefshmërisë së asaj Strategjie. Nisur nga kjo situatë, me të drejtë ato janë përshtatur për t'u integruar në SND II.

Objektivi është në koherencë me gjendjen aktuale të gjyqësorit dhe me pritshmëritë e publikut sa i takon rezultateve të aplikimit të Reformës në Drejtësi. Ai lidhet me nevojën e ngutshme të gjyqësorit (të gjitha nivelet e tij) për të qenë më efikas, më eficient, më transparent, më i aksesueshëm dhe për të dhënë drejtësi pa vonesë. Aktualisht eficientia e sistemit të drejtësisë po vihet në dyshim. Vakancat e krijuara në sistem për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të magistratëve (vetting), si dhe backlog-u i akumuluar, e kanë vendosur gjyqësorin dhe organet qeverisëse të tij përballëzgjdhjes së sfidave që kanë të bëjnë me standardet e "drejtësisë pa vonesa" apo dhe me "drejtësinë e aksesueshme". Për këtë arsye Objektivi është në koherencë me nevojat aktuale të sistemit. Në kushtet kur KLGJ është funksionale dhe ka objektiv strategjik aplikimin e parimeve të ekselencës së gjyqësorit, ky Objektiv është realist.

Gjithashtu, sa kohë Qëllimi i Politikës 2 kërkon një sistem në përputhje me standardet evropiane, sugjerojmë që përveç efikasitetit dhe efektivitetit të përfshihet edhe pavarësia e sistemit gjyqësor. Mungesa për vite e besimit tek sistemi i drejtësisë dhe skepticizmi tek rezultatet e deritanishme të Reformës në Drejtësi do të kërkonte rezultate të matshme që lidhen me pavarësinë. Gjithashtu, pavarësia është një standard i qëndrueshëm, i cili duhet të synohet nëçdo kohë, në mënyrë të vazhdueshme. Pavarësia e institucioneve të qeverisjes së gjyqësorit (parashikuar në Objektivin 1.3) duhet të shihet si proces i ndarë nga pavarësia e gjyqësorit, sa kohë masat për arritjen e tyre janë të ndryshme. Sigurisht që transparenca e parashikuar në këtë objektiv në ofrimin e shërbimve të gjyqësorit do të na jepte të dhëna cilësore mbi pavarësinë e këtij të fundit.

Ky objektiv vjen në të njëjtën linjë me dy strategjitë sektoriale. Ai përkon me Synimin 1 dhe 3 të Planit Strategjik të KLGJ 2019-2020 : "*Përsheptimi i Reformës së Pushtetit Gjyqësor dhe Akordimit të Burimeve*" si dhe "*Ofrimi Efikas i Shërbimeve dhe Funksionimi më i Mirë i Gjykatave*".

Përmbushja e këtij Objektivi lidhet me 5 Rezultate. Së pari, nga mënyra se si janë formuluar këto rezultate, në pjesën më të madhe të tyre duken më tepër si masa sesa si rezultate e për këtë duhet të riformulohen. Së dyti, jo të gjitha këto rezultate janë në përputhje me Objektivin 2.4. Rezultati 2.4.4 mbi fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve të KLGJ më tepër se me këtë objektiv, lidhet me Objektivin 1.3. Sigurisht fuqizimi i kapaciteteve dhe burimeve në institucionin qeverisës të gjyqësorit, sjell rritjen e efikasitetit, pavarësisë apo eficientës së tij. Por synimi për eficientë dhe efektivitet në gjyqësor nuk sjell si rezultat ndërtim dhe fuqizim kapacitetesh të KLGJ-së. Edhe sikur në këtë rast problemi të qëndrojë tek mënyra e formulimit, përsëri jemi të mendimit që pavarësisht natyrës së integruar të gjyqësorit, SND II duhet të ndajë objektivat, rezultatet dhe masat që lidhen me organet e qeverisjes së gjyqësorit, vecmas nga ato që kanë të bëjnë me vetë gjyqësorin. Në këtë mënyrë do të ishte më i lehtë identifikimi i indikatorëve të rezultatit dhe matja e monitorimi i tyre. E njëjta gjë vlen dhe për Rezultatit 2.4.5. Në këtë Rezultat nuk del e qartë se si objektivi për gjyqësor efikas dhe efektiv, të aksesueshëm e transparent do të sjellë komunikim dhe koordinim efektiv të jashtëm të gjyqësorit me partnerë, institucione të pavarura apo ILD. Për më tepër, po të shohim masat që i përkasin këtij rezultati (Masat 2.4.6 2.4.7-2.4.8 dhe 2.4.9), vëmë re se ato i referohen më tepër transparençës dhe koordinimit mes institucioneve të qeverisjes së gjyqësorit, sesa vetë këtij të fundit. Prandaj, ashtu si dhe për Rezultatit 2.4.4 mendojmë se ky rezultat nuk i shërben këtij objektivi dhe lidhet më tepër me koordinimin dhe transparençën e vetë institucioneve të qeverisjes së gjyqësorit.

Nëse i referohemi masave në përmbushje të këtij objektivi, konstatojmë se ato duhet të jenë të plota dhe më të detajuara për çdo rezultat të pritshëm në përmbushje të synimeve të parashikuara në Objektivin 2.4. Duke qenë se efektiviteti dhe efikasiteti, kanë disa komponentë të matshëm në vetvete, sugjerojmë që çdo komponent i tyre të zërthehet në masë konkrete. Gjithashtu nuk konstatohen masa për Gjykatën e Lartë, e cila është e përfshirë në mënyrë të shprehur në Objektiv, dhe ku plotësimi i strukturës së saj me personel, dhe adresimi i backlog-ut të krijuar në këtë Gjykatë dhe në të gjitha shkallët e gjyqësorit është një ndër faktorët kryesorë që sot ndikon drejtpërdrejt në eficientësinë e sistemit gjyqësor. Mungesa e masave apo indikatorëve për matjen e progresit lidhur me adresimin e backlog-ut të akumuluar ndikon në eficientësinë dhe efektivitetin jo vetëm të Gjykatës së Lartë, por në të gjithë sistemin gjyqësor.

Sa i takon indikatorëve për matjen e këtij objektivi, konstatojmë se janë të kufizuar në raport me synimet që përmban Objektivin. Ndërkohë që ata mund të masin kohën në dhënien e drejtësisë (dhe kjo pa përfshirë Gjykatën e Lartë), lënë jashtë fokusit të monitorimit një sërë komponentësh të tjerë që lidhen me efektivitetin dhe efikasitetin e gjyqësorit apo transparencën dhe aksesueshmërinë. Gjithashtu këto indikatorë është vështirë të ndërlidhen me masat e parashikuara (të paktën në mënyrën aktuale të formulimit të tyre).

**Konkluzion:** *Objektivi Specifik 2.4 është në koherencë me nevojën aktuale të gjyqësorit (në të gjitha nivelet e tij) për të qënë më efikas e efektiv, më transparent, më i aksesueshëm dhe për të dhënë drejtësi pa vonesë. Ky është një Objektiv thelbësor për mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor. Sugjerojmë që përveç efikasitetit dhe efektivitetit të gjyqësorit në synimet e këtij Objektivi të përfshihet dhe pavarësia e tij në dhënien e vendimeve, si një ndër prioritetet e Reformës në Drejtësi dhe pritshmëritë legjitime të publikut prej kësaj të fundit. Gjithashtu sugjerojmë që, në lidhje me këtë objektiv, të rishikohen rezultatet e pritshme, si nga mënyra e formulimit të tyre (pra të përdoret gjuhë më e përshtatshme për rezultate, pasi pjesa më e madhe duken si masa), ashtu dhe nga lidhja që ato kanë me Objektivin 2.4. (pasi jo të gjitha rezultatet janë në përmbushje të objektivit dhe një pjesë janë më të përshtatshme për Objektivin 1.3). Vlerësojmë se është e nevojshme që ky objektiv të plotësohet me masa shtesë që përmbushin rezultatet e parashikuara si të pritshme në kuadër të këtij objektivi. Në vijim të tyre do të identifikoheshin qartë dhe indikatorët. Po ashtu, e rëndësishme në lidhje me këtë objektiv është që në të të përfshihen vetëm Rezultate dhe Masa që i referohen gjyqësorit dhe jo organeve të qeverisjes së tij, të cilat trajtohen në objektivat e Qëllimit të Politikës 1 apo koordinimit mes institucioneve të drejtësisë që trajtohen në objektivat e Qëllimit të Politikës 4.*

### **Rezultati 2.4.1**

*“Përshpejtimi i Reformës në Sistemin e Drejtësisë, përfshirë përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore dhe plotësimin me personel sa më shpejt që është e mundur, duke ruajtur fokusin në cilësinë e shërbimit. Kjo fushë përfshin sigurimin e funksionimit optimal të Gjykatës së Lartë dhe GJKKO.”*

Një rezultat i pritshëm në përmbushje të Objektivit 2.4 është një sistem gjyqësor efektiv dhe eficient, i cili performon sipas standardeve më të larta të cilësisë. Dhe në këtë linjë, në përputhje me nevojat aktuale të sistemit, i cili performon me një numër të kufizuar gjyqtarësh, një rezultat i pritshëm, parakusht i eficientësisë, është funksionimi optimal i gjyqësorit, në të gjitha shkallët e tij. Kjo, duke filluar me gjykatat që nuk kanë qenë funksionale dhe janë aktualisht të paplotësuara me staf (Gjykata e Lartë dhe GJKKO) e deri tek gjykatat e dy shkallëve të para të cilat ditë pas dite, si rezultat i avancimit të procesit të Vetting-ut, po shtojnë vakancat.

Prandaj, në këtë aspekt, me qëllim arritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të synuar të Objektivit 2.4, rezultat i masave që duhet të ndërmerren duhet të jenë gjykata funksionale me personel gjyqësor dhe administrativ, të nevojshëm, i cili duhet të reflektojë standardet europiane për raportet e personelit me numrin e popullsisë, si dhe të operojë sipas standardeve më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Ky rezultat është në vijimësi të rezultateve të pritshme nga masat e parashikuara në kuadër të Planit Strategjik të KLGJ-së për vitet 2019-2020. Në këtë aspekt, masat për arritjen e tij, të parashikuara në SND II, duhet të reflektojnë dhe të jenë të koordinuara me masat që KLGJ do të parashikojë për arritjen e efikasitetit në gjyqësor në Planin Strategjik për vitet në vijim, i cili është duke u hartuar.

Sa i takon formulimit, Rezultati 2.4.1 duhet të rishikohet në tërësinë e tij. Së pari, duke vendosur qartë rezultatit e pritshëm dhe duke shmangur formulime që përbëjnë masa që çojnë në arritjen e tij. Ndërkohë që “përshtetimi i Reformës” përbën më tepër një objektivi sesa rezultat, dhe “përmirësimi i infrastrukturës apo plotësimi me personel”, janë masa të cilat si rezultat sjellin funksionimin optimal të sistemit gjyqësor, si në lidhje me burimet njerëzore ashtu dhe me infrastrukturën. Gjithashtu, duke qenë se plotësimi me personel dhe menaxhimi i burimeve njerëzore janë procese të ndërthurura, sidomos në fazën kur prurjet nga Shkolla e Magjistraturës janë të limituara, mund të shihet mundësia që Rezultatet 2.4.1 dhe 2.4.2 të shkrihen me njëri-tjetrin. Sigurisht masat në arritjen e tyre do të reflektojnë secilin proces.

Së dyti, me qëllim që të jetë realist, Rezultati 2.4.1 duhet të plotësohet më tej me masa që lidhen me përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, duke u ndërlidhur këtu edhe me masat për sistemet e teknologjisë së informacionit (të parashikuara në Objektivin 4.1), si dhe masa që sjellin plotësimin me personel.

Së treti, Rezultati duhet të saktësohet në mënyrë që të jetë më i matshëm dhe i monitorueshëm. Shpeshherë, gjatë zbatimit të SND I janë ndeshur paqartësi, të cilat janë reflektuar në mos-identifikim të institucionit përgjegjës për monitorimin. Për këtë arsye, rezultatet duhet të hartohen duke përdorur gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, në mënyrë që të jenë sa më të matshme gjatë zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë. Në këtë aspekt, një tregues për matjen e rezultatit të të pasurit gjykata funksionale me personel të mjaftueshëm, në gjendjen aktuale të sistemit (me një numër të konsiderueshëm çështjesh të mbartura), mund të jetë : “ numri mesatar i çështjeve për gjyqtar përgjatë një viti”, apo “përqindja e numrit të rasteve të zgjidhura në raport me rastet e reja brenda një periudhe kohore”.

**Konkluzion:** Rezultati i mësipërm duhet të rishikohet në tërësi. Ai duhet të riformulohet në përputhje me Objektivin 2.4, si dhe me natyrën e një rezultati (duke shmangur formulime që përkrijnë me natyrën e masave apo objektivave). Gjithashtu duhet të plotësohet me indikatorë të cilët janë të matshëm dhe të monitorueshëm. Në këtë aspekt sugjerohet përfshirjen si indikator “numri mesatar i çështjeve për gjyqtar përgjatë një viti”, apo “përqindja e numrit të rasteve të zgjidhura në raport me rastet e reja brenda një periudhe kohore”.

## Rezultati 2.4.2

*“Vendosja dhe Zbatimi i Standardeve për Ekselencë Gjyqësore për zbatimin e praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjithë nivelet e gjyqësorit, duke u fokusuar në standarde për të siguruar ekselencë gjyqësore.”*

Ky rezultat lidhet me konceptin e efikasitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore. Eficienca e një sistemi është e lidhur në mënyrë të pandashme me kostot. Një sistem, përfshirë këtu dhe gjyqësorin, konsiderohet se rrit efikasitetin e vet, nëse me të njëjtat burime, të

menaxhuara si duhet, jep rezultat më të lartë ose ruan eficientë edhe me më pak burime njerëzore.

Në funksion të Objektivit 2.4 që synon një gjyqësor efektiv dhe efikas, rezultat i pritshëm do të jetë një sistem që menaxhon në mënyrë efikase dhe eficiente burimet e të gjitha natyrave, përfshi këtu dhe ato njerëzore. Në këtë aspekt Rezultati 2.4.2 përputhet me Objektivin 2.4.

Ky rezultat është gjithashtu aktual. Vakancat që sjell në organikën e gjykatave aplikimi i procesit të Vetingut, dhe prurjet e kufizuara nga Shkolla e Magjistraturës, të paktën për vitet ku do shtrijë aplikimin SND II, kërkojnë detyrimisht një menaxhim eficient të burimet njerëzore. Në këtë aspekt një rialokim optimal dhe i përshtatshëm i burimeve njerëzore, brenda sistemit gjyqësor, do t'a bënte sistemin gjyqësor më eficient.

Megjithëse *“Sigurimi i burimeve të përshatshme për zbatimin e reformave të pushtetit gjyqësor, përfshirë infrastrukturën dhe personelin gjyqësor”* dhe *“miratimi i hartës gjyqësore”* ishte një ndër objektivat kryesore të Planit Strategjik të KLGj-së për vitet 2019-2020, ai mbetet ende i paplotësuar.

Rezultati në vetvete nuk përmbush në tërësi dhe i vetëm objektivin për eficientë, por është një prej rezultateve që detyrimisht vjen në përmbushje të tij dhe që synon menaxhim të burimeve njerëzore, në të gjitha nivelet e gjyqësorit, në përputhje me standardet evropiane të fushës. Ky rezultat mund të shkrihet me rezultatin e parë, pasi plotësimi i personelit së bashku me menaxhimin optimal të burimeve njerëzore sjellin një sistem funksional dhe eficient.

Për matjen e këtij rezultati do të shërbejnë indikatorët që matin në tërësinë e tyre eficientë e gjyqësorit, indikatorët e propozuar në Rezultatin 2.4.1, si dhe *“numri i stafit administrativ të gjykatës për një gjyqtar”*, i cili, krahasuar me mesataren evropiane të përpunuar nga CEPEJ, do të na jepte të dhëna mbi zbatimin e praktikave më të mira evropiane.

**Konkluzion:** Ky rezultat është në përputhje me Objektivin 2.4. Ai i përgjigjet nevojave aktuale të sistemit dhe është realist. Sugjerohet që të shkrihet me rezultatin 2.4.1. Përvec indikatorëve të propozuar për Rezultatin 2.4.1, sugjerohet të shtohet dhe *“numri i stafit administrativ të gjykatës për një gjyqtar”*.

#### **Masa 2.4.2**

*“Kryerja e vlerësimeve të qëndrueshme, të pavarura dhe gjithëpërfshirëse të gjykatave, për të matur performancën kundrejt standardeve të përcaktuara”*

Matja e performancës së gjykatave në Republikën e Shqipërisë, si një ndërmarrje e përcaktuar më parë, është domosdoshmëri. Kjo masë lidhet me të dy rezultatet e mësipërme 2.4.1 dhe 2.4.2. Në këtë aspekt, rëndësi të veçantë ka që në radhë të parë KLGJ të identifikojë komponentët e performancës së një sistemi gjyqësor cilësor që operon sipas standardeve të fushës (pra komponentë që lidhen me pavarësinë, eficientë, efikasitetin, transparencën, aksesin në drejtësi, llogaridhënie, etj), duke përcaktuar njëkohësisht mënyrën dhe metodologjinë e vlerësimit/matjes së tyre.

Vlerësimi i performancës do të ndihmonte KLGJ-në, por edhe vetë gjykatat, që së brendshmi të vlerësonin, kontrollin, buxhetonin, motivonin, promovonin, vlerësonin arritjet, si dhe të përmirësonin shërbimet që 'ofron' gjykata. Matja e performancës është mjet vetëkontrolli dhe përgjegjshmërie. Dhe që ky vlerësim të japë rezultate realiste duhet që të jetë i vazhdueshëm, i pavarur dhe të përfshijë të gjithë komponentët e matshëm të performancës. Gjithashtu, për të qënë gjithëpërfshirës duhet që vlerësimi të përfshijë të gjithë aktorët e sistemit (përfshirë këtu qytetarët, avokatët, etj.).

Nisur nga sa më sipër, përfshirja e një mase të tillë është thelbësore për arritjen e Objektivit strategjik. Ajo qëështë e rëndësishme lidhur me këtë masëështë identifikimi i saktë i komponentëve që përbëjnë një sistem gjyqësor cilësor, metodologjia e vlerësimit, si dhe matja e tyre. Rezultati i kërkuar do të vijë vetëm nëse të dhënat e vlerësimeve të bëra analizohen dhe konkludojnë me masa që do të adresojnë problematikat e evidentuara si pengesë në arritjen e performancës.

Masa nuk krijon konfuzion me rezultatin për arritjen e një gjyqësori efikas dhe efektiv që operon sipas standardeve. Por, për të qenë e plotë dhe në përputhje me Rezultatin duhet tëshoqërohet me të gjitha sa u përmendën më sipër (identifikimin e komponentëve/treguesve të performancës, metodologjinë e matjes së tyre, analizimin dhe nxjerrjen e rezultateve/problematikave, si dhe adresimin e tyre me masat e duhura). Vetëm në këtë mënyrë vlerësimi do të ishte i plotë dhe masa do të ishte realiste e do të sillte rezultatin e kërkuar në përputhje me Objektivin 2.4. Pra kjo masë e vetme nuk jep rezultatin e kërkuar. Përveç sa më sipër, kjo masë duhet të shoqërohet me një masë, e cila do të ketë në fokus evidentimin dhe adresimin e problematikave të evidentuara nga vlerësimet e performancës.

**Konkluzion:** *Matja e performancës së gjykatave është thelbësore. Dicka që nuk i nënshtrohet vlerësimit nuk mund të vlerësohet dhe nuk mund të përmirësohet, pasi nuk dihen mangësitë e sistemit dhe se ku duhet të ndërhyhet. Megjithatë, për të qenë realiste dhe të sjellë rezultatin e pritshëm duhet të identifikohen të gjithë hapat proceduralë që mundësojnë aplikimin e saj (identifikimin e komponentëve/treguesve të performancës, metodologjinë e matjes së tyre, analizimin e të dhënave dhe nxjerrjen e problematikave, adresimin e tyre, si dhe institucionin përgjegjës për këto procese). Këto të fundit mund të hartohen si elementë përbërës brenda kësaj mase sa kohë i shërbejnë një procesi të vetëm, pavarësisht kompleksitetit të tij.*

#### **Masa 2.4.5**

*“Miratimi dhe zbatimi i hartës së re gjyqësore”.*

Kjo masë, në zbatim të ligjit 115/2016, nënkupton miratimin e një vendimi nga Këshilli i Ministrave bazuar në bashkëpropozimin e KLGj-së dhe MD-së. Një ndër çështjet më të rëndësishme që zgjidh Këshilli i Lartë Gjyqësor është përcaktimi i numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve që nevojiten në Republikën e Shqipërisë dhe vlerësimi i organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, ose thënë ndryshe, miratimi i hartës gjyqësore. Kjo është një vendimarrje tekniko-politike me efekte shumë të mëdha në eficientësinë e gjyqësorit dhe aksesin në drejtësi të qytetarëve shqiptarë.

Miratimi dhe zbatimi i hartës së re gjyqësore është masë e domosdoshme në funksion të arritjes së Rezultatit 2.4.1 dhe 2.4.2 dhe Objektivit Specifik 2.4. Harta gjyqësore përbën një nga çështjet më të rëndësishme të sigurimit të efektshmërisë dhe eficientësisë së gjykatave. Sfidat në hartimin e kësaj harte, në përputhje me nevojat aktuale të gjyqësorit, qëndron në gjetjen e balancës së arsyeshme midis mirëfunksionimit me efikasitet të gjykatave dhe aksesit të publikut. Ajo kërkon një studim të kujdesshëm të gjendjes së gjykatave, dhe këtu i referohemi fluksit të çështjeve, çështjeve të prapambetura, vendimeve të dhëna, numrit të gjyqtarëve, numrit të personelit ndihmës, infrastructures së gjykatës, buxhetit, etj. Nga ana tjetër, me qëllim mos- cënimin e aksesit në drejtësi duhet mbajtur parasysh popullsia e rajoneve apo rretheve gjyqësore ekzistuese të cilat mund të preken nga riorganizimi, trendet e zhvillimit ekonomik tësecilit rajon; cilësia e infrastructures, hekurudhore dhe automobilistike, largësia

dhe kostot financiare të transportit, aksesit dhe niveli i përdorimit të teknologjisë së informacionit, mundësinë e përfitimit nga shërbimet e ndihmës ligjore falas, etj.

Analiza për hartimin e hartës duhet të mbajë në konsideratë dhe ndryshimet e fundit të bëra në paketën e Reformës në Drejtësi dhe që prekën kompetencat e gjykatave, ndryshuan përbërjet e trupave gjykues, duke ulur numrin e gjyqtarëve që nevojiteshin para ndryshimeve, dhe ndryshuan procedurat e gjykimit, duke kaluar një numër të madh të rasteve në dhomë këshillimi, të cilat synonin efikasitetin dhe eficiencën e gjyqësorit.

Kjo masë ka qenë e parashikuar në Aktivitetin 1.04 *'Riorganizimi i hartës gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe e autoriteteve të tjera hetimore dhe shpërndarja e gjykatave, në përputhje me ndarjen e re territoriale, numrin e popullsisë dhe bllokimi i çështjeve gjyqësore, me qëllim forcimin e rolit dhe funksionimit të gjykatave dhe për të siguruar aksesin në drejtësi'*, të Objektivit 1 (shiko më sipër) të SND I. Gjithashtu kjo masë ka qenë parashikuar në masat në zbatim të Synimit 1 *"Përshpejtimi i Reformës së Pushtetit Gjyqësor dhe Akordimit të Burimeve"* të parashikuar në Planin Strategjik të KLGJ 2018-2020. Megjithatë, edhe pse kanë kaluar katër vite nga miratimi i ligjeve të Reformës, harta ende nuk është miratuar, megjithë diskutimet që janë bërë për realizimin e saj. Parashikimi i kësaj mase sigurisht që është i domosdoshëm. Ndërkohë që është një proces imediat, duket sikur përfshirja në SND II, krijon premisën se ky proces do të vazhdojë të kërkojë kohë.

Masa mbetet aktuale sa kohë që ende nuk është miratuar dhe është në fazën e një drafti të propozuar nga KLGJ. Gjithashtu kjo masë shihet e nevojshme me qëllim optimizimin e burimeve njerëzore dhe financiare, rritjen e eficiencës dhe efikasitetit të gjykatave, si dhe minimizimin e kostove dhe pasojave të rivlerësimit kalimtar, pa çenuar këtu aksesin në drejtësi. Në këtë aspekt, kjo masë është e domosdoshme për arritjen e rezultateve të sipërpërmendura 2.4.1 dhe 2.4.2.

Të gjitha vendet e BE-së që kanë miratuar harta të reja gjyqësore janë përballur me këtë sfidë. Masa është e formuluar qartë dhe krijon lidhje të natyrshme me Masën 2.4.2.

**Konkluzion:** *Masa është e përshtatshme për të realizuar Objektivin Specifik 2.4. Ajo është formuluar qartë, dhe është aktuale dhe realiste. Miratimi dhe zbatimi i hartës gjyqësore mbetet 'çelësi kryesor' që garanton rritje të eficiencës dhe efektivitetit në dy shkallët e para të sistemit gjyqësor, duke ruajtur të pacënuar aksesin në gjykata.*

### **Rezultati 2.4.5**

*"Krijimi i komunikimit dhe koordinimit efektiv të jashtëm: përmirësimi i marrëdhënieve midis gjyqësorit, partnerëve të tij, institucioneve të pavarura, si ILD, dhe publikut duke zhvilluar dhe zbatuar një strategji komunikimi të qartë".*

Ky rezultat nënkupton që në funksion të përmbushjes së Objektivit Specifik 2.4 të kemi komunikimin dhe koordinimin efektiv midis gjyqësorit, partnerëve të tij dhe institucioneve të pavarura, si ILD. Si premisë për këtë rezultat do të jetë zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie të qartë komunikimi.

Nga mënyra si është formuluar, duket që ky rezultat i përgjigjet vetëm pjesërisht Objektivit 2.4, konkretisht pjesës së transparencës në shërbimet e ofruara.

Komunikimi me publikun ndikon në transparencën e gjyqësorit, aksesin e qytetarëve në informacion, rrit besimin e publikut tek drejtësia dhe bën sistemin më të përgjegjshëm. Gjithashtu, ekzistenca e një strategjie komunikimi *per se*, përbën hap pozitiv për çdo institucion

apo sistem. Një strategji e tillë, për llogari të gjyqësorit, është miratuar nga KLGJ<sup>20</sup>. Kjo lloj strategjie pritet të sjellë efekte tek publiku dhe përdoruesit e gjykatave të të gjitha niveleve. Strategjia e komunikimit ka natyrë gjithëpërfshirëse dhe parashikon forma komunikimi dhe ndërveprimi me publikun dhe përfituesit e gjykatave. Për t'a bërë realist këtë rezultat, në SND II, në konsultim me KLGJ, do të ishte me interes të përfshiheshin masa, të cilat janë ende në proces në kuadër të Planit Strategjik të komunikimit miratuar për Gjyqësorin. Kështu do të monitorohej dhe do të matej progresi i transparencës së gjyqësorit me publikun dhe shkalla e realizimit të vetë Planit Strategjik të Komunikimit. Në këtë mënyrë dhe indikator që mat këtë rezultat “% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në internet dhe i përditësuar” do të merrte më tepër vlerë. Një indikator tjetër në funksion të matjes së këtij rezultati mund të jetë dhe “% e çështjeve gjyqësore për të cilat vendimet janë publikuar në faqen e web, apo % e rezultateve të performancës së gjykatës që gjendet e publikuar në faqen e gjykatës dhe KLGJ-së”.

Pjesa tjetër e Rezultatit është e paqartë dhe të paktën ashtu siç është formuluar nuk i përgjigjet Objektivit 2.4. Nuk del e qartë sesi komunikimi me institucionet e pavarura (ku nuk kuptohet kush janë këto institucione), partnerët e tij (term i paqartë dhe jo juridik), apo ILD (funksioni i të cilit lidhet me llogaridhënien) do të ndikojë në eficiencë, efektivitet apo transparencë të gjyqësorit.

Gjithashtu, masat që janë në zbatim të Objektivit 2.4 dhe lidhen me këtë Rezultat duket se i referohen rritjes së bashkëpunimit institucional mes institucioneve të qeverisjes së gjyqësorit, si dhe transparencës së tyre me publikun, duke u fokusuar tek ILD. Këto masa më tepër ndikojnë në konsolidimin dhe transparencën e institucioneve të qeverisjes, parashikuar në Objektivin 1.3 të Politikës 1 të SND II.

**Konkluzion:** Rezultati 4.2.5 duhet të rishikohet në tërësinë e tij. Së pari, sugjerojmë të riformulohet në përputhje me Objektivin 2.4, duke u fokusuar tek komunikimi i gjyqësorit me publikun dhe duke shmangur pjesët që nuk i përgjigjen Objektivit 2.4. Së dyti, në funksion të këtij saktësimi dhe për t'a bërë sa më realist, duhet të rishikohen edhe masat e vendosura që do të mundësojnë arritjen e tij.

#### **Masa 2.4.8**

*“Krijimi i infrastrukturës për të ngritur një njësi për pritje të publikut pranë ILD-së”.*

Kjo masë është hartuar në funksion të realizimit të rezultateve që kanë të bëjnë me krijimin e një zyre për informimin e publikut pranë ILD-së. Kjo masë përmban elementë që pothuajse çdo institucion i sistemit të drejtësisë i ka në strukturën e vet, pasi kanë të bëjnë me ushtrimin e mirëfilltë të kompetencave që ligji u ka dhënë.

Masa nuk vjen në koherencë me Objektivin 2.4. Një masë e tillë më tepër i shërben transparencës së ILD-së dhe aksesit të qytetarëve tek ky institucion, me qëllim bashkëpunimin e tyre në funksion të rritjes së llogaridhënies së gjyqësorit.

Së dyti, masa lidhet ngushtësisht me konsolidimin e institucionit. Ajo është parashikuar si e tillë në vetë Planin Strategjik për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022, si aktivitet për realizimin e Objektivit Strategjik 4: *Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në*

---

<sup>20</sup>Shih Vendimin e KLGJ nr. 590, 26.11.2020 “Për miratimin e Planit Strategjik të Komunikimit për sistemin Gjyqësor”<http://klgj.al/ep-content/uploads/2020/12/PLANI-STRATEGJIK-I-KOMUNIKIMIT-P%C3%8BR-SISTEMIN-GJYQ%C3%8BSOR.pdf>

veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të lartë të Drejtësisë, me afat realizimi muajin mars 2021. Në këtë aspekt, mendojmë se masa nuk është aktuale apo realiste.

**Konkluzion:** Masa nuk i përgjigjet Objektivit 2.4. Ajo nuk është e nevojshme për t'u përfshirë në nivelin e Strategjisë Ndërsektoriale (pra Strategjisë ombrellë), sa kohë gjendet me afat të shkurtër (mars 2021) në strategjinë e vetë institucionit.

#### Masa 2.4.9

*"Ngritja e kapaciteteve të ILD për ofrimin e ndihmës/këshillime me publikun për plotësimin e formularit të ankesave".*

Kjo masë duket sikur plotëson Masën 2.4.8 pasi ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve të ILD-së për ofrimin e shërbimeve për publikun me qëllim qasjen e këtij të fundit për sinjalizimin e shkeljeve disiplinore nga ana e gjyqtarëve. Ofrimi i asistencës për plotësimin e formularit ndihmon në suksesin e një procedimi disiplinor dhe në rritjen e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat e tyre, për sjelljet/veprimet/mosveprimet që mund të përbëjnë shkelje, si dhe mënyrën se si t'i parashtrajnë ato në mënyrë bindëse.

Megjithatë, ashtu sic ushprehëm edhe për masën e mësipërme, dy masat së bashku (Masa 2.4.9 dhe 2.4.8), lidhen me fuqizimin kapaciteteve të institucionit të ILD-së në funksion të llogaridhëniessë gjyqësorit, duke rritur gjithashtu transparencën dhe aksesin e publikut në këtë institucion. Në këtë aspekt mendojmë se kjo masë nuk i përgjigjet Objektivit 2.4. që ka në fokus gjyqësorin dhe jo institucionet e qeverisjes së tij.

Gjithashtu, kjo masë është përfshirë në Planin Strategjik të vetë ILD-së në kuadër të Objektivit Specifik 4.1: *Rritja e aksesit të publikut përmes komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët.*, ku ofrimi i trajnimeve për personat përgjegjës për pritjen me publikun shihet si një masë me afat realizimi fundin e vitit 2020. Për këtë arsye mendojmë se masa nuk është në koherencë me parashikimet e vetë ILD-së.

**Konkluzion:** Masa nuk i përgjigjet Objektivit 2.4 sepse nuk ka në fokus gjyqësorin por institucionet e qeverisjes së tij. Gjithashtu masa duhet të jetë në koherencë me parashikimet e Planit të Veprimit të ILD-së. Kjo masë, e shoqëruar edhe me masa të tjera, mund të qëndronte në Strategji, nëse Objektivit 2.4 do të shtonte si synim dhe llogaridhëniën e gjyqësorit.

#### Objektivi specifik 2.5

*"Aksesi efikas në drejtësi i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme."*

Përmirësimi i aksesit në sistemin e drejtësisë ka qenë një nga qëllimet kryesore të reformës. Në mënyrë që ky akses të jetë sa më efektiv për qytetarët duhet të 'investohet' në shumë drejtime. Për nga mënyra se si është formuluar, ky Objektiv fokusohet në tre drejtime: (i) tek ndihma juridike; (ii) zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve; dhe (iii) hartimi i tarifave të përshtatshme gjyqësore. Të tria këto aspekte, megjithëse jo të vetmet, janë shumë të rëndësishme për të siguruar aksesin në drejtësi.

E drejta për ndihmë juridike siguron akses efektiv në drejtësi për ata që kanë pamjaftueshmëri burimesh financiare për të mbuluar kostot e çështjeve gjyqësore, siç janë tarifatat ose shpenzimet gjyqësore të përfaqësimit ligjor.

Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve (ZAM) i referohet procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve - si ndërmjetësimi dhe arbitrazhi-që ofrojnë zgjidhje jashtëgjyqësore për

mosmarrëveshjet. Aplikimi i tyre përmirëson efikasitetin e drejtësisë, duke zvogëluar ngarkesën e punës së gjykatave dhe duke u ofruar individëve një mundësi për të zgjidhur mosmarrëveshjet në një kohë më të shpejtë dhe me më pak kosto financiare e sociale.

Tarifat gjyqësore duhet të jenë të studiuara në mënyrë që të ndihmojnë administrimin efikas të drejtësisë. Ato, nga njëra anë, nuk duhet të rëndojnë palët me kosto të tepërta që pengojnë t'i drejtohen gjykatës për shkelje të të drejtave, si dhe, nga ana tjetër, duhet të mbulojnë kostot administrative dhe të pengojnë palët që abuzojnë me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës.

Ky Objektiv është në përputhje me Qëllimin e Politikës 2, një ndër drejtimet e së cilës është fuqizimi i aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane. Objektiv 2.5 gjithashtu vjen në vijimësi të objektivave të SNDI. Konkretisht Nën-objektivi 3/b: *“Përmirësimi i aksesit në sistemin e drejtësisë, ishte pjesë e Objektivit 3 të SND I: Përmirësimi i funksionimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen në gjykatë në përputhje me standardet evropiane.”*

Objektiv 2.5 i përgjigjet gjithashtu nevojave aktuale të shoqërisë. Sistemi i ndihmës juridike është në fazë konsolidimi. Pas hartimit të bazës ligjore dhe shtimit të rrjetit të qendrave të ofrimit të ndihmës juridike, sfidë mbetet ndërgjegjësimi i qytetarëve mbi kushtet e përfitimit të saj dhe rritja e numrit të atyre që përfitojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore falas.

Alternativat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, me gjithë ndihmën që do të mund t'i ofronin qytetarëve dhe sistemit gjyqësor, mbeten jo-efektive dhe duhet që, përveç ndërgjegjësimit, të bëhet një analizë e bazës aktuale ligjore, duke evidentuar pikat e dobëta, si dhe duke e sjellë atë në përputhje me modelet e suksesshme, të cilat shmangin këto probleme dhe i përshtaten realitetit shqiptar.

Gjithashtu, tarifat gjyqësore janë të nevojshme për t'u rishikuar, duke marrë në konsideratë organizimin e sistemit në bazë të hartës së re gjyqësore.

Ky objektiv materializohet në 3 rezultate<sup>21</sup>. Këto rezultate janë të plota dhe në përputhje me Objektivin 2.5. Sugjerojmë që Rezultati 2.5.2 të riformulohet në formën e një rezultati pasi ka më tepër natyrën e një mase gjithëpërfshirëse. Për shembull, mund të formulohet: *“Mekanizma efektive për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve”*. E njëjta vërejtje vlen edhe për Rezultatin 2.5.3. Edhe ky rezultat duhet të riformulohet në përputhje me natyrën e një rezultati. P.sh *“Tarifa të studiuara të cilat maksimizojnë aksesin në drejtësi, me fokus grupet vulnerabël”*. Nga mënyra se si është shkruar ky rezultat parashikon rritje tarifash, duke paragjykuar rezultatet e një analize të thellë të sistemit të tarifimit, i cili në vetvete duhet të gjejë një balancë të shëndetshme mes aksesit në drejtësi, kostove administrative të procesit, si dhe identifikimin e drejtë të kategorive që përjashtohen nga tarifimi i shërbimeve gjyqësore. Në këtë analizë duhet të merret në konsideratë edhe organizimi dhe shpërndarja e bërë sipas hartës së re gjyqësore. Referuar masave të parashikuara për këtë objektiv, mendojmë që

---

<sup>21</sup>. Rezultati 2.5.1: *Sistemi i ndihmës juridike parësore dhe dytësore ka funksionalitet të plotë dhe siguron akses të barabartë në drejtësi për qytetarët në të gjithë vendin (burimet njerëzore, zyrat e ndihmës juridike parësore, avokatët ofruar të ndihmës juridike dytësore; mjetet e duhura, aftësia teknike, etj.)* Rezultati 2.5.2: *Përmirësohen mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve nga organet e ZAM (ndryshimet ligjore, zhvillimi institucional dhe i kapaciteteve).* Rezultati 2.5.3: *Rishikimi i sistemit të tarifave gjyqësore (rritja e tarifave dhe përcaktimi i përjashtimeve nga tarifata) në mënyrë periodike për të maksimizuar aksesin në gjykatë dhe për të siguruar akses për të gjitha grupet vulnerabël dhe vendosja e sistemeve të rikuperimit të kostove për palët përdorues të gjykatave.*

institucione pjesmarrëse duhet të jenë gjithashtu Dhoma Kombëtare e Avokatisë (për pjesën e trajnimit të avokatëve), Shkolla e Magjistraturës dhe Gjyqësori (për pjesën e ndërgjegjësimit dhe trajnimit vazhdues të gjyqtarëve lidhur me ndihmën juridike falas).

**Konkluzion:** Ky objektivi është në përputhje me Qëllimin e Politikës 2. Ai është i qartë, i nevojshëm dhe realist. Sugjerojmë rishikimin e terminologjisë të përdorur për rezultatet që synohen të përmbushen me arritjen e këtij objektivi, si dhe përfshirjen në institucionet pjesmarrëse edhe të Dhomës Kombëtare të Avokatisë (për pjesën e trajnimit të avokatëve), Shkollës së Magjistraturës dhe Gjyqësori (për pjesën e ndërgjegjësimit dhe trajnimit vazhdues të gjyqtarëve lidhur me ndihmën juridike falas).

### Rezultati 2.5.1

*“Sistemi i ndihmës juridike parësore dhe dytësore ka funksionalitet të plotë dhe siguron akses të barabartë në drejtësi për qytetarët në të gjithë vendin (burimet njerëzore, zyrat e ndihmës juridike parësore, avokatët ofruar të ndihmës juridike dytësore; mjetet e duhura, aftësia teknike, etj.)”*

Ky rezultat lidhet me dy aspekte: së pari, mefunksionalitetin e sistemit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, dhe, së dyti, me aplikimin e këtij sistemi në të gjithë vendin, pa baza diskriminuuese, në përputhje me kategoritë që përfitojnë prej saj. Sa i takon pjesës së vendosur në kllapa dhe që lidhet me aktivitetet që duhet të përmbushen për të rritur kapacitetet e ndihmës juridike, sugjerojmë që ose të përfshihen si pjesë e Rezultatit (konsolidim i burimeve dhe infrastrukturës) ose të shmangen dhe formulohen si masa.

Rezultati 2.5.1 është në përputhje me Objektivin 2.5. Siç e sqaruam edhe më sipër në kuadër të Objektivit 2.4, një nga mënyrat e arritjes së aksesit në drejtësi është funksionimi efektiv i ndihmës juridike falas. Ndërkohë që kuadri ligjor për ndihmën juridike është plotësuar, sfida mbetet zbatimi i tij në të gjithë territorin, aplikimi në mënyrë të barabartë, rritja e kapaciteteve të ndihmës Juridike Falas (NJF) dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve. Ky rezultat vlerësohet si realist dhe i domosdoshëm.

Ky rezultat është në linjë vazhdimësie me parashikimet e SND I: Objektivi 3: *Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane; Aktiviteti 3.03: Krijimi i një sistemi të drejtë dhe funksional të ndihmës falas për individët dhe grupet në nevojë.*

Masat në përmbushje të këtij Rezultati (2.5.1 -2.5.9) vlerësohen si të plota dhe të formuluar qartë.

Ky rezultat ka për indikatorë “% e aplikimeve të pranuar për të marrë ndihmë juridike parësore falas” si dhe “% e aplikimeve të pranuar për të marrë ndihmë juridike dytësore falas”. Sa më i madh numri i personave që përfitojnë nga ndihma juridike, aq më funksional është sistemi e për pasojë aksesit në drejtësi i shtresave vulnerabël. Një indikator tjetër që tregon për mat ndikimin e ndihmës në aksesin në drejtësi është edhe indikatorin “% e buxhetit të shtetit akorduar NJF.”

**Konkluzion:** Ky rezultat lidhet me funksionalitetin e një prej sistemeve më të rëndësishme për aksesin në sistemin e drejtësisë, atë të ndihmës juridike. Ai është në përputhje me Objektivin 2.4, aktual dhe i domosdoshëm.

### Masa 2.5.1

*“Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të ligjit “Për ndihmën juridike falas” për të drejtat e tyre për ndihmë dhe akses në institucione, të cilat mund të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre.”*

Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitim e saj përbën detyrim ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017) dhe njëkohësisht premisë për funksionimin e sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi. Në këtë këndvështrim masa është e nevojshme për të arritur Rezultatin 2.5.1 dhe në përputhje me synimet e Objektivës 2.4 për rritjen e aksesit në drejtësi.

Referuar Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e DNJF për vitin 2020, konstatohet se kjo drejtori i ka kushtuar një vëmendje të shtuar informimit mbi sistemin e ndihmës juridike falas duke u ndalur në hartimin dhe publikimin e materialeve ndërgjegjësuese. Megjithatë, si prioritet në fokus të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore parashikohet të jetë ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe kushtet e përfitimit, si një ndër faktorët që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e numrit të rasteve të trajtuara. Në këtë aspekt, kjo masë vjen si përgjigje e problematikave të hasura në terren në lidhje me mungesën e informacionit mbi sistemin e ndihmës juridike. Në këtë aspekt, masa është aktuale dhe në koherencë me realitetin. Një masë e ngjashme gjendej edhe në SND I, nën Aktivitetin 3.03 f) *‘Fushatë ndërgjegjësimi’ midis Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës së Avokatisë, dhe KLGJ’*. Fakti që kjo masë është përfshirë sërish tregon se është ndërmarrë ose realizuar jo-mjaftueshëm në këtë drejtim dhe një parashikim i tillë është në përputhje me vetë konkluzionet dhe rekomandimet e DNJF.

**Konkluzion:** *Ndërgjegjësimi i popullsisë mbi sistemin e ndihmës juridike dhe aspekte të tjera të aksesit në drejtësi është një masë shumë e rëndësishme në funksion të Objektivit Strategjik për të pasur efektivitet në sistemin e ndihmës falas dhe akses në drejtësi. Masa është formuluar qartë, është në koherencë dhe aktuale.*

### Qëllimi i Politikës 3

*“Sistemi i drejtësisë penale po zhvillohet mbi parimet moderne të drejtësisë Evropiane, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut brenda një qasje të integruar dhe me praktika të forta për parandalimin e krimit”.*

Politika 3 vendos si synim të saj që sistemi i drejtësisë penale të orientohet drejt parandalimit të krimit, dhe të kujdeset që të dënuarit, në përfundim të dënimit, ose gjatë kohëzgjatjes së tij, të kenë mundësi të risocializohen, riintegrohen në shoqëri dhe të kenë mundësi reale rehabilitimi. Këto janë parimet moderne të drejtësisë evropiane dhe synojnë që sistemi i drejtësisë penale, nëpërmjet institucioneve të drejtësisë penale, ato shtetërore dhe të gjyqësorit, të fokusohet drejt uljes së përgjithshme të nivelit të kriminalitetit në shoqëri dhe zbutjes së pasojave negative që vijnë nga një shoqëri me probleme të kriminalitetit në të gjitha grupmoshat dhe shtresat e shoqërisë.

Arritja e qëllimeve të vendosura në këtë politikë nuk ndikon vetëm në çështjet e kriminalitetit dhe politikave penale, por shënon edhe një hap drejt emancipimit social të Shqipërisë dhe pranimit të diferencave shoqërore e respektimit të të drejtave të njeriut.

Lidhur me politikën penale, SND I parashikonte dy fokuse kryesore, së pari, rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale (Politika 4) dhe rritjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit

(Politika 6). Këto dy drejtime ishin në koherencë të plotë edhe me vetë qëllimin e reformës në drejtësi, kyçi i së cilës ishte pikërisht ndëshkimi i kriminalitetit nëpërmjet një drejtësie të pavarur dhe forcimi i kapaciteteve shtetërore e të drejtësisë në këtë drejtim.

Formulimi që është bërë në SND II, duke mos parashikuar sërish nevojën për konsolidimin e institucioneve të hetimit dhe gjyqimit të veprave penale, vecanërisht korrupsionit, nuk është i plotë, pasi nevoja për t'a konsideruar këtë komponent sërish si qëllim të reformës edhe për katërvjeçarin e dytë është shumë e rëndësishme dhe aktuale. Ky mendim përforcohet edhe nga vetë objektivat që ka vendosur SND II, ku një prej objektivave me më shumë masa është pikërisht Objektivi 3.2, i cili kërkon një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv operacional sipas standardeve evropiane dhe hetim efikas, si dhe ndjekja e korrupsionit dhe e krimit të organizuar, i cili do të trajtohet i plotë në vijim (ku është përfshirë Prokuroria e Përgjithshme, SPAK dhe BKH).

Pra, për të pasur një vijimësi logjike dhe kronologjike, duke iu referuar edhe ngritjes së organeve të reja, hallka të të njëjtit mekanizëm (si p.sh. BKH), të cilat nuk ishin parashikuar në SND I, do të ishte e nevojshme që Politika 3 të përmbante të shprehur rëndësinë e funksionimit efikas dhe eficient të organeve të hetimit. Duke qenë se një ndër "investimet" më të mëdha në sektorin e prokurorisë ishte ngritja e SPAK dhe BKH, edhe për shkak të sensibilitetit të lartë publik që kanë çështjet që hetojnë këto organe, mirëqeverisja e prokurorisë dhe e hetimit në Shqipëri do të varet gjithashtu nga suksesi i këtyre organeve. Nuk mund të thuhet se në katër vitet e SND I u arrit të përmbylej politika penale "ndëshkuese", kur organet u krijuan me vonesë dhe filluan të japin rezultatet e para vetëm dy vitet e fundit<sup>22</sup>. Qasja më e përshtatshme kërkon një bashkëekzistencë të të dyja metodave, si ndëshkuese, edhe restauruese.

Politika 3 realizohet përmes pesë objektivave: 1. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar, duke synuar një qasje të integruar të zinxhirit të institucioneve të drejtësisë dhe një qasje restauruese të drejtësisë, duke zëvendësuar qasjen ndëshkuese ekzistuese; 2. Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv operacional sipas standardeve evropiane, si dhe hetim efikas, ndjekje të korrupsionit dhe krimit të organizuar; 3. Përmirësimi i drejtësisë për të mitur, duke garantuar një drejtësi miqësore ndaj të miturve, e cila mbron interesin më të mirë të tyre; 4. Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdor standardet operacionale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, por edhe mbështet ri-socializimin, ri-integrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira të BE-së dhe është pranuar nga gjykatat dhe prokuroria si një alternativë e mirë ndaj burgimit; dhe 5. Zhvillimi i një sistemi efikas burgjesh bazuar në strategjinë për reformën e burgjeve në vazhdim, e cila siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane individuale për zhvillimin e çështjeve.

Të pesë objektivat së bashku e përmbushin Qëllimin e Politikës 3, por në këtë Studim është vendosur të analizohet Objektivi 3.2 për shkak të rëndësisë emergjente që ka ai dhe impaktit të lartë që do të sillte për sistemin e drejtësisë suksesi i hetimit të korrupsionit e krimit të organizuar. Gjithashtu, lufta kundër këtyre fenomeneve është një ndër kërkesat kryesore ndaj Shqipërisë për procesin e integritetit evropian.

---

<sup>22</sup>Shënim i autorit: Më datë 19 Dhjetor 2019 janë emëruar 8 (tetë) prokurorë dhe ka filluar funksionimi i Prokurorisë së Posaçme. Gjatë vitit 2020 (në datat 31 Janar 2020, 21 Maj 2020 dhe 14 Korrik 2020) janë emëruar dhe pesë prokurorë të tjerë. Për dy prokurorë të tjerë, të përzgjedhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, deri në fund të vitit 2020 nuk kishte përfunduar akoma procedura e emërimit, sepse ata nuk kishin përfunduar akoma vetingun me vendim të formës së prerë. Aktualisht në Prokurorinë e Posaçme ushtrojnë funksionet 14 (katërmëdhjetë) prokurorë. Marrë nga [www.spak.al](http://www.spak.al).

## Objektivi specifik 3.2

*“Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv operacional sipas standardeve evropiane dhe hetim efikas dhe ndjekja e korrupsionit dhe e krimit të organizuar”.*

Objektivi synon që prokuroria të përmbushë misionin e saj në funksion të hetimit të gjithanshëm, të pavarur dhe të shpejtë, e vecanërisht t’i kushtojë një rëndësi të posaçme rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Pra, fillimisht, në këto raste, prokuroria nxitet të bëjë një hetim proaktiv, që nënkupton: së pari, atë lloj hetimi ku procesi i mbledhjes së provave kryhet njëkohësisht me lindjen e dyshimit për kryerjen e veprës së dyshuar penale; së dyti, atë lloj hetimi që nisët nga prokurorinë mungesë të një kallëzimi; dhe së treti, çdo hetim i cili është dukshëm më i zgjeruar se kallëzimi origjinal. Mëtej, prokuroria nxitet të punojë vecanërisht mbi çështje të ndërlikuara, për shembull, ato çështje ku subjekt i hetimit është një funksionar i lartë publik, çështjet të cilat kanë një numër të madh të pandehurish, ose një numër të madh veprash penale që passjellin pasoja të rënda për jetën dhe pasurinë e personave ose shkaktojnë dëm të madh ekonomik, të cilat rezultojnë në konfiskimin e asetëve me vlera të mëdha, etj.

Gjithashtu, që hetimi të jetë efikas, kërkohet që të përdoren teknika të posaçme të hetimit, sic janë metodat speciale të hetimit sipas Kodit të Procedurës Penale dhe parashikimeve të tjera ligjore, përdorimi i të cilave nuk është i autorizuar për të gjitha llojet e veprave penale. Të tilla janë veprimet simuluese, infiltrimi në përbërje të grupit kriminal, dorëzimi i kontrolluar, mbrojtja e dëshmitarit, si dhe teknika të tjera si: vendimet për kontroll në rastet e hetimeve të veprave penale të korrupsionit; sigurimi me anë të letërporosisë i provave që gjenden jashtë vendit; sigurimi i provave kompjuterike; përdorimi i provave mjekoligjore (ADN, etj.); përdorimi i ekspertizës kontabël; përgjimi elektronik; marrja dhe përdorimi i informacioneve nga vende të huaja; përdorimi i bashkëpunëtorëve të drejtësisë ose bashkëpunimi në marrëveshjet e fajësisë; etj.

Thelbësore është që ky hetim të jetë i suksesshëm, pra që procedimi të dërgohet për gjykim, e në përfundim të tij të jepet fajësi ndaj të pandehurit, ose prokurori të arrijë të tregojë se veprimet hetimore kanë qenë shterruese pavarësisht vendimit të gjykatës.

**Konkluzion:** *Ky objektivi është aktual dhe i realizueshëm brenda kohëzgjatjes së SND II për shkak të karakterit të tij thelbësor për shtetin shqiptar, për besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, për krijimin e kulturës së ndëshkimit në vend të asaj të pandëshkueshmërisë, si dhe për procesin e integritetit të vendit në BE. Rezultatet dhe masat mbi të cilat mendohet që të realizohet ky objektivi do të analizohen në vijim dhe në fund do të mund të konkludohet nëse, në tërësinë e tyre, ato e përmbushin ose jo objektivin. Një indikator i vlefshëm për matjen e rezultateve në drejtim të operacionalitetit proaktiv të prokurorisë do të ishte “% e rasteve të hetimeve proaktive në krahasim me rastet e referuara nga policia apo kallëzimet në prokurori”.*

### Rezultati 3.2.1

*“Prokuroria e Përgjithshme ka mekanizma të përmirësuar për monitorimin e aktiviteteve lokale, procedura operationale të përcaktuara, numër personeli të përshtatshëm, eficiencë dhe produktivitet të përmirësuar në hetimet kundër pastrimit të parave, zbatim të përmirësuar të procesit të hetimit, përfshirje në punën me kërkimet mbi krimet dhe punë analitike përkatëse, dhe sistem efektiv për zbatimin e udhëzimeve të PP dhe DPPSH”.*

Rezultati i parë që kërkohet të arrihet lidhet me përmirësimin e punës së Prokurorisë së Përgjithshme. Reforma në drejtësi solli ndryshime thelbësore sa i takon funksionimit të sistemit të prokurorisë në tërësi, rolit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe “delegimit” të shumë

kompetencave të PP të mëparshme tek KLP e sapokrijuar. Kështu, Prokuroria e Përgjithshme: propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme; siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë; nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët; raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit; përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga SPAK; drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Policisë Gjyqësore; etj. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përgjegjësi të një natyre tjetër. Ai garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

Për të ushtruar këto funksione Rezultati 3.2.1 kërkon që PP të realizojë njëherësh dy nën-rezultate:

Nën-rezultati i parë kërkon që PP duhet të përmirësojë mekanizmat e saj matës dhe monitorues për prokuroritë pranë rretheve gjyqësore, të hartojë rregulla dhe udhëzime për zhvillimin e aktivitetit të tyre dhe të sigurojë stafin e mjaftueshëm dhe të nevojshëm për realizimin me efikasitet të aktiviteteve të saj, përfshirë ngritjen e një sistemi efikas për të kontrolluar nëse udhëzimet e saj po zbatohen apo jo nga prokuroritë. Gjithashtu, PP duhet të mbledhë e analizojë të dhëna, të cilat i shërbejnë për përcaktimin e gjendjes së kriminalitetit, llojit të kriminalitetit, ecurisë së tij, etj., në mënyrë që të përcaktohen, në mënyrë të studiuar, politikat penale që duhen ndjekur.

Lidhur me nën-rezultatit e dytë, kërkohet që PP të rrisë produktivitetin e saj në hetimet kundër pastrimit të parave dhe të përmirësojë tërësi procesin e hetimit. Ky nën-rezultat lidhet drejtpërdrejtë me veprimin e saj si organ që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në GjL dhe GjK. Këtu rezultati duhet të ishte formuluar pak më qartë sepse, duke qenë se i referohet vetëm PP, ai duhet t'i përmbahet përgjegjësi dhe detyrave të PP. Për pjesën e veprimit të PP si organ që heton dhe përfaqëson akuzën, duhet të dilte më e qartë se kjo është kompetencë vetëm në disa raste, të parashikuara nga ligji.

Në rastin kur nën-rezultati i dytë duhet të qëndrojë sic është, atëherë duhet që në masat e parashikuara të mos parashikohet vetëm PP, por edhe SPAK, si dhe prokuroritë e sistemit në tërësi. Në fakt, për SPAK dhe BKH janë parashikuar rezultate më vete dhe masa konkrete, siç do të shihet në vijim.

Paraprakisht, vërejmë se masat që parashikohen në funksion të këtij rezultati lidhen me rishikimin e ligjit për prokurorinë, rishikimin e akteve nënligjore që nxjerr PP (si përsëmbull, udhëzime të përgjithshme të detyrueshme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, sipas kufizimeve që përcakton ligji; përcakton strukturën e përgjithshme dhe rregulloren standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm<sup>23</sup>) dhe trajnimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore mbi ligjin e prokurorisë. Këto masa nuk e përmbushin plotësisht rezultatin pasi ato nuk përfshijnë në mënyrë të plotë strukturën e PP. Rekrutimi dhe trajnimi i stafit administrativ të PP, rritja e kapaciteteve të IT, janë gjithashtu komponentë shumë të rëndësishëm në performancën tërësore të PP dhe për to duhet të ishte parashikuar, të paktën, një masë më vete.

**Konkluzion:** Ky rezultat i referohet ekskluzivisht PP dhe ai do të duhej të përmbajë vetëm komponentë që lidhen me PP. Mënyra sesi është shprehur lë hapësirë për paqartësi. Megjithatë, konkludohet se interpretimi i duhur i qëllimit të këtij rezultati del duke e lidhur atë ngushtësisht me dy rolet kryesore të PP, atë të ndikimit të saj në sistemin e prokurorisë dhe, atë të organit hetues dhe përfaqësues të akuzës në çështje të caktuara.

---

<sup>23</sup>Ligj 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë";

### Masa 3.2.4

*“Konsultimi i paketës së propozimeve me magistratët/prokurorët/avokatët/OJF (workshop)/hartimi i raporteve të konsultimit/finalizimi i paketës dhe miratimi i ligjit organik të PP”.*

Kjo masë parashikon se Prokuroria e Përgjithshme do të ndërrmarë nismën për rishikimin e ligjit organik të saj, dhe përpara miratimit, do t'a kalojë atë nëpër një proces të gjerë konsultimi me magistratë, avokatë dhe OJF, dhe do të hartojë raporte bazuar në rekomandimet e dala nga procesi i konsultimit.

**Konkluzion:** *Kjo masë shihet e nevojshme dhe e rëndësishme për t'u realizuar sipas afateve të parashikuara në SND II, viti 2021, për shkak se nevojitet një reflektim i të gjitha institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në sistemin e prokurorisë, për të analizuar nëse ndarja e kompetencave midis disa organeve (KLP, PP, SPAK, BKH) ka krijuar ndonjë vështirësi në praktikë, apo mbivendosje që pengon veprimin eficient të këtyre organeve. Lidhja që ka ligji me të qenurit eficient të organit bën që kjo masë të jetë në përputhje me objektivin.*

### Rezultati 3.2.2

*“Zyrat e prokurorisë riorganizohen bazuar në hartën e re gjyqësore, të pajisura dhe operacionet e tyre të përmirësuara, dhe efikasiteti i tyre i qëndrueshëm”.*

Efienca e sistemit të drejtësisë lidhet drejtpërdrejtë me organizimin e kapaciteteve të saj dhe kjo vlen si për gjykatën, edhe për prokurorinë. Për këtë arsye, një ndër rezultatet që synohet të arrihet lidhet në mënyrë konkrete me çështjet e riorganizimit të zyrave të prokurorisë pasi të miratohet harta e re gjyqësore. Ky është një proces i cili kryhet nga KLGj në bashkëpunim me MD, por pasojat e këtij procesi ndikojnë në tërësi edhe në sistemin e drejtësisë penale, duke nisur nga prokuroritë, e deri tek burgjet apo shërbimi i provës.

**Konkluzion:** *Ky rezultat është në përputhje me objektivin dhe Qëllimin e Politikës 3. Ky rezultat është i ndërvarur nga përcaktimi i hartës së re gjyqësore, ndaj edhe në SND II nuk ka të parashikuar një masë konkrete dhe të posaçme për arritjen e këtij rezultati. Megjithatë, masa 3.2.1 mund të konsiderohet si një masë që e përmbush këtë rezultat, pasi ajo i referohet në tërësi përmirësimit të menaxhimit strukturor dhe administrimit të prokurorisë, dhe të shtrihet ajo në një kohë të pacaktuar, duke nisur nga viti 2021, sic e parashikon Plani i Veprimit i SND II, e në vazhdim derisa të miratohet harta e re gjyqësore.*

### Masa 3.2.1

*“Përmirësimi i menaxhimit strukturor dhe administrimit të prokurorisë nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit eficient të burimeve njerëzore (152 shtesë)”.*

Kjo masë kërkon nga PP që, së pari, të përmirësojë menaxhimin strukturor të organit të prokurorisë, nëpërmjet përcaktimit të një strukture të përgjithshme sa më funksionale të prokurorisë dhe, së dyti, të ndihmojë në procesin e administrimit të prokurorisë, duke miratuar rregulloren standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, por gjithashtu duke përcaktuar rregulla të detajuara për procedurat e shpërndarjes së çështjeve, të cilat sigurojnë transparencë dhe mundësi të mjaftueshme verifikimi, apo kriteret për shpërndarjen e çështjeve, bazuar në ngarkesën dhe specializimin e prokurorëve, etj.

Masa vetë parashikon gjithashtu detyrimin e planifikimit dhe menaxhimit eficient të burimeve njerëzore dhe kjo lidhet drejtpërdrejtë me strukturën e prokurorive, përcaktimin e

numrit të përgjithshëm të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, përgjegjësi e PP-së, numrin e prokurorëve në prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe apeleve, në bashkëpunim me KLP, por edhe me cështje që lidhen me buxhetin dhe mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm (PP propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm).

Masa, në tekstin e saj, ka vendosur edhe një parashikim për 152 vende shtesë. Ky parashikim tregon se nevoja për shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në prokurori është e lartë dhe emergjente. Megjithatë, vlen të përmendet se në formulimin e masës duhet të shmangen shifra apo parashikime konkrete.

**Konkluzion:** *Kjo masë është relevante me Rezultatit dhe e realizueshme, edhe pa u miratuar përfundimisht harta gjyqësore. Ristrukturimet, lëvizjet e brendshme, rishpërndarja e burimeve, procesi i planifikimit, etj, janë veprimtari që PP dhe prokuroritë vetë do të duhet t'i realizojnë në një frekuencë, të paktën 5-vjecare, me qëllim rritjen e performancës së tyre.*

### Rezultati 3.2.3

*“SPAK e krijuar dhe aktiviteti i tij i konsoliduar”.*

Rezultatet dhe masat që lidhen me SPAK janë të mbartura nga SND I për shkak të mosrealizimit të tyre në kohën e parshikuar, si rrjedhojë e vonesës në ngritjen e SPAK dhe për shkak të rëndësisë së madhe dhe aktuale që paraqet funksionimi i SPAK në kapacitete të plota dhe të përmirësuara.

Këto janë arsyet pse Rezultati kërkon që SPAK të jetë krijuar dhe të ketë një aktivitet të konsoliduar. Krijimi i SPAK nuk duhet interpretuar në mënyrë literale, pasi është pranuar se SPAK funksionon prej dhjetorit të vitit 2019, por do të duhet të interpretohet si plotësim i të gjithë bazës ligjore dhe nënligjore për funksionimin e tij dhe plotësim i strukturës dhe organikës së këtij institucioni. Qëllimi i dytë i vendosur në këtë rezultat është konsolidimi i aktivitetit të SPAK, që lidhet me qëndrueshmërinë, vijimësinë normale të aktivitetit të tij dhe përmirësimin, nëpërmjet procesit të trajnimit, të kapaciteteve të tij.

Për përmbushjen e Rezultatit, plani i veprimit të SND II ka parashikuar tre masa, të cilat analizohen në vijim.

**Konkluzion:** *Ky rezultat është në përputhje me Objektivin dhe Qëllimin e Politikës 3, i cili kërkon, në mënyrë të vecantë, efikasitet dhe proaktivitet në cështjet që janë në kompetencën e SPAK. Këtë qëllim SPAK mund t'a përmbushë vetëm në momentin që ofron qëndrueshmëri, vijimësi normale të aktivitetit të tij dhe përmirësimin, nëpërmjet procesit të trajnimit, të kapaciteteve të tij.*

### Masa 3.2.10

*“Përgatitja e analizave të rregullta ndër-institucionale mbi efikasitetin e hetimeve ndaj pastrimit të parave, hartimi i raporteve të analizës mbi evidentimin e problematikave dhe përgatitja e paketës së rekomandimeve”.*

Kjo masë kërkon që SPAK të realizojë analiza mbi efikasitetin e hetimit të tij të rasteve të pastrimit të parave, raporte me qëllim evidentimin e problematikave të hasura dhe të japë rekomandime aty ku është e nevojshme. Për realizimin e kësaj mase, Plani i Veprimit të SND II ka përcaktuar SPAK si organ të vecantë dhe tërësisht të pavarur në realizimin e detyrave të tij. Megjithatë Masa kërkon që të përgatiten analiza të rregullta ndër-institucionale.

Nuk është shumë e qartë se cilat organe të tjera do të kontribuojnë për këto analiza. Do të vlerësohej si më i përshtatshëm roli që mund të luajë Prokurori i Përgjithshëm, si rrjedhim i

të drejtës së tij për të mbledhur informacion, për t'a përpunuar atë dhe për të raportuar cdo vit mbi gjendjen e kriminalitetit në vend, përfshirë këtu edhe veprat penale që janë kompetencë e SPAK. Gjithashtu, pjesë e këtyre analizave mund të jetë edhe KLP, e cila analizon raportet vjetore të SPAK.

**Konkluzion:** Kjo masë është në përputhje me Rezultatin dhe ndihmon në çështje të llogaridhënies, përgjegjësisë dhe komunikimit me publikun. Megjithatë, edhe pse qëllimi i masës është shumë i vlerësueshëm pasi lidhet me mundësinë që SPAK të kontrollojë dhe përmirësojë vetveten, për të bërë të mundur përmbushjen e saj është i nevojshëm një sqarim më i detajuar i veprimeve që mund të ndërmerren dhe organeve që mund të përfshihen në këtë proces. Kjo masë parashikohet të realizohet deri në përfundim të SND II, parashikim i cili është pozitiv, sepse lejon qartësimin në detyra më konkrete të kësaj mase dhe në bërjen efektive të saj.

### Masa 3.2.11

*“Konsolidimi i burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të SPAK (5 + kapacitete administrative)”.*

U përmend edhe më sipër gjatë analizës që konsolidimi i burimeve njerëzore të SPAK është ndër komponentët kryesorë bazë të zhvillimit të aktivitetit të tij dhe thelbësor në suksesin e veprimtarisë së tij. Konsolidimi i burimeve njerëzore për një institucion të ri si SPAK dhe, çfarë është më e rëndësishme, për një ndër institucionet kyç të reformës në sistemin e drejtësisë, e bën këtë masë të jetë emergjente në zbatimin e saj.

Edhe pse për këtë masë është vendosur SPAK si institucioni përgjegjës për zbatimin e saj, ligji parashikon se procesi i rekrutimit të anëtarëve të SPAK është përgjegjësi e KLP-së. SPAK nga ana tjetër është tërësisht kompetent për kapacitetet administrative, procesin e planifikimit dhe buxhetin.

**Konkluzion:** Kjo është një masë relevante dhe në përputhje me Rezultatin dhe Objektivin 3.2 por duhet të parashikojë si organ zbatues të saj edhe KLP-në.

### Masa 3.2.14

*“Trajnimi i kapaciteteve institucionale të SPAK (trajnime/seminare)”.*

Kjo masë parashikon se SPAK duhet të realizojë procesin e trajnimit për administratën e institucionit. Edhe pse kjo masë ka qenë e parashikuar edhe në SND I, konkretisht masa 4.02 f, “Trajnimi i anëtarëve të SPAK dhe stafit administrativ. Krijimi i kurrikulave/trajnimit pilot”, sërish është i nevojshëm parashikimi i saj në SND II, si rrjedhojë e funksionimit të pjesshëm të SPAK përgjatë SND I, si në kohë, edhe në burime njerëzore.

Është me vend të theksohet rëndësia që ka trajnimi për këtë institucion. Në Kushtetutë, e më tej në ligj, SPAK është konceptuar si organ hetimor që ka karakteristikë faktin se është organi specializuar. Pra, SPAK duhet të përbëhet nga profesionistët më të mirë të fushës, të cilët duhet t'i nënshtrohen trajnimeve të specializuara për të qenë në gjendje të veprojnë si trupa që përdorin çdo lloj metode të avancuar dhe speciale për detektimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e veprave penale që ato kanë në përgjegjësi. Vështirësi të një natyre të vecantë ka edhe stafi administrativ i SPAK, për shkak të elementëve thelbësorë kufizues të disa të drejtave që iu vijnë si rrjedhojë e punës së tyre në këtë institucion. Të gjithë punonjësit duhet

të përmbushin kushte të vecanta, të parashikuara nga ligji i posaçëm<sup>24</sup>, për të qenë të përshtatshëm për këto pozicione.

Gjithashtu, SPAK, konkretisht, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe drejtuesit e sektorëve, kryejnë mbikëqyrjen administrative të marrjes në punë, trajnimit, disiplinës dhe vlerësimit të punonjësve dhe ekspertëve të Prokurorisë së Posaçme, si dhe i caktojnë ata të punojnë me prokurorët.

**Konkluzion:** *Kjo masë vazhdon të jetë relevante, edhe pse ka qenë e parashikuar në SND I. Kjo lidhet me vonesën në krijimin e SPAK dhe në funksionimin e pjesshëm të SPAK deri më tani si në prokurorë, edhe në burime njerëzore mbështetëse dhe infrastrukturë.*

#### Rezultati 3.2.4

*“BKH e krijuar dhe aktiviteti i saj i konsoliduar”.*

Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) është strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme.

Rezultati i fundit që kërkohet të arrihet në funksion të plotësimit të sistemit të prokurorisë është krijimi dhe konsolidimi i BKH, strukturë hetimore që ka munguar deri në vitin 2020<sup>25</sup>. Për shkak të mungesave të saj të mëdha në burime njerëzore dhe nevojës për t’u pasur sa më shpejt funksionale këtë hallkë shumë të rëndësishme të procesit hetimor nga SPAK, ky rezultat ka nevojë emergjente për t’u përmbushur.

Konsolidimi i aktivitetit të saj nënkupton që BKH është duke kryer detyrat në mënyrë plotësisht të qëndrueshme, sipas një strukture dhe organike të qartë e të plotësuar, sipas rregullave e udhëzimeve të hartuara e të miratuara dhe me profesionalitet.

Në përmbushje të këtij rezultati, plani i masave të SND II ka parashikuar gjithsej dy masa, të cilat do të analizohen në vijim.

**Konkluzion:** *Ky rezultat kërkon krijimin dhe konsolidimin e hallkës që ka munguar deri më tani dhe që është risi për Shqipërinë, BKH-në. Arritja e këtij rezultati është një hap i rëndësishëm në funksion të hetimit.*

#### Masa 3.2.12

*“Konsolidimi i burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të BKH (60+kapacitetet administrative)”.*

---

<sup>24</sup>Ligj 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

<sup>25</sup>Shënim i autorit: Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme dhe fillimit të ushtrimit të funksioneve nga kjo prokurori me datën 19.12 2019, procesi i përzgjedhjes së kandidatit për pozicionin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, ka qënë procesi më i rëndësishëm i organizuar në Prokurorinë e Posaçme, në drejtim të ngritjes së strukturës së Byrosë Kombëtare të Hetimit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin Nr.183, date 30.07.2020 ka emëruar Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, për një mandat pesëvjeçar, i cili fillon nga data 01.09.2020. Menjëherë pas fillimit punë të Drejtorit të BKH-së, ka filluar dhe procedura e përzgjedhjes së hetuesve të BKH-së, e cila nuk u përmyll dot brenda vitit 2020 dhe në prill 2021 është njoftuar sërish për hapjen e tridhjetë e dy vendeve vakante për hetues.

Kjo masë parashikon plotësimin me personel (drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe stafi administrativ i BKH), sigurimin e qëndrueshmërisë dhe trajtimin financiar<sup>26</sup>të tyre.

**Konkluzion:** *Bërja funksionale e BKH-së është një masë thelbësore për ecurinë e procesit hetimor, prandaj ajo është relevante dhe emergjente për t'u zbatuar. Afati i përcaktuar në Planin e Veprimit të SND II, viti 2022, është i përshtatshëm dhe i mundshëm për t'u realizuar.*

### Masa 3.2.15

*“Trajnimi i kapaciteteve institucionale të BKH (trajnime/seminare)”.*

Kjo masë parashikon se BKH duhet të realizojë procesin e trajnimit (një regjim rigoroz trajnimi dhe arsimimi, me një sërë modulesh vlerësimi) për administratën e saj. Kandidatët për drejtor, hetues dhe oficerë pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit, përpara emërimit, duhet të kenë përfunduar programin e nevojshëm të trajnimit dhe të kenë shfaqur aftësitë, që garantojnë kryerjen e detyrave sipas standardeve të kërkuara profesionale.

Masa duhet të kishte parashikuar si institucion bashkëpunues edhe SPAK, pasi kursi i trajnimit dhe arsimimit, standardet profesionale dhe sistemet e vlerësimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit miratohen nga Drejtori i BKH-së, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

**Konkluzion:** *Trajnimi i BKH-së është një masë relevante dhe e nevojshme për t'u realizuar sa më parë. BKH është një strukturë e specializuar dhe kërkon njohuri të thelluara e të avancuara për të përmbushur misionin e saj. Programet e trajnimit garantojnë rritje profesionale dhe azhornim me mjetet më të reja të hetimit.*

### Qëllimi i Politikës 4

*“Koordinimi dhe menaxhimi efikas dhe efektiv i sektorit në të gjitha institucionet në sektorin e drejtësisë”.*

Ky qëllim lidhet me koordinimin dhe menaxhimin efikas dhe efektiv të sistemit të drejtësisë. Koordinimi institucional ka qenë dhe mbetet një sfidë që duhet t'a adresojnë të gjitha institucionet e drejtësisë. Koordinimi është një proces i vazhdueshëm. Menaxhimi efikas dhe efektiv është gjithashtu një sfidë për sistemin, së cilës ende nuk i është dhënë vëmendja e duhur nga institucionet (KLGJ, KLP). Kjo pasi aktualisht institucionet e qeverisjes përballen me vakanca të shumta në sistem.

Pavarësisht se këto elemente kanë pasur mangësi në të kaluarën, tashmë organeve të sistemit të drejtësisë u kërkohet të koordinohen më mirë midis tyre, si dhe të administrojnë burimet e vëna në dispozicion në mënyrë efikase dhe efektive.

Një parashikim i ngjashëm ka ekzistuar edhe në SND 1. Konkretisht, në Objektivin 7 parashikohej: *‘Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të*

---

<sup>26</sup>Në mars të vitit 2021, Kuvendi miratoi shtesa të rëndësishme në ligjin 95/2016 për të rritur dhe përforcuar trajtimin financiar të Drejtorit të BKH-së, Nëndrejtorit të BKH-së, hetuesve të këtij institucioni dhe nëpunësve civil gjyqësor në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, në prokurorinë e posaçme dhe në Byronë Kombëtare të Hetimit<sup>26</sup>. Këto shtesa ishin të domosdoshme për të garantuar një sistem hetimi të pavarur ndaj çdo influence politike, të paanshëm, të përgjegjshëm, të drejtë e profesional.

varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara'. Aktiviteti 7.06 i këtij Objektivit parashikonte: 'Projektimi dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit, aktiviteteve operacionale dhe të kontrollit dhe funksionimi financiar i MD dhe institucioneve të tjera (KLGJ, KLP, Inspektoriati i ri, Këshilli i Emërimeve) për të mundësuar që ato të menaxhojnë procesin e reformës (lidhur me Objektivin 5)'. Ndërkohë, Aktiviteti 7.07 parashikonte: 'Do të ofrohet mbështetje për të gjitha institucionet e reja dhe të ndryshuara me qëllim që të sigurohet zbatimi i sistemeve të reja të menaxhimit, aktiviteteve operacionale dhe të kontrollit dhe funksionimit financiar të MD (KLGJ, KLP, Inspektoriati i ri, Këshilli i Emërimeve) për të mundësuar që ato të menaxhojnë procesin e reformës'.

Për sa i takon SND I, referuar Raporteteve të Monitorimit Periodik<sup>27</sup> të periudhave/viteve të ndryshme që janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, aktivitetet e pikës 7.06 dhe 7.07 kanë mbetur të parealizuara në kushtet kur ILD është krijuar në Shkurt 2020. Kjo mund të jetë një nga arsyet pse është përfshirë në Dokumentin Strategjik për SND II.

**Konkluzion:** Koordinimi institucional është sfidë për të gjitha institucionet e drejtësisë. Me të drejtë, ai është gjykuar që të vendoset si Objektiv Strategjik me efekt për të gjitha institucionet.

#### Objektivi Specifik 4.1

*"Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare".*

Objektivi Specifik 4.1 lidhet me zhvillimin e sektorit të teknologjisë së informacionit, në fushën e drejtësisë ku progresi mbetet ende në faza fillestare. Megjithëse është formuluar në një fjali të gjatë që krijon premisa për konfuzion dhe paqartësi, kuptojmë se Objektivit orientohet në disa drejtime: Së pari, në një sistem të përditësuar të menaxhimit të çështjeve; së dyti, në regjistrimin elektronik të të dhënave gjyqësore për të tre fushat, si dhe lidhje mes regjistrave me bazën e të dhënave me qëllim zhvillimin e një sistemi të integruar të drejtësisë elektronike. Në terma praktikë kjo do të thotë ndërlidhje midis sistemeve (atij të prokurorisë dhe gjyqësor) në mënyrë që identifikimi dhe kërkimi i çështjeve (të natyrave të ndryshme) të jetë i mundshëm vetëm me 'një klik' dhe në kohë reale. Kjo do të sillte një sistem më efikas dhe do të shmangte kohën dhe burokracitë në komunikimin dhe ndërveprimin mes institucioneve (Gjykata, KLGJ, Prokurori, KLP). Nga këndvështrimi i ILD kjo do të thotë akses i menjëhershëm në këtë sistem të integruar dhe informacion të plotë për ecurinë e dosjes përkatëse, duke shkurtuar kohën e komunikimit zyrtar me gjykatën/prokurorinë, dhe duke e bërë punën e ILD-së më efikase dhe efektive.

Ky Objektiv është në përputhje të plotë me Qëllimin e Politikës 4 për arritjen e një koordinimi dhe menaxhimi efikas dhe efektiv të drejtësisë. Ai adreson një problem të madh që ekziston në sistemin e drejtësisë. Sistemet elektronike të organeve/institucioneve të ndryshme (duke përfshirë gjykatat dhe prokuroritë) janë jo vetëm të vjetëruara, por nuk janë të integruara. Progresi në sektorin e teknologjisë së informacionit, si nga ana e gjyqësorit ashtu dhe prokurorisë mbetet ende i vogël. Progres në këtë drejtim do të kemi vetëm nëse sistemet e menaxhimit të çështjeve do të zëvendësohen me të reja. Nga ana tjetër, mangësitë në gjenerimin e të dhënave statistikore të performancës ndikojnë në matjen, analizimin e rezultateve dhe adresimin e problemeve. Gjithashtu ato ndikojnë dhe në saktësinë e

<sup>27</sup><https://www.drejtesia.gov.al/plani-i-veprimite-strategjise-ndersektoriale-te-drejtisesie/>

raportimeve që bëjnë institucionet, sipas detyrimeve që u burojnë nga kuadri ligjor në fuqi (sipas të cilit institucionet e sistemit të drejtësisë, ILD, KLP, KLGJ, PP raportojnë çdo vit në Kuvend). Ky është një Objektiv madhor që përfshin jo vetëm investime në aspektin infrastrukturor, por edhe nëburimet njerëzore. Në këtë aspekt Objektiv i është aktual dhe i domosdoshëm.

Një parashikim i ngjashëm ka ekzistuar edhe në SND 1. Konkretisht, në Objektivin 7 parashikohet: *'Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara'*. Aktiviteti 7.06 i këtij Objektiv parashikonte: *'Projektimi dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit, aktiviteteve operacionale dhe të kontrollit dhe funksionimi financiar i MD dhe institucioneve të tjera (KLGJ, KLP, ILD, KED) për të mundësuar që ato të menaxhojnë procesin e reformës* (lidhur me Objektivin 5). Ndërkohë që Aktiviteti 7.07 parashikonte: *'Do të ofrohet mbështetje për të gjitha institucionet e reja dhe të ndryshuara me qëllim që të sigurohet zbatimi i sistemeve të reja të menaxhimit, aktiviteteve operacionale dhe të kontrollit, si dhe funksionimit financiar të MD (KLGJ, KLP, Inspektoriati i ri, Këshilli i Emërimeve) për të mundësuar që ato të menaxhojnë procesin e reformës'*.

Referuar Raporteve të Monitorimit Periodik<sup>28</sup> të periudhave/viteve të ndryshme që janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë aktivitetet e pikës 7.06 dhe 7.07 kanë mbetur të parealizuara në kushtet kur edhe ILD është krijuar në Shkurt 2020.

Gjithashtu, Referuar Raportit të Monitorimit të Planit Strategjik të KLGJ për periudhën Korrik 2019-Korrik 2020<sup>29</sup>, Masa 3.1 *"Rritja e efikasitetit, saktësisë së të dhënave dhe efektivitetit në menaxhimin e çështjeve gjyqësore nëpërmjet zhvillimit të një sistemi elektronik të unifikuar për menaxhimin e çështjeve sipas standardeve ndërkombëtare"*, në kuadër të Objektivit 1: *"Rritja e efikasitetit, saktësisë së të dhënave dhe efektivitetit në menaxhimin e çështjeve gjyqësore nëpërmjet zhvillimit të një sistemi elektronik të unifikuar për menaxhimin e çështjeve sipas standardeve ndërkombëtare"*, është ende në proces.

Referuar Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2020 mbetet prioritet ende vijimi i punës së nisur lidhur me *"sistemin e menaxhimit të çështjeve" (CAMS), dhe i përshtatjen e këtij sistemi sipas nevojave të organit të prokurorisë, për të mundësuar digjitalizimin, me prioritetet: 7.1 Sigurimin e funksionalitetit të sistemit CAMS/modernizimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve me teknologji të avancuara. i) Integrimi i rrjeteve; ii) Vlerësimi i kapaciteteve humane dhe teknologjike, përlllogaritja e kostove dhe gjetja e financimeve, për vënien në funksionim të këtij sistemi apo në pamundësi, të një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve në prokurori. 7.2 Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit dhe përfitim të të dhënave statistikore nëpërmjet një sistemi të automatizuar dhe funksional në sistemin e prokurorisë*<sup>30</sup>

Ndërkohë nuk vërehet lidhje me Objektivat Strategjike të vetë Planit Strategjik të KLP-së dhe ILD-së.

Si rrjedhojë mund të themi se Objektiv i është në kronologji me masat dhe prioritetet e SND I, KLGJ-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Në lidhje me institucionet pjsëmarrëse sugjerojmë që të shtohet edhe Prokuroria, sa kohë do jetë pjesë e sistemit të integruar dhe mbajtjes së të dhënave, apo dhe Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, misioni i së cilës është hartimi i

<sup>28</sup><https://www.drejtesia.gov.al/plani-i-veprimit-te-strategjise-ndersektorale-te-drejtësisë/>

<sup>29</sup><http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/06/Raport-i-Monitorimit-te-Planit-Strategjik-korrik-2019-korrik-2020.pdf>, fq 23, fq 59

<sup>30</sup> Raport i prokurorit të përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2020 [https://www.parlament.al/Files/Kerkese/20210518105256Raporti\\_Vjetor\\_2020\\_Kuvendit\\_Kriminaliteti.pdf](https://www.parlament.al/Files/Kerkese/20210518105256Raporti_Vjetor_2020_Kuvendit_Kriminaliteti.pdf), fq 263

politikave, për sistemin e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë dhe garantimi i funksionimit efektiv të sistemeve të teknologjisë së përpunimit të informacionit dhe të të dhënave.

**Konkluzion:** *Objektivi Specifik është ambicioz, por i domosdoshëm për të integruar të dhënat midis sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, në kuadër të një koordinimi dhe bashkëpunimi efikas ndër-institucionale si dhe matjen më të mirë të performancës së këtyre institucioneve. Një sistem i tillë ndikon në rritjen e eficiencës së sistemit gjyqësor, të prokurorisë, si dhe sistemit llogaridhënës. Objektivi është i domosdoshëm në përmbushje të Qëllimit të Politikës 4, aktual për nga rëndësia që mbart dhe realist. Sugjerojmë riformulimin e tij në funksion të qartësisë.*

#### **Rezultati 4.1.1**

*“Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore i përditësuar dhe plotësisht operacional bazuar në regjistrat elektronikë”.*

Ky rezultat kërkon që në përmbushje të Objektivit 4.1 të kemi një sistem të ri dhe funksional të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Në këtë aspekt, Rezultati 4.1.1 është në përputhje me Objektivin Specifik 4.1.

Siç e përmendëm edhe më sipër, KLGJ ka në proces punën për sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS dhe ARKIT) . Ajo ka ngritur një grup të posaçëm pune dhe po punon me kompaninë përkatëse që do të mirëmbajë dhe zhvillojë sistemin<sup>31</sup>. Për vitin 2020, KLGJ raporton në Raportin Vjetor Mbi Veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për Vitin 2020 se *“në bashkëpunim me kompaninë “KREATX” shpk. ka bërë të mundur instalimin e versionit të përmirësuar të sistemit të menaxhimit të çështjeve ICMIS, duke shtuar në këtë version 84 zhvillime të reja, shumë të rëndësishme për sistemin gjyqësor dhe punën në KLGJ<sup>32</sup>.”* Në këtë aspekt, ky rezultat vjen edhe në zbatim të punës së deritanishme të bërë nga KLGJ dhe prioriteteve të saj për të ardhmen.

Rezultati matet nëpërmjet indikatorit të *“% e gjykatave për të cilat sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve është ngritur dhe funksionon me kapacitet të plotë”*, si dhe *“% e trupës gjyqësore/ /inspektorë dhe i stafit administrativ të trajnuar mbi përdorimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve”*. Këta indikatorë janë të përshtatshëm për matjen e këtij Rezultati. Gjithashtu një indikator tjetër që mat funksionalitetin e sistemit dhe përditësimin e tij mund të jetë *“% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni është i aksesueshëm online dhe i përditësuar”*.

**Konkluzion:** *Rezultati është në përputhje me Objektivin Specifik 4.4. Ai është i formuluar qartë dhe mbetet realist dhe i domosdoshëm. Sugjerojmë të përfshihet si indikator që mat funksionalitetin e sistemit dhe përditësimin e tij “% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni është i aksesueshëm online dhe i përditësuar”.*

<sup>31</sup>Shih Raportin e Monitorimit për Planin Strategjik të KLGJ (Korrik 2019-Korrik 2020) për kompaninë që do të mirëmbajë dhe zhvillojë sistemin, fq 23

<sup>32</sup>Shih Raportin e lart përmendur, fq 20 Për më tepër: <http://klgj.al/ep-content/uploads/2021/02/RAPORTI-VJETOR-MBI-VEPRIMTARINE%CC%88-E-KOMISIONIT-TE%CC%88-PLANIFIKIMIT-STRATEGJIK-ADMINISTRIMIT-DHE-BUXHETIT-PE%CC%88R-VITIN-2020-BASHKE%CC%88LIDHUR-VENDIM-NR.-39-DATE%CC%88-04.02.2021-.pdf>

## Masa 4.1.2

*“Ngritja dhe zbatimi i programit të sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata/PP/KLGJ/KLP/ILD*

Për të pasur një sistem të përditësuar dhe funksional të menaxhimit të çështjeve duhet projektimi dhe zbatimi në praktikë i programit përkatës të menaxhimit të çështjeve në gjykata, prokurori, Këshilla dhe ILD. Ngritja e sistemit të menaxhimit shërben edhe si premisë për një sistem të integruar. Në këtë aspekt masa është në përputhje me Objektivin Specifik 4.1 dhe Rezultatit 4.1.1.

Duke qenë se sistemet ekzistuese të gjykatave dhe prokurorive konsiderohen ‘të vjetëruara’, lindi i nevojshëm dizenjimi i një programi tërësisht të ri. Më tej, ky program nevojitet të zhvillohet dhe zbatohet në praktikë nga gjykatat/prokuroritë, si dhe institucionet e qeverisjes së sistemit (Këshillat, ILD). Programi duhet të jetë në gjendje të prodhojë të dhëna që mund të përpunohen dhe përdoren për nevoja të sistemit të drejtësisë. Një masë e ngjashme ka qenë parashikuar në Planin Strategjik të KLGJ 2018-2020. Masa 5.4 parashikonte: *“Rritja e transparencës për të gjithë sistemin gjyqësor nëpërmjet publikimit në kohë të vendimeve të gjykatave në faqen e internetit të KLGJ-s”*ë.

Në këtë aspekt, masa është e nevojshme. Sugjerojmë vetëm koordinimin me KLGJ mbi fazën në të cilën është puna me ngritjen e sistemit, me qëllim që ajo të jetë koherente me fazën aktuale të punës në këtë drejtim dhe prioritetet e KLGJ.

**Konkluzion:** *Masa është e formuluar qartë dhe nuk krijon konfondim me rezultatin dhe është në harmoni me objektivin strategjik. Sugjerojmë koordinim me KLGJ për të sqaruar fazën në të cilën është puna mbi projektimin/ngritjen e programit.*

## Masa 4.1.8

*“Mirëmbajtja për sistemin e menaxhimit të çështjeve për gjykatat/PP/KLP/KLGJ/ILD”.*

Masa 4.1.8 parashikon mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve. Kjo masë është në vijim logjik të masës 4.1.2. Aplikimi i programit të sistemit duhet të shoqërohet me mirëmbajtjen e tij. Mirëmbajtja është kusht për funksionalitetin afatgjatë të sistemit e për pasojë masa 4.1.8 është në përputhje me Rezultatit 4.1.1,

Sa kohë mirëmbajtja e sistemit menaxhimit të çështjeve është domosdoshmëri, ajo vlerësohet si masë realiste.

Kjo masë duhet të rishikohet në raport me masën 4.1.13 *“Investime dhe mirëmbajtje për sistemin e menaxhimit të çështjeve, pajisjet dhe software respektive për gjykatat/PP/KLP/KLGJ/ILD”*, pasi ka mbivendosje. Sa kohë që dhe kjo e fundit përfshin *“mirëmbajtje për sistemin e menaxhimit të çështjeve”* nuk del i qartë dallimi apo fokusi i secilës masë.

**Konkluzion:** *Masa është e formuluar qartë. Ajo është në përputhje me rezultatin 4.1.1, dhe Objektivin Strategjik 4.1, si dhe vlerësohet realiste. Sugjerojmë që kjo masë të rishikohet në raport me masën 4.1.13 për të mos krijuar mbivendosje.*

## Masa 4.1.11

*“Trajnimi i trupës gjyqësore/prokurorë/inspektorë dhe i stafit administrative mbi përdorimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve”*

Së fundmi, për të pasur një sistem të menaxhimit të çështjeve funksional, duhet që përdoruesit e tij (trupa gjyqësore/prokurorët/inspektorët, dhe stafet përkatëse administrative), të trajnohen në lidhje me përdorimin e sistemit të ri. Për këtë arsye, kjo masë është në koherencë me masat 4.1.1 dhe 4.1.8, si dhe në përputhje me Rezultatit 4.1.1 dhe Objektivin Specifik 4.1

Njohuritë për veçoritë e sistemit, si dhe përdorimi i saktë i sistemeve janë të domosdoshme për të pasur një sistem menaxhimi të çështjeve që funksionon me efikasitet. Në këtë aspekt, masa është e domosdoshme dhe realiste.

**Konkluzion:** Masat e lartpërmendura (4.1.1, , 4.1.8 dhe 4.1.11) që synohet të ndërmerren në funksion të arritjes së Rezultatit 4.1.1 janë në vijimësi logjike të njëra tjetërës dhe aplikimi i tyre së bashku është i nevojshëm për të mundur rezultatin. Masat janë të formuluar qartë dhe nuk krijojnë konfundim me rezultatin dhe janë në harmoni me objektivin strategjik 4.1. Sugjerojmë vetëm rishikim të masës 4.1.8 në raport me 4.1.11 për të shmangur mbivendosjet.

### Rezultati 4.1.2

*“Baza e të dhënave gjyqësore e ngritur, e cila mund të shërbejë për statistika dhe të dhëna në kohë reale bazuar në konceptin e përdorimit të një klasifikuesi të unifikuar për çështjet zinxhir të institucioneve të drejtësisë”.*

Ky rezultat nënkupton krijimin e bazës të të dhënave për sistemin gjyqësor. Kjo mundëson, së pari mundësinë e pasjes dhe aksesimit në kohë reale të statistikave dhe të dhënave të tjera tjera, dhe së dyti, krijimin e një sistemi unik për të dhëna që përfshijnë disa institucione. Ky rezultat është në koherencë me Objektivin Strategjik 4.1, i cili në kuadër të sistemit elektronik të integruar kërkon dhe ngritjen e bazës së të dhënave.

Të dhënat e CEPEJ<sup>33</sup>tregojnë se Shqipëria së bashku me vende të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë nivelin më të ulët të përdorimit të sistemeve elektronike të komunikimit midis gjykatave dhe prokurorëve dhe avokatëve. Gjenerimi i të dhënave statistikore të performancës është në proces për t’u përmirësuar. KLGJ aktualisht ka miratuar Vendimin “Për Mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave”<sup>34</sup> dhe e rëndësishme në këtë fazë është të ketë një bazë të dhënash ku mund të gjenden këto statistika. Në këtë aspekt, masa është realiste dhe në koherencë me gjendjen aktuale. Rezultati mund të rishikohet në formulim, pasi fjalia është e gjatë, dhe gjuha e përdorur nuk e nxjerr të qartë për lexuesin kuptimin e tij. Gjithashtu nuk identifikohet saktë se çfarë informacioni do të gjendet në bazën e të dhënave. Përmenden statistika, por pa specifikuar në lidhje me çfarë do të jenë këto statistika, si dhe është e paqartë se çfarë nënkuptojnë “të dhënat e tjera”. Sqarimi i tyre do të mundësonte matjen e këtij rezultati. Nga ana tjetër do të linte të kuptohej qartë dhe cilat çështje/ të dhëna kërkojnë apo ndërthurin informacion nga disa institucione të drejtësisë (që edhe në këtë rast nuk kuptohet se kujt i referohen). Për matjen e këtij Rezultati nuk janë identifikuar indikatorët. Një indikator që mat arritjen e plotë të këtij rezultati mund të jetë “% e statistikave/informacioneve të hedhur në bazën e të dhënave në vijimësi, në raport me tërësinë e të dhënave që duhet të përfshijë baza e të dhënave” apo “% e organizatave të shoqërisë civile/studuesve të së drejtësisë që mendojnë se baza e të dhënave jep rezultat mbi performancën e sistemit të drejtësisë”.

**Konkluzion:** Ky rezultat është në përputhje me Objektivin 4.1 dhe vlerësohet realist dhe i domosdoshëm. Sugjerojmë të rishikohet gjuha e përdorur në funksion të qartësisë të të dhënave

<sup>33</sup>Shih për më tepër <https://www.coe.int/en/web/cepej/documentation/cepej-studies>

<sup>34</sup>Shih për më tepër <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-11-shkurt-2021-2/>

*apo informacioneve që përmban baza e të dhënave. Për matjen e këtij rezultati sugjerojmësi indikatore “% e statistikave/informacioneve të hedhur në bazën e të dhënave në vijimësi, në raport me tërësinë e të dhënave që duhet të përfshijë baza e të dhënave” apo “% e organizatave të shoqërisë civile/studuesve të së drejtës që mendojnë se baza e të dhënave jep rezultat mbi performancën e sistemit të drejtësisë.*

#### **Masa 4.1.1**

*“Dizenjimi dhe ngritja e programit të digjitalizimit të institucioneve të drejtësisë”.*

Masa e parë e renditur në kuadër të Objektivit 4.1 është dizenjimi dhe ngritja e një programi të digjitalizimit të institucioneve të drejtësisë. Kjo masë është e përgjithshme dhe lidhet me digjitalizimin e gjithë institucioneve të drejtësisë. Kjo masë është parakusht për ngritjen e bazës së të dhënave dhe pasjen e një sistemi funksional dhe të integruar të drejtësisë elektronike. Për këtë arsye masa është në përputhje me Rezultatin 4.1.2 dhe Objektivin Specifik 4.1. Në funksion të qartësimit sugjerojmë të specifikohet se kujt i referohen ‘institucionet e drejtësisë’, të cilat përfshijnë një sërë organesh.

Duke qenë se projektimi dhe ngritja janë procese që marrin kohë (nisur edhe nga kompleksiteti i një sistemi të ri që do të ngrihet për herë të parë), vlerësohet se kohëzgjatja e kësaj mase duhet të jetë në përpjestim të drejtë me masat e tjera vijuese, si dhe ato të parashikuara nga vetë institucionet e drejtësisë, apo AKSHI, i cili është përfshirë si një ndër institucionet pjesëmarrëse në realizimin e Objektivit 4.1. Masa është aktuale, por mbetet e paqartë sa është koha e nevojshme për dizenjimin dhe ngritjen e programit, si dhe autoriteti përgjegjës.

**Konkluzion:** *Kjo masë është në përputhje me rezultatin 4.1.2 dhe Objektivin 4.1 dhe vlerësohet realiste dhe e domosdoshme. Sugjerojmë të specifikohen institucionet e drejtësisë të cilave u referohet masa dhe tek të cilat do të gjejë shtrirje digjitalizimi, si dhe koha e nevojshme dhe autoriteti përgjegjës për dizenjimin dhe ngritjen e programit.*

#### **Masa 4.1.3**

*“Përmirësimi i qendrës së përpunimit të të dhënave”.*

Kjo masë për nga mënyra se si është formuluar duket disi e paqartë. Nuk kuptohet koncepti i qendrës së përpunimit të të dhënave, si dhe çfarë synon përmirësimi i saj.

Qendra e përpunimit të të dhënave nuk është parashikuar në ligjin nr.115/2016. Ky i fundit parashikon në nenin 92 të tij “Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë”. Pika 2 e nenit 92 përmend edhe përmirësimin e të dhënave si një kompetencë e kësaj Qendre. Ndërkohë është miratuar VKM nr.972, datë 02.12.2020 ‘Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë’, me të cilën është ngritur kjo Qendër, si dhe është miratuar vendimi ‘Për miratimin e rregullave për politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë’.

Nëse kjo masë lidhet me detyrimet që burojnë nga neni 92 i Ligjit nr.115/2016 sugjerohet që të riformulohet dhe të saktësohet. Gjithashtu, zhvillimet sa më sipër të merren në konsideratë dhe të shërbejnë si pikë lidhëse për hartimin e masës.

Përpunimi i të dhënave është një nga mangësitë më të mëdha dhe problematike të sistemit të drejtësisë. Të dhënat që raportohen nga gjykatat dhe prokuroritë, në pjesën më të madhe, nxirren dhe përpunohen manualisht në regjistrat përkatës. Shumë pak të dhëna

prodhohen elektronikisht, të cilat, për efekt të saktësisë së tyre, duhet që të verifikohen shpesh me të dhënat e nxjerra nga regjistrat manualë.

**Konkluzion:** Nisur nga mënyra se si është formuluar, kjo masë mbetet e paqartë sa kohë koncepti “Qendër e përpunimit të të dhënave” nuk parashikohet në Ligjin nr.115/2016 ‘Për qeverisjen e sistemit të drejtësisë’. Nuk kuptohet se ku do të ekzistojë qendra e përpunimit të të dhënave dhe çfarë të dhënash do të ruhen dhe përpunohen në këtë qendër. Vetëm të dhënat e gjykatave, apo/dhe prokurorive apo të ILD-së? Sugjerohet sqarimi i kësaj mase në mënyrë që të jetë sa mëe matshme dhe e realizueshme.

#### Masa 4.1.4

*“Përmirësimi i infrastrukturës së IT-së në gjykata”.*

Masa lidhet me përmirësimin e infrastrukturës së IT të gjykatave. Infrastruktura e duhur e sistemeve të IT-së ndihmon në një menaxhim eficient të çështjeve, funksionimin si duhet të bazës së të dhënave e, si përfundim, është premisë për të pasur një sistem të unifikuar të drejtësisë elektronike. Në këtë aspekt, masa është e nevojshme për arritjen e Rezultatit 4.1.1 dhe 4.1.2, si dhe është në përputhje me Objektivin 4.1.

Masa është aktuale sa kohë që sistemi IT shihet si një shtysë për modernizimin e të gjitha gjykatave, prokurorive dhe informacioneve që ato japin apo shërbimeve që ofrojnë. Një masë e tillë bën të mundur ofrimin e mënyrave novatore për rritjen e bashkëpunimit mes vetë institucioneve dhe këtyre të fundit me publikun. Vërehet që sistemi IT i prokurorive nuk është përmendur në këtë masë. Duke qenë se synohet krijimi i një sistemi të unifikuar të dhënash, sipas të cilës është e mundshme ndjekja e ecurisë së dosjes që nga prokuroria e deri më vonë në gjykatë, formulimi i në lidhjeje vetëm me përmirësimin e infrastrukturës së IT-së së gjykatës duket e paplotë.

**Konkluzion:** Masa është në koherencë me Rezultatet 4.1.1 dhe 4.1.2 si dhe me Objektivin Specifik 4.1. Sugjerojmë që sistemi i infrastrukturës në prokurori të jetë gjithashtu fokus i masës. Për këtë arsye sugjerohet riformulim i masës për të qenë më afër realitetit dhe më e matshme.

#### Rezultati 4.1.5

*“Institucionet e tjera të drejtësisë, duke përfshirë institucionet e varësisë, të mbështetura në zhvillimin e zgjidhjeve të tyre të teknologjisë së informacionit, përfshirë koordinimin me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit”*

Për nga mënyra se si është formuluar, ky rezultat është i paqartë. Së pari, fjalë me të cilën shprehet Rezultati është e paplotë dhe nuk nxjerr të qartë çfarë pritet nga përmbushja e tij në funksion të Objektivit Specifik 4.1. Së dyti, nuk është identifikuar qartë lloji dhe natyra e mbështetjes. Gjithashtu, në të përmenden ‘institucionet e tjera të drejtësisë’ si dhe “institucionet e varësisë”, duke bërë që target grupi për këtë rezultat të jetë evaziv. Duhet saktësuar formulimi duke dhënë një orientim ose përdorur një term shoqëruar për të identifikuar “institucionet e tjera” apo “institucionet e varësisë” të cilat nuk janë të qarta. Paqartësia në formulim e këtij rezultati bën të vështirë identifikimin e masave që i shërbejnë arritjes së tij. Duket se Masat 4.1.14 dhe 4.1.15 i referohen këtij rezultati, megjithatë, të lexuara në tërësinë e tyre (Rezultati dhe Masat), nuk nxjerrin të qartë nëse “sistemi i menaxhimit të çështjeve” që do të mbahet nga MD dhe institucionet e varësisë i referohet sistemit të

menaxhimit të çështjeve gjyqësore/të prokurorisë, apo sistemi tjetër që menaxhon MD dhe institucionet vartëse të saj.

**Konkluzion:** Paqartësia në formulimin e këtij Rezultati (relevanca me Objektivin Specifik 4.1, nocioni i mbështetjes dhe institucionet e varësisë) e bën të vështirë identifikimin e indikatorëve që do të masin arritjen e Rezultatit.

#### Objektiv Specifik 4.4

*“Përditësimi i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të MD-së dhe përmirësimet në fushën e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar dhe përgatitja e Shqipërisë për anëtarësimin në BE me anë të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis e BE dhe aktet e tjera të integritit me BE dhe shtetet anëtare në fushën e drejtësisë.”*

Ky objektiv është i orientuar në dy drejtime. Së pari, në përmirësim të kuadrit ligjor dhe rritje të kapaciteteve të MD në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe, së dyti, në harmonizimin e legjislacionit me acquis dhe akte të tjera të BE për të përgatitur vendin për fazën e integritit në BE. Ky objektiv, është në koherencë me Qëllimin e Politikës 4, të cilat i referohen menaxhimitefikas dhe efektiv të sistemit të drejtësisë në të gjithë institucionet e sektorit.

Megjithëse nuk rezulton e qartë nga formulimi i Objektivit, referuar masës 4.4.1 dhe 4.4.2, kuptojmë që pjesa e parë e tij i referohet përmirësimit të legjislacionit dhe kapaciteteve të MD-së lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale. Nëse e kuptojmë drejt dhe ky është qëllimi i Objektivit, rezulton se me ligjin Nr. 97/2021 janë parashikuar shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 193, Datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”<sup>35</sup>. Në këtë aspekt sugjerojmë që të rishikohet ky Objektiv në lidhje me pjesën e përmirësimit të legjislacionit, i cili ka më pak se tre muaj që është ndryshuar në drejtim të përmirësimit të procedurave që ndiqen në rastet e marrëdhënieve juridiksionale, duke e sjellë në përputhje me konventat e fushës. Objektivi mund të fokusohet në plotësimin e tij me akte nënligjore për miratimin e të cilave Ligji lë afat prej 6 muajsh nga hyrja në fuqi e tij.

Ndërkohë, duke qenë se marrëdhëniet juridiksionale me shtetet e huaja është një ndër fushat që mbulon MD, rritja e kapaciteteve të MD-së në lidhje me bashkëpunimin ligjor ndërkombëtar, si dhe përmirësimet e fundit të legjislacionit shihen të nevojshme dhe aktuale.

Pjesa tjetër e këtij Objektivi evidenton të nevojshëm vijimin e mëtejshëm të harmonizimit të legjislacionit vendas me Acquis, si një domosdoshmëri në kuadër të procesit të integritit në BE. Ky është një proces i vazhdueshëm, ku për çdo akt ligjor të miratuar shihet përputhshmëria me Acquis-në e fushës dhe hartimi i tabelës së përputhshmërisë që është një detyrim ligjor. Sa kohë Shqipëria vijon përmbushjen e të gjitha detyrimeve që i rrjedhin nga MSA dhe fazën e përgatitjes për anëtarësim në BE, ky objektiv mbetet aktual. Ndërkohë shihet e nevojshme që në këtë fazë të vlerësohen kapacitetet në këtë drejtim dhe të investohet në drejtim të stafeve dhe personave përgjegjës për këtë proces. Kjo pjesë e Objektivit afekton, veç MD-së, MEPJ-në, dhe të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë, si dhe ato të pushtetit ekzekutiv (Ministritë dhe Këshillin e Ministrave). Objektivi Specifik 4.4 është hartuar rishtazi për efekt të SND II dhe nuk ka qenë i përfshirë në SND I.

---

<sup>35</sup>Shih LIGJ Nr. 97/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 193, datë 3.12.2009 “për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”,  
<https://ëëë.parlament.al/Files/ProjektLigje/20210714135014ligj%20nr.%2097,%20dt.%207.7.2021.pdf>

**Konkluzion:** *Objektivi Specifik 4.4 është në harmoni me Qëllimin e Politikës 4. Sugjerojmë riformulimin e tij në funksion të saktësisë të terminologjisë dhe qëllimit të tij, si dhe rishikimin e pjesës së përmirësimit të legjislacionit lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar, i cili rezultoi në ndryshuar rishtazi.*

#### Rezultati 4.4.4

*“Kapacitetet e MD dhe institucioneve sektoriale për të menaxhuar Instrumentin e ri të Para Anëtarësimit dhe modalitetet e tjera të mbështetjes së BE-së janë zhvilluar në mënyrën e duhur dhe sektori i drejtësisë merr mbështetje të konsiderueshme financiare nga këto fonde.”*

Me qëllim përthithjen e fondeve me vlerë të lartë, të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të jenë në “lartësinë e duhur” për sa i takon kapaciteteve që kanë. Për të qenë në lartësinë e duhur duhet të përmbushen disa parakushte. Një parakusht lidhet me nivelin profesional të burimeve njerëzore që duhet të kenë mjaftueshmërisht njohuri, si dhe nivelin e duhur të trajnimit. Kjo varet re në disa ministri, si ajo për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financës që kanë patur qëndrueshmëri për sa i takon burimeve njerëzore, ndërkohë që për Ministrinë e Drejtësisë, e cila nuk ka patur qëndrueshmëri në burimet njerëzore, ngritja e kapaciteteve profesionale është mëse e domosdoshme. Një tjetër parakusht lidhet me ekzistencën e strukturave të specializuara brenda institucioneve, si dhe me nivelin e ndërgjegjësimit të punonjësve të tyre në lidhje me rëndësinë e këtij rezultati.

Për sa më lart, ky rezultat është në përputhje me Objektivin 4.4.

SND II nuk parashikon indikator për matjen e këtij rezultati. Ndërkohë, si indikator mund të shërbejë “% e fondeve të përthithura nga BE”.

**Konkluzion:** *Ky është rezultat shumë i rëndësishëm pasi lidhet me pasjen e kapaciteteve të duhura njerëzore dhe institucionale për të përthithur sa më tepër fonde nga ana e të gjitha institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe për t’i menaxhuar ato me efikasitet. Sugjerojmë të përfshihet si indikator “% e fondeve të përthithura nga BE”.*

#### Masa 4.4.4

*“Trajnime të nëpunësve të MD në fushën e harmonizimit të legjislacionit”.*

Në kuadër të procesit të integritimit në BE, Ministria e Drejtësisë, si autoriteti përgjegjës për përafrimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë, mbart detyrimin për të administruar procesin e përafrimit të legjislacionit. Hapi i parë në procesin e përafrimit është analiza dhe krahasimi i legjislacionit të BE-së me legjislacionin përkatës për të përcaktuar statusin e konformitetit të kuadrit ligjor dhe masat që do të marrë shteti për të përafruar legjislacionin shqiptar me atë të BE-së. Në lidhje me transpozimin e Direktivave, ekziston një metodologji e mirëpërcaktuar, të cilën stafi i Ministrisë duhet të jetë në gjendje t’i zbatojë. Kjo lidhet pikë së pari me hartimin e Tabelës së Përputhshmërisë (*Table of Concordance (ToC)*). Objektivi i hartimit të ToC është identifikimi i parashikimeve ligjore që rregullojnë të njëjtin aspekt, çfarë është transpozuar apo nuk është transpozuar (boshllëqet); dhe identifikimi i parashikimeve të tjera ligjore. Në këtë aspekt, duhet pasur parasysh që Rregulloret dhe Vendimet e BE-së nuk janë pjesë e procesit të përafrimit, pasi ato hyjnë në fuqi në datën e anëtarësimit të shtetit në BE. Pavarësisht kësaj, Rregulloret dhe Vendimet e BE-së diktojnë marrjen e masave kombëtare për zbatimin e tyre dhe nuk mund të mos jenë pjesë e procesit të integritimit.

Për të gjitha sa më sipër, stafi i Ministrisë duhet të aftësohet në nivelin e duhur. Për pasojë masa është aktuale dhe realiste.

**Konkluzion:** Kjo masë i përgjigjet Objektivin Specifik dhe Rezultatit 4.4.3. Harmonizimi i legjislacionit shqiptar me Acquis-në e BE-së realizohet në një fazë dhe në një cilësi në përputhje me MSA dhe kuadrin negociator, dhe është në përputhje me të dhe vetë Objektivin 4.4. Masa është e formuluar qartë dhe e domosdoshme.

#### Masa 4.4.8

*“Përgatitja e kapaciteteve të MD-së dhe të institucioneve të pavarura të drejtësisë (KLGJ, KLP, ILD, PP, SHM) për të përgatitur dhe menaxhuar fondet IPA III”.*

Masa është e nevojshme për t’u ndërmarrë lidhen me përgatitjen e kapaciteteve të MD KLGJ, KLP, ILD, PP, SHM për të menaxhuar fonde të IPA III. IPA III është një mekanizëm /instrument i para-anëtarësimit në BE. Ky instrument ka veçoritë e veta për të cilat institucionet si ILD, KLGJ, KLP, PP dhe SHM duhet të kenë njohuritë e duhura. Për pasojë masa është aktuale. Dhe shihet si e nevojshme në arritjen e Rezultatit 4.4.4. si dhe në përmbushjen e Objektivit 4.4.

**Konkluzion:** Kjo masë është në harmoni me rezultatin 4.4.4. Në të njëjtën kohë kjo është një masë realiste, pasi kapacitetet në institucionet e sistemit të drejtësisë mund (dhe duhet) të zhvillohen në vitet e ardhshme. Ky është një proces që është kryer edhe në vende të tjera përpara anëtarësimit të tyre në BE (si Kroacia, etj.). Kapacitetet mund të përgatiten nëpërmjet trajnimeve të dedikuara për këtë çështje.

## ANALIZA E INDIKATORËVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË SND II

### Rëndësia e indikatorëve të parashikuar për SND II

Për proceset strategjike, vendosja e indikatorëve të duhur është e një rëndësie thelbësore për matjen e progresit që është parashikuar të realizohet me anë të masave apo qëllimeve të vendosura në Strategji. Në mënyrë të vecantë, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, si një strategji ombrellë, nën të cilën veprojnë shumë organe të larta të sistemit gjyqësor dhe organe të pavarura prej saj, ka misionin e vështirë që, përpara publikut, të tregojë sesa kjo reformë e ndërmarrë po funksionon dhe po ndikon në përmirësimin e drejtësisë në vend. Akoma më të rëndësishme janë edhe përfitimet që duhet të vijnë nga matja e indikatorëve kur kemi parasysh se Strategjia e Reformës në Drejtësi nuk është një Strategji afatshkurtër, por pas SND II, parashikohet të vijohet me një katër vjeçar tjetër qëllimesh e politikash strategjike (SND III). Pra, përcaktimi i indikatorëve të duhur do të shërbejë për përcaktimin edhe të çështjeve kryesore të cilat do të duhet të “shqetësojnë” SND III.

Thujse çdo institucion i drejtësisë ka strategjinë e vet institucionale, që në mënyrë analoge, përmban planin e masave dhe indikatorët që tregojnë efektivitetin dhe realizimin e tyre, e megjithëkëtë, indikatorët e vendosur në këtë Strategji, nuk e humbasin kurrsesi vlerën e tyre, përse kohë ato synojnë të masin, në tërësi, funksionimin e aspekteve të caktuara që lidhen me drejtësinë në vend, përgjegjës për të cilat mund të jetë një apo disa institucione sëbashku.

Për efekt të këtij studimi, do të analizohen tetëmbëdhjetë(18) indikatorë nga tridhjetë dy (32) të parashikuar nga SND II. Kjo përzgjedhje është bërë në bazë të objektivave, rezultateve dhe masave që janë analizuar në këtë studim.

## Analiza e indikatorëve

### Indikator 1

*“% e subjekteve të rivlerësimit kalimtar që besojnë se institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë janë të pavarura dhe të paanshme”*

Treguesi do të masë performancën e institucioneve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, duke matur nëpërmjet sondazhit, perceptimin e subjekteve të rivlerësimit në drejtim të pavarësisë dhe paansësisë së këtyre institucioneve.

Ky indikator përbën një mënyrë direkte të krijimit të bindjes nëse institucionet e reja të qeverisjes po veprojnë në kushtet e paanshmërisë dhe po zbatojnë standardet ligjore ose jo. Fakti që indikator mat perceptimin e grupit drejtpërdrejtë të interesuar, gjyqtarët dhe prokurorët, e bën këtë indikator të jetë më i besueshëm dhe më afër të vërtetës. Nuk kuptohet se përse indikator i referohet vetëm subjekteve të rivlerësimit kalimtar dhe jo gjithë trupës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nëse kjo bëhet për të matur veprimtarinë e këtyre organeve pas mbarimit të mandatit të organeve të vetting-ut, sugjerojmë që pyetësi i matjes së perceptimit të jetë gjithëpërfshirës, për gjithë kompetencat e këtyre organeve në raport me gjyqësorin. Në këtë aspekt maten dhe monitorohen dhe masat dhe rezultatet e tjera të përfshirë në SND II. Në këtë aspekt sugjerojmë riformulimin e subjekteve që do i nënshtrohen sondazhit.

Referuar Metodologjisë treguesi do të matet përmes pyetësorit vjetor të hartuar nga KLGJ/KLP drejtuar subjekteve të rivlerësimit kalimtar ( gjyqtarëve dhe prokurorëve). Në këtë aspekt sugjerojmë që pyetësi të përpunohet nga MD dhe jo nga KLP dhe KLGJ, sa kohë që MD monitoron dhe mat këtë tregues, si dhe meqenëse KLP dhe KLGJ janë institucione të monitoruara. Treguesi krijohet për herë të parë dhe vlerat e para do të jenë ato të vitit 2021. Ndërkohë frekuenca për matjen e këtij perceptimi, e përvitshme, është e përshtatshme dhe ofron mundësi reale që ky indikator të përdoret me qëllim përmirësimit e punës të këtyre organeve.

**Konkluzion:** *Ky indikator duhet të saktësojë subjektet të cilave do iu drejtohet sondazhi, si dhe institucionin, i cili harton dhe përpunon pyetësorët. Sugjerojmë që, përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve, pjesë e këtij sondazhi të ishte edhe ILD, si institucioni që kontrollon gjyqtarët/prokurorët dhe njeh nga afër pjesë problematike të performacës së gjyqësorit dhe prokurorisë.*

### Indikator 3

*“% e buxhetit të shtetit dedikuar organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*

Ky indikator llogarit në përqindje pjesën që zë buxheti i dedikuar organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në raport me buxhetin e shtetit. Sa më e madhe kjo e fundit aq më të mëdha janë premiset për konsolidimin e organeve të qeverisjes së sistemit, në drejtim të rritjes së kapaciteteve, burimeve njerëzore dhe infrastrukturës.

Ky tregues lidhet me Qëllimin e Politikës 1 *“Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien”*. Ndërkohë Pasaporta e Indikatorëve e referon atë në Objektivin Specifik *“Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar në mënyrë efektive dhe efikase siç parashikohet nga Kushtetuta dhe ligji.”* Hartuesit e Strategjisë duket se e kanë lidhur këtë indikator me vazhdimin e procesit të vettingut nga KLGJ dhe KLP, pas mbarimit të mandatit të organeve të

rivlerësimit kalimtar, ndërkohëqë ai [indikatori] i shërben njëkohësisht dhe objektivave të tjerë që lidhen me konsolidimin e organeve të qeverisjes së sistemit, në drejtim të rritjes së kapaciteteve, burimeve njerëzore e infrastrukturës, parashikuar në Objektivin Specifik 1.3.

Metodologjia për matjen e këtij treguesi është e qartë dhe ka si qëllim të llogarisë përqindjen e buxhetit të shtetit që i dedikohet çdo vit organeve të sistemit të qeverisjes së drejtësisë, sipas të dhënave të marra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Si vlerë bazë për përcaktimin e objektivave të ardhshëm merret përqindja e dedikuar KLP-së, KLGj-së dhe ILD-së për vitin 2020. Ndërkohë që synohet një rend rritës, nëse krahasojmë vlerat nga viti në vit për çdo institucion, shohim që jo në cdo rast kemi këtë trend.

**Konkluzion:** Ky indikator duhet të saktësojë Objektivat me të cilat lidhet dhe Rezultatet që synon të masë.

#### **Indikatori 4**

*“Numri i akteve nënligjore të miratuara në lidhje me kompetencat, efikasitetin dhe koordinimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (vlera të ndara për KLGj/KLP/ILD)”*

Ky indikator synon të masë përmbushjen e detyrave të këshillave dhe ILD-së lidhur me plotësimin e kuadrit të brendshëm nënligjor me akte që rregullojnë çështje të ndryshme të funksionimit dhe ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të këtyre organeve.

Me anë të këtij indikator do të përftohet një e dhënë sasiore lidhur me numrin e akteve që ka arritur të hartojë e miratojë secili organ.

Ky indikator është vendosur si matës i Objektivit 1.2 “Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, legjislacionin për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin”.

Së pari, vlerësojmë se ky indikator nuk përshtatet me Objektivin 1.2, objektiv i cili nuk iu referohet akteve të brendshme që duhet të nxjerrë secili organ në mënyrë që të ushtrojë funksionet e tij, por objektiv që i referohet ndryshimeve të ligjit për këto organe, nëse si pasojë e analizës dhe eksperiencës së deritanishme, vihen re probleme në zbatimin e ligjit që ndikojnë në çështje të funksionimit me normalitet të këtyre organeve.

Së dyti, rezultati që do të arrihet të merret nga ky indikator është një rezultat numerik që nuk thotë asgjë për eficiencën, përgjegjshmërinë, cilësinë e këtyre organeve, por jep një të dhënë të “ftohtë” për një detyrë funksionale, për të cilën nuk është e rëndësishme të krijohet një indikator.

Së treti, lidhur me pritshmëritë për vlerat e synuara, të cilat lidhen me numrin e akteve që do të prodhojë në një vit secili organ, sërish numrat janë të paqartë, të palidhur me detyrime konkrete për nxjerrje aktesh dhe se si është vlerësuar shpërndarja e paraqitur në vite.

Ligji parashikon detyrime konkrete për organet për plotësimin e bazës së tyre nënligjore dhe në përmbushje të Politikës 1 “Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficientë dhe llogaridhënie”, prandaj indikator duhet të ishte cilësor, pra një indikator që të arrinte të maste nëse këto organe i kanë përmbushur në kohë dhe me cilësi detyrimet e tyre për nxjerrjen e akteve.

**Konkluzion:** Nisur nga aktet e deritanishme të miratuara nga këto organe, sic është përmendur edhe përgjatë analizës, koha që i është dashur organeve për nxjerrjen e tyre është shumë e gjatë,

*gjë që ka ndikuar negativisht në cilësinë e ofrimit të shërbimit për gjyqësorin dhe prokurorinë. Do të ishte me interes të matej ky aspekt, dhe jo thjesht sa akte ka miratuar secili organ.*

## **Indikator 5**

*“Numri i propozimeve për ndryshime ligjore të bëra nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*

Ky indikator lidhet në mënyrë logjike me Objektivin 1.2 dhe synon të masë angazhimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në vetë-analizën dhe prodhimin e zgjidhjeve ligjore për çështje që ligji aktual ka nevojë të përmirësohet, në funksion të mirëfunksionimit të këtyre organeve dhe rritjes së eficiencës së tyre.

Megjithatë, sërish, përfitohet vetëm një e dhënë numerike, e cila nuk arrin të thotë dicka konkrete lidhur me cilësinë e propozimeve apo suksesin e tyre. Vendosja në metodologji e një tendence zbritëse, pra në vitet e para të strategjisë pritet të ketëmë shumë propozime dhe në vitet e mëvonshme, më pak propozime, nuk është shoqëruar me të njëjtën ide kur vendosen vlerat e synuara nga viti në vit për secilin organ (ato janë të njëjta nga viti në vit). Kjo për shkak se indikator duket se është paqartë për vetë hartuesit e tij. Është e vërtetë se propozimi për ndryshime të ligjit duhet të vijë nga këto organe, por këto propozime nuk janë qëllim nëvetvete dhe nuk mund të trajtohen si të tilla. Kjo do të thotë që matja se sa propozime ka bërë një organ nuk tregon për cilësi, eficiencë apo përgjegjësi më të lartë të këtij organi.

**Konkluzion:** *Do të ishte me interes të përfitohej një e dhënë krahasimore lidhur me suksesin e këtyre propozimeve, përshembull, sa prej këtyre nismave për ndryshime kanë arritur të marrin formën e projektligjeve apo të kenë ndryshuar ligjin.*

## **Indikator 6**

*“% e procedurave të filluara disiplinore për ankesat kundër gjyqtarëve ose prokurorëve”*

Paraprakisht duhet thënë se ky indikator është formuluar në mënyrë të ndryshme me atë çfarë synon të masë, element që del qartë nga metodologjia që ka parashikuar. Kështu, nëse marrim për bazë metodologjinë dhe rrjedhën logjike me të cilën është shpjeguar ky indikator, duket qartë se ai synon të masë cilësinë e punës së ILD për të hetuar rastet e shkeljeve të kryera nga subjektet që janë pjesë e veprimtarisë së këtij organi, duke vendosur përballë standardet dhe kriteret e përdorura nga ky organ në fazën “paraprake”, kur vendos të nisë apo jo hetimi disiplinor, me një fazë të dytë më të konsoliduar të hetimit kur, pas kontrollit më të imtësishëm, merret vendim për dërgimin e çështjes në KLGJ/KLP, apo mbyllet e hetimit.

Qëllimi është që ILD të marrë përgjegjësi qysh në momentin kur nis hetimin disiplinor, në mënyrë që të shmangen situatat kur hetimet nisin, por ato bien gjatë hetimit më të thelluar dhe nuk arrihet dot të prodhojnë një propozim serioz dhe të bazuar për këshillat. Kjo kërkon që ILD të zbatojë rregulla e kritere të unifikuara dhe të harmonizuara qysh në fazat e para të hetimit.

Për t’a realizuar këtë, indikatoriparashikon të krijojë një krahasim (raport) ndërmjet vendimeve të ILD-së për fillimin e hetimit disiplinor dhe vendimeve të ILD-së për t’a dërguar çështjen për shqyrtim para këshillave.

Për të qenë të qartë lidhur me metodologjinë dhe problemin në formulim të indikatorit, duhet t’i referohemi mënyrës sesi vepron hap pas hap ILD-ja. Përshkrimi i fazave është si vijon:

ankesa (1) →shqyrtimi i ankesës (2) →fillimi i hetimit disiplinor/arkivimi (3) →kërkesa dërgohet në KLGj ose KLP/mbyllet hetimi (4) →KLGj ose KLP vendos pranimin e kërkesës/rrëzimin e kërkesës (5)

Interpretimi i metodologjisë së indikatorit lidh *fazën 3*, fillimi i hetimit disiplinor nga ILD, me *fazën 4*, rastet se kur ILD, pasi ka nisur hetimin disiplinor, vendost'i drejtohet me kërkesë KLGj/KLP ose t'a mbyllë hetimin.

Duhet pranuar se lidhja e këtyre dy fazave bën që indikatorin të vlerësohet si një indikator i saktë, pasi jep të dhëna lidhur me suksesin e procesit të hetimit brenda vetë ILD-së dhe shfrytëzim në efikasitet të plotë të kapaciteteve të këtij organi.

Ndërkohë, kur shohim sesi është formuluar indikatorin, duke përdorur togfjalëshin "ankesat kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve", pritet që ai të japë të dhëna që nisin nga faza 1 dhe 2, që lidhen me ankesën. Pra, interpretimi literal i formulimit të indikatorit kërkon që të matet raporti ndërmjet ankesave dhe vendimmarrjes së ILD-së për hetimin e tyre. Nëse do të krijohej një indikator i tillë, vlera e vetme që ai do të kishte do të lidhej me arritjen e një konkluzioni sesa të ndërgjegjësuar janë subjektet që depozitojnë ankesa ndaj sjelljeve apo veprimeve që përbëjnë shkelje disiplinore.

**Konkluzion:** Indikatorin 6 duhet të riformulohet në mënyrë që të shprehë qartësisht qëllimin e tij. Një formulim i saktë mund të jetë: "% e çështjeve të hetuara që dërgohen në KLGj dhe KLP".

## Indikatorin 7

*"Treguesi i zgjidhjes së çështjeve të prapambetura për disiplinën e ankesave të paraqitura në ILD."*

Ky indikator kërkon të masë efikasitetin e ILD-së në trajtimin e ankesave të prapambetura, të cilat kanë shkakuar një backlog të konsiderueshëm përgjatë këtyre viteve, duke marrë në konsideratë edhe vonesën në krijimin e ILD-së dhe në bërjen e saj efektive. Sugjerojmë rishikimin e tij për mënyrën e formulimit, duke saktësuar togfjalëshin "për disiplinën e ankesave", i cili krijon konfuzion lidhur me atë se çfarë synon të masë indikatorin. Gjithashtu, sugjerojmë që ky indikator të shprehet në përqindje dhe jo thjesht të mbetet një tregues evaziv dhe i papërcaktuar.

Indikatorin 7 lidhet me Objektivin 1.3 të SND II "Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet Evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, efikasitet dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmes rregullat dhe standardet përkatëse" për pjesën që i takon ILD-së.

Ky indikator do të matet me një metodologji të thjeshtë, duke vendosur përballë numrin e ankesave ekzistuese të mbartura me numrin e ankesave të zgjidhura nga kjo kategori. Ky është një tregues i saktë dhe lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me dy nga masat e parashikuara për ILD-në (Masa 1.2.12 dhe Masa 1.3.4). Gjithashtu, duke qenë se frekuenca e matjes së tij është vjetore, ky indikator mund të shërbejë edhe si një indikator udhëzues për ndryshime në Strategjinë e ILD-së apo administrimin që ajo i ka bërë zgjidhjes së këtyre rasteve.

Sa i përket vlerave të synuara për vitet e kohëzgjatjes së SND II, të vendosur në Pasaportën e Indikatorëve, sugjerojmë që ato për çdo vit të shprehen në përqindje, në bazë të formulës që Pasaporta llogarit vlerat në përqindje për vitin 2021 përqindje.

**Konkluzion:** Ky indikator është i nevojshëm për matjen e pastrimit të backlog-ut të ILD-së, si një mjet që do të ndikojë në rritjen e eficiencës së këtij institucioni. Sugjerojmë që ky indikator të masë në përqindje pastrimin e backlogut, bazuar në vetë formulën e përcaktuar në llogaritjen që është bërë për vitin 2021. Po kështu, në përqindje të shprehur dhe objektivat e synuara mbi vlerat e këtij treguesi përgjatë viteve të zbatimit të SND II.

## Indikator 8

*“Treguesi i zgjidhjes së çështjeve të prapambetura për Gjykatën e Lartë”*

Indikator nr. 8 i referohet treguesit të zgjidhjes së çështjeve të prapambetura në GJL. Ky indikator nuk ka ekzistuar në pasaportën e indikatorëve të SND I dhe është përfshirë rishtazi në pasaportën e indikatorëve të SND II. Përfshirja nënvizon rëndësinë që ka trajtimi i çështjeve të prapambetura për ecurinë e reformës në drejtësi në tërësi, por dhe për matjen e shkallës së realizimit të Objektivave të SND II, ku funksionaliteti i GJL-së është një ndër objektivat. Trajtimi i backlog-ut është një tregues për eficiencën e GJL-së dhe vetë gjyqësorit që ndikon në ofrimin e një drejtësie pa vonesa, synime këto të parashikuara në Objektivin Specifik 2.4.

Vërehet se si vlerë bazë, Pasaporta e Indikatorëve merr të dhënat e vitit 2020, pasi GJL ka qenë jo-funksionale deri në Mars të 2020 (kur u emëruan edhe tre gjyqtarët e parë që filluan të shqyrtonin çështje). Nga viti 2018 dhe deri në mars të 2020, numri i çështjeve vetëm është rritur, duke qenë se gjykata nuk ka qenë funksionale (pra nuk ka shqyrtuar asnjë çështje).

Si metodologji për këtë indikator është caktuar “Asnjë rast në prapambetje/asnjë rast i zgjidhur gjatë vitit \* 12.” Kjo metodologji është e paqartë dhe nuk kuptohet se çfarë mat dhe mënyrën se si do të realizojë matjen, prandaj sugjerojmë të rishikohet.

Më tej, mbetet i paqartë se përse synimi është shprehur për kohëzgjatje në vite të pastrimit të backlogut përgjatë jetëgjatësisë së Strategjisë. Mënyrë efikase mund të ishte matja me përqindje e çështjeve të prapambetura, të cilat kanë mbetur pa zgjidhur (ose janë zgjidhur). Ndërkohë për çdo vit mund të caktohet si target përqindja e sasisë së backlog të ngelur (ose të pastruar) që KLGJ (GJL) si institucion përgjegjës duhet të synojë për të arritur në funksion të pastrimit të stokut nga viti në vit. Përcaktimi i targetit është i domosdoshëm për të vlerësuar arritjet/ecurinë.

**Konkluzion:** Metodologjia e matjes së indikatorit është e paqartë. Mënyrë efikase mund të ishte matja me përqindje e çështjeve të prapambetura, të cilat kanë mbetur pa zgjidhur, ose janë zgjidhur, viti pas viti.

## Indikator 9

*“% e akteve ligjore dhe nënligjore që i janë nënshtruar analizës së vlerësimit nga organet gjyqësore”*

Në analizë të fundit, ky indikator mund të japë vetëm një vlerë numerike të thjeshtë, pra jo një përqindje sic është shprehur në formulimin e tij, dhe sic është përcaktuar në vlerat e synuara (100%) të akteve ligjore dhe nënligjore që do të analizohen nga MD dhe KLGJ, në funksion të përmirësimit të aftësisë profesionale, aksesueshmërisë, transparencës dhe eficiencës të gjyqësorit.

Në fakt, analiza e akteve dhe miratimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore është pjesë e masave që janë vendosur në Politikën 2, Objektivin Specifik 2.1 “Rishikimi i kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe eficiencën” dhe hartimi i një indikatorit për të matur përbushjen e pjesëve të masës, pa pasur mundësi të krijimit të një raporti apo krahasimi

me një të dhënë tjetër, duket i pamjaftueshëm. Kjo, për shkak se nuk janë përcaktuar vlera të synuara konkrete, pasi është pamundur të ketë një pritshmëri të saktë se sa akte ligjore/nënligjore do të duhej të analizoheshin për t'a quajtur të përmbushur këtë masë. Mbetet pra, logjikisht, të matet vetëm një vlerë e thjeshtë numerike, pra numri i akteve të analizuara, e cila në vetvete është një e dhënë që nuk orienton në një produkt konkret me relevancë për Rezultat apo masat e synuara në Objektivin Specifik 2.1.

**Konkluzion:** Do të ishte e arsyeshme që të parashikohej një indikator, i cili të maste se sa nga aktet e analizuara arritën të merrnin formën e projektligjeve apo të ligjeve (në vlerë numerike), në mënyrë që të përfitohet një rezultat konkret lidhur me angazhimin dhe seriozitetin e organeve që do të bashkëpunojnë në këtë proces, për të dhënë një rezultat në drejtim të përmirësimeve ligjore të mundshme. Një indikator i tillë do të kishte më shumë kuptim të vendosjes pasi të përfundonte faza e analizës dhe ndryshimeve ligjore dhe të kalohej në fazën e matjes së impaktit real që kanë pasur këto ndryshime në qëllimin për të cilën u vendosën.

## Indikator 12

*“Kuotat vjetore të kandidatëve magjistratë, këshilltarëve dhe ndihmësve në Shkollën e Magjistraturës”*

Ky indikator iu referohet kuotave, ose numrit maksimal të vendeve të lira, të shpallura nga Këshillat, për magjistratë, këshilltarë e ndihmës ligjorë.

Në përshkrimin e tij, ky indikator është vendosur si pjesë e realizimit të Politikës 2 “Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane”, nën Objektivin Specifik 2.3 që parashikon “Rritjen e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit, i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë, duke siguruar një numër të përshtatshëm të magjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri”.

Gjithashtu, ky indikator është konsideruar si thelbësor për zëvendësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të larguar për shkak të vetingut.

Në përshkrimin që i është bërë indikatorit vlen të ndalemi në dy elementë: së pari, metodologjia, sipas të cilës ky indikator i referohet numrit të magjistratëve të pranuar në një vit, dhe së dyti, institucionet përgjegjëse dhe pjesëmarrëse për krijimin dhe raportimin mbi indikatorin, ku vihet re se nuk është e përfshirë Shkolla e Magjistraturës.

Të dyja këto parashikime kanë problematikë, sic ka problematikë edhe formulimi i indikatorit kur i referohet kuotave të pranimit, ndërkohë që në fakt i referohet numrit të magjistratëve të pranuar realisht nga Shkolla në një vit.

Së pari, që indikator i tillë të japë një rezultat të saktë do të duhet të mos bazohet në kuotat, por në numrin e magjistratëve, këshilltarëve e ndihmësve ligjorë të emëruar nga KLGj dhe KLP.

Kuotat nuk tregojnë se sa magjistratë/këshilltarë/ndihmës do të hyjnë në sistem, por tregojnë sesa vende të lira janë hapur nga Këshillat dhe mbi të cilat realizohet edhe testimi në Shkollën e Magjistraturës. Pas procesit të testimit, arrihet të prodhohet një shifër lidhur me sa kandidatë do të pranohen nga Shkolla, pra kandidatët të cilët do të jenë pjesë e programit 3 vjeçar të Formimit Fillestar (kësaj shifre i referohet metodologjia e këtij indikator). Më tej, filtrat e vendosur (konkretisht; sa kandidatë do të diplomohen nga Shkolla; sa do të jenë në gjendje të vlerësohen të paktën “mjaftueshëm”; dhe, sa do të emërohen nga Këshillat, pas procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës) do të prodhojnë numrin përfundimtar të prurjeve të reja në sistem.

Pra, si kuotat, ashtu edhe pranimet, nuk japin një rezultat të saktë të numrit të prurjeve të reja në sistem. Për këtë arsye, si formulimi, ashtu edhe metodologjia e matjes së indikatorit duhen ndryshuar.

Lidhur me parashikimin e KLGj dhe KLP si institucionet evetmepërgjegjëse dhe pjesëmarrëse të krijimit dhe raportimit mbi indikatorin, është e pakuptueshme sesi nuk është përfshirë Shkolla e Magjistraturës, në të vetmin indikator ku bëhet fjalë për prurjet në sistemin e drejtësisë dhe kur, Kushtetuta thotë se prurjet e reja mund të hyjnë vetëm përmes Shkollës së Magjistraturës. Si rrjedhojë, pesha që ka ky organ në krijimin e indikatorit dhe përmbushjen e rezultatit në tërësi, është e lartë dhe duhet të reflektohet. Testimi i realizuar nga ShM dhe Programi 3 vjeçar i trajnimit të detyrueshëm në Shkollë janë dy premisat kryesore nga del numri i magjistratëve që do t'i shtohen sistemit. Në këtë kontekst, numri i kuotave që do të hapin Këshillat është më pak i rëndësishëm se numri që kanë kaluar me sukses provimin e pranimit. Eksperienca e këtyre viteve tregon se kuotat e shpallura nuk kanë mundur të plotësohen tërësisht.

Së dyti, nëse i referohemi masave që lidhen me Shkollën e Magjistraturës në planin e veprimit, konstatojmë se ato lidhen të gjitha me formimin vazhdues, gjatë detyrës, dhe me zhvillimin e studimeve dhe publikimeve vecanërisht në fushën e të drejtës së BE, standardeve ndërkombëtare dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

Në mënyrë që indikatorin mbi cilësinë e sistemit të drejtësisë të jetë i plotë, ai duhet të parashikojë edhe mbledhjen e të dhënave lidhur me pjesëmarrjen e magjistratëve në aktivitetet që lidhen me formimin dhe aftësimin me njohuri të specializuara gjatë karrierës, si në rolin e ekspertëve, edhe në rolin e pjesëmarrësve. Një tregues për këtë do të se sa gjyqtarë marrin pjesë në trajnime në Shkollë gjatë një viti akademik. Ligji parashikon se ata duhet të marrin pjesë në të paktën 5 trajnime në vit, por ndërkohë, një pjesë shumë e ulët e tyre e realizojnë këtë detyrim ligjor, i cili, në fakt, më shumë sesa si detyrim, duhet të shihet si një mundësi që atyre ju jepet të thellohen dhe aftësohen në profesionin e tyre.

Ky indikator do të shërbente për të matur edhe të dhëna të tjera që mund të lidhen me çështjet për të cilat ata shfaqin më shumë interes, apo janë më tepër aktiv, dhe ky indikator të shndërrohet në një indikator udhëheqës për politikën e Shkollës lidhur me trajnimin vazhdues. Për më tepër, ky indikator do të shërbejë edhe kur sistemi të jetë plotësuar me gjyqtarë dhe prokurorë.

**Konkluzion:** Indikatorin duhet ndryshuar: duhet t'i referohet numrit të emërimeve të bëra nga Këshillat; dhe, të shtohet edhe Shkolla e Magjistraturës tek institucionet përgjegjëse. Gjithashtu, duhet të formulohet një indikator i ri me këtë emërtim: “% e magjistratëve që marrin pjesë në trajnimin vazhdues të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës”.

### **Indikatorin 13**

*“% e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të një çështjeje penale (vlera të ndara për shkallën e parë dhe shkallën e apelit, vetëm juridiksionin e zakonshëm)”*

Indikatorin 13 i referohet % së zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të një çështjeje penale. Nëpërmjet tij, do të matet kohëzgjatja mesatare e një çështjeje penale më vete për shkallën e parë dhe shkallën e apelit, pa përfshirë gjykimin në GJKKO. Ulja e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve është tregues kryesor i eficiencës së gjyqësorit, prandaj matja e tij është e rëndësishme për të vlerësuar performancën e gjykatave penale të juridiksionit të zakonshëm.

Indikatorin shërben si tregues për realizimin e Objektivit 2.4 “Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor,

duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët”, i cili ndodhet nën Qëllimet e Politikës 2 “Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane”.

Ky indikator përmban një formulim (rregullim) të ngjashëm me Indikatorin 2 të pasaportës së indikatorëve të SND I, me ndryshimin që në këtë formulim saktësohet se matja lidhet vetëm me juridiksionin e zakonshëm (pra nuk përfshin juridiksionin e gjykatave të posacme dhe SPAK).

Metodologjia e caktuar për matjen e tij i referohet Vlerës në% që del si rezultat i formulës:  $(1 - (\text{Shuma e kohëzgjatjes në ditë të të gjitha rasteve përkatëse në vitin n} / \text{numri i rasteve në vitin n}) / (\text{Shuma e kohëzgjatjes në ditë të të gjitha rasteve në vitin n-1} / \text{numri i të gjitha rasteve në vit n-1})) * 100$ .

Vërehet që vlera bazë është e vitit 2020 ku përcaktohet se kohëzgjatja mesatare në ditë e çështjeve penale në shkallë të parë dhe apel: ‘DT penale shkalla 1 = 66 (ditë) dhe DT penale apel: = 246 (ditë), pa specifikuar gjykatën/gjykatat të cilat i referohen këto vlera, gjë që nënkupton një mesatare të përgjithshme referuar të gjitha gjykatave sipas KLGJ (pasaporta e indikatorëve të SND I i referohej kohëzgjatjes që përfshinte gjykatën e Tiranës dhe Durrësit). Marrja për bazë e vitit 2020, mendojmë se është më afër realitetit, pasi procesi i rivlerësimit kalimtar i aplikuar në vitet e fundit ka ndikuar ndjeshëm në kohëzgjatjen mesatare të shqyrtimit të çështjeve. Për rrjedhojë, progresi matet nisur nga një vlerë realiste.

Ndërkohë vërehet që objektivat e synuaranë Pasaportën e Indikatorëve gjatë viteve të kohëzgjatjes së SND II, nuk shprehen në përqindje, por në afat kohor. Sa kohë që indikatorin mat përqindjen, sugjerojmë që objektivi për vitet e vlefshmërisë së Strategjisë të shprehet në përqindje. Saktësimi i targetit të synuar është i domosdoshëm për të vlerësuar arritjet/ecurinë. Gjithashtu, megjithëse synim është zvogëlimi i kohëzgjatjes së çështjeve, objektivat e shprehura në kohëzgjatje ditore, në vitet e kohëzgjatjes së SND II, në Pasaportën e Indikatorëve janë më të larta se vlera bazë, duke e bërë targetin më shumë regres sesa progres. Një objektivi i tillë mendojmë se nuk i përgjigjet rritjes së efikasitetit të gjyqësorit, synimeve të Politikës 2 dhe Objektivit 2.4. Edhe pse situata e pritshme vitet e ardhshme parashikohet jo shumë optimiste për shkak të efekteve të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, përsëri target nuk mund të jetë rritja, qoftë kjo dhe e përkohshme. Për më tepër, sa kohë parashikohet rritje, indikatorin që mat “përqindjen e zvogëlimit të kohëzgjatjes” do të ishte i pazbatueshëm.

**Konkluzion:** Sugjerojmë që të rishikohen objektivat target të vendosura për t’u arritur gjatë kohëzgjatjes së Strategjisë, si për sa i takon shprehjes së tyre në vlera të llogaritura në përqindje dhe jo kohëzgjatje kohore (llogaritja në përqindje është e nevojshme në kuadër të aplikimit të metodologjisë së propozuar), ashtu dhe sa i takon përputhjes së këtyre vlerave me objektivin strategjik (rritje e efikasitetit dhe zvogëlim i kohëzgjatjes së çështjeve).

#### **Indikator 14**

*“% e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të çështjes civile në shkallën e parë dhe në apel (vlera të ndara për secilin nivel)”*

Indikatorin 14 lidhet me % e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të çështjes civile në shkallën e parë dhe në apel (vlera të ndara për secilin nivel). Nëpërmjet tij do të matet kohëzgjatja mesatare e një çështjeje civile më vete për shkallën e parë dhe shkallën e apelit. Zvogëlimi i kohëzgjatjes së shqyrtimit të një çështjeje është tregues kryesor i efikasitetit të gjyqësorit, prandaj matja e tij është e rëndësishme për të vlerësuar performancën e gjykatave civile.

Edhe ky indikator ashtu si ai më sipër, shërben si tregues për realizimin e Objektivit 2.4 “Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët”, i cili ndodhet nën qëllimet e Politikës 2 “Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane”.

Një formulim (rregullim) të ngjashëm me këtë indikator gjejmë në Indikatorin 3 të pasaportës së indikatorëve të SND I.

Vërehet që kufiri bazë është i vitit 2020 ku përcaktohet ‘192 ditë në shkallën e parë / 1538 (ditë) në apel’.

Sërisht vërehet që objektivat e shprehura në përqindje për vitet e vlefshmërisë së strategjisë mungojnë. Saktësimi i objektivit është i domosdoshëm për të vlerësuar arritjet/ecurinë. Marrja për bazë e vitit 2020, ashtu siç theksuam edhe më sipër, është më afër realitetit dhe, për pasojë, progresi matet nisur nga një vlerë realiste.

Ndërkohë vërehet që objektivat e synuara, nuk shprehen në përqindje, por në afat kohor. Sa kohë që indikatorin mat përqindjen, sugjerojmë që objektivi për vitet e vlefshmërisë së Strategjisë të shprehet gjithashtu në përqindje dhe jo në kohëzgjatje. Saktësimi i targetit është i domosdoshëm për të vlerësuar arritjet/ecurinë.

Gjithashtu, megjithëse synim është zvogëlimi i kohëzgjatjes së çështjeve, objektivat e shprehura në kohëzgjatje ditore, në dy vitet e para të aplikimit të SND II, janë më të larta se vlera bazë, duke e bërë targetin të pa-aplikueshëm dhe objektivin të pamatshëm (sa kohë ai mat përqindjen e zvogëlimit të kohëzgjatjes të çështjes). Një target i tillë mendojmë se nuk i përgjigjet as rritjes së eficiencës së gjyqësorit, synimeve të Politikës 2 dhe Objektivit 2.4. Edhe pse situata e pritshme vitet e ardhshme parashikohet jo shumë optimiste, përsëri objektivat e Strategjisë synojnë optimizim burimesh me qëllim rritjen e eficiencës dhe efikasitetit të gjyqësorit.

**Konkluzion:** Sugjerojmë që të rishikohen objektivat target të vendosura për t’u arritur gjatë kohëzgjatjes së Strategjisë, si për sa i takon shprehjes së tyre në vlera të llogaritura në përqindje, sipas metodologjisë së propozuar, ashtu dhe sa i takon përputhjes së këtyre vlerave me objektivin strategjik (rritje e eficiencës dhe zvogëlim i kohëzgjatjes së çështjeve).

## **Indikator 15**

*“% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në internet dhe i përditësuar.”*

Indikator 15 mat % e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në internet dhe i përditësuar. Ky indikator lidhet me Objektivin 2.4 “Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët”, pjesë e Politikës 2.

Përfshirja e këtij indikatorin në portofolin e pasaportës lidhet me domosdoshmërinë për rritjen e transparencës së vendimarrjes gjyqësore. Aktualisht, informacioni që gjendet në portalet e gjykatave nuk është i përditësuar dhe vetëm palët ndërgjyqëse mund të gjejnë vendimet, por jo studiues të së drejtës apo publiku i gjerë që mund të kërkojë të dhëna.

Si metodologji matjeje përcaktohet se “Qendra IT e KLGJ-së, bazuar në të dhënat e disponueshme në faqen e gjykatës, do të jetë në gjendje të llogarisë % e rasteve kur informacioni bazë është i disponueshëm në internet.” Ndërkohë formula përcaktohet si:  $Vlera = \frac{Numri\ i\ përgjithshëm\ i\ çështjeve\ gjyqësore\ në\ vazhdim\ me\ informacionin\ themelor\ të\ disponueshëm}{Total\ i\ çështjeve\ gjyqësore}$

*publikisht / numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces gjatë periudhës raportuese \* 100*  
Kjo metodologji mat përqindjen e çështjeve për të cilat ka informacion, por ai nuk i referohet "informacionit bazë", si dhe nuk jep të dhëna për rastin kur ka informacion bazë, por ai nuk është i përditësuar, të cilave i referohet në përmbajtjen e vet indikatorit. Dhe në vijim të saktësimit të metodologjisë, vlerësohet se duhet të saktësohet/përkufizohet termi "informacion bazë", duke përshkruar përmbajtjen e këtij informacioni (pra, informacion për emrat e palëve, data e regjistrimit, emri i gjyqtarit apo statusi i procedimit apo të dhëna të tjera). Saktësimi i përmbajtjes së informacionit bazë është i rëndësishëm, së paku në përmbajtjen e metodologjisë.

Vërehet që kufiri bazë i llogaritjes është viti 2020 me vlerën 100 %. Mendojmë se aktualisht nuk jemi në këtë përqindje, pasi nëse dicka e tillë ishte arritur nuk kishte pse t'a vlerësonim si objektiv strategjik për 5 vitet e kohëzgjatjes së SND II.

Një formulim të ngjashëm me këtë indikator gjejmë në Indikatorin 7 të pasaportës së indikatorëve të SND I.

**Konkluzion:** *Sugjerojmë që të rishikohen objektivat target të vendosura për t'u arritur gjatë kohëzgjatjes së Strategjisë, me qëllim për t'i shprehur në vlera që i përfaqësojnë realitetin dhe gjendjes aktuale. Gjithashtu, sugjerojmë rishikimin e metodologjisë, me qëllim që të mund t'i përshtatet komponentëve-objekt i matjes së shprehur në përmbajtjen e indikatorit. Një metodologji më e përshtatshme mund të ishte "Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces me informacionin bazë dhe të përditësuar të disponueshëm online / numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces gjatë periudhës raportuese \* 100."*

## **Indikator 16**

*"% e aplikimeve të pranuar për të marrë ndihmë juridike parësore falas"*

Indikator 16 lidhet me % e aplikimeve të pranuar për të marrë ndihmë juridike parësore falas. Sa më e madhe kjo shifër, aq më të ndërgjegjësuar janë individët për të përfutur ndihmë parësore falas dhe kriteret për përfitimin e saj, dhe si rezultat aq më i madh është aksesimi në drejtësi për pjesën e popullatës që nuk mund të sigurojë vetë ndihmë juridike.

Ky indikator lidhet me Objektivin Specifik 2.5 "Aksesimi efektiv në drejtësi i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme", pjesë e Politikës 2. Ai është përfshirë rishtazi dhe nuk bënte pjesë në pasaportën e indikatorëve të SND I.

Për matjen e këtij indikator, metodologjia përcakton se matet numri i atyre që aplikojnë për ndihmë juridike parësore dhe janë gjetur nga autoriteti përkatës (përfshirë si rezultat i çdo apelimi) se plotësojnë kriteret ligjore për të marrë një ndihmë të tillë sipas ligjit. Ndërkohë, përqindja e aplikimeve llogaritet si vijon: *Vlera = Numri i përgjithshëm i përfituesve të ndihmës juridike parësore gjatë periudhës raportuese / numri i përgjithshëm i kërkesave drejtuar qendrave për ndihmë juridike parësore gjatë periudhës raportuese \* 100.*

Bazuar në statistikat e NJF, kjo metodologji mat % e aplikantëve që përmbushin kriteret ligjore për të përfutur ndihmë juridike parësore falas. Pra, ajo mat ndërgjegjësimin e aplikantëve për kriteret ligjore të përfitimit. Në këtë aspekt, indikator duhet të shprehet më qartë në raport me metodologjinë e propozuar.

Referuar kufirit bazë, rezultoni se është viti 2020 në të cilin 4200 persona kanë përfutur ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti. Ky është një formulim i qartë dhe që krijon premisa solide për matjen në vijim. Ndërkohë vlerat e synuara janë përcaktuar qartësisht duke synuar për çdo vit rritje 5% në krahasim me vitin e kaluar.

**Konkluzion:** Ky është një indikator i nevojshëm në kuadër të matjes së aksesit në drejtësi të shtresave që nuk kanë mundësi ekonomike dhe që përfitojnë ndihmë juridike dytësore falas.

### Indikatori 17

*“% e aplikimeve të pranuar për të marrë ndihmë juridike dytësore falas”.*

Indikatori 17 lidhet me % e aplikimeve të pranuar për të marrë ndihmë juridike dytësore falas. Sa më e madhe kjo shifër, aq më të ndërgjegjësuar individët për të përfituar ndihmë dytësore falas, dhe aq më i madh është aksesit në drejtësi për pjesën e popullatës që nuk mund të sigurojë vetë ndihmë juridike.

Ky indikator lidhet me Objektivin Specifik 2.5 “Aksesit efektiv në drejtësi i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme”, pjesë e Politikës 2. Ky indikator përmban një formulim (rregullim) të ngjashëm me Indikatorin 8 të pasaportës së indikatorëve të SND I. Në pasaportën e indikatorëve të SND I ishte përcaktuar % e aplikantëve që përmbushin kriteret ligjore të cilët përfitojnë ndihmë juridike dytësore falas. Përkundrejtë këtij formulimi, risia në indikatorin 13 qëndron në faktin se maten aplikimet e pranuar. Ky formulim e bën më të matshëm këtë indikator.

Edhe në këtë rast, si për Indikatorin 16, formula e përcaktuar: *“Vlera = Numri i pergjithshem i perfituesve te ndihmes juridike dytesore gjate periudhes raportuese / numri i pergjithshem i kerkesave drejtuar Gjykates per ndihme juridike dytesore gjate periudhes raportuese \* 100*, mat % e aplikantëve të pranuar që përmbushin kriteret ligjore për të përfituar ndihmë juridike dytësore falas.

Referuar kufirit bazë, rezulton se është ‘viti 2020 në të cilin 157 (numri i personave që kanë përfituar ndihmë juridike dytësore). Ky është një formulim i qartë dhe që krijon premisa solide për matjen në vijim.

Vërehet gjithashtu që objektivat janë përcaktuar qartësisht duke evidentuar për çdo vit rritje përkatësisht me 15% në krahasim me vitin e kaluar.

**Konkluzion:** Ky është një indikator i nevojshëm në kuadër të matjes së aksesit në drejtësi të shtresave që nuk kanë mundësi ekonomike dhe që përfitojnë ndihmë juridike dytësore falas.

### Indikatori 20

*“% e çështjeve që shkojnë në gjyq në të cilat i pandehuri është dënues”*

Indikatori 20 synon të masë punën e organit të prokurorisë. Ai është pjesë e Politikës 3, qëllimi i së cilës është drejtësia penale, dhe i referohet Objektivit 3.2 “Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv që funksionon sipas standardeve evropiane dhe hetim dhe ndjekja efikase e korrupsionit dhe e krimit të organizuar”.

Nëpërmjet këtij indikatorit synohet të matet se sa eficiente ka qenë ndjekja penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjykatë. Kështu, duke llogaritur raportin ndërmjet të pandehurve të dënues nga gjykata dhe të pandehurve që janë dërguar për gjykim, del një përqindje e “suksesit” të punës hetimore të zhvilluar nga prokurori, pra sa të organizuara e të sakta kanë qenë hetimet dhe sa prokurori i ka bazuar në ligj dhe prova akuzat ndaj të pandehurit.

Edhe pse ky raport përfshin dy organe, organin e akuzës dhe gjykatën, për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë që ato kanë në këtë proces dhe “ndërvarësisë” që ato kanë nga njëra tjetra, arrihet të prodhohet një e dhënë afërsisht pranë së vërtetës. Rezerva që gjykata nuk po punon me të njëjtën eficiencë dhe objektivitet mbetet pjesa e marzhit të gabimit të këtij indikator.

Gjithashtu, në metodologjinë e parashikuar për këtë indikator përcaktohet që raporti të llogaritet duke veçuar tëpandehurit ndaj të cilëve është dhënë një vendim pafajësie ose pushimi nga ata të gjykuar, në shkallë të parë.

Së pari, në metodologji duhet të parashikohet se vecimi do të bëhet mbi rastet e të pandehurve të dënuar, për të qenë më të saktë ndaj formulimit të indikatorit.

Së dyti, vlerësojmë se do të ishte me vlerë krijimi i një indikatorit të ri që të përcaktojë këtë raport ndërmjet gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit. Kjo, për të vlerësuar edhe raportin mes vendimmarrjeve të këtyre dy nivele gjykatave, duke pasur parasysh se vendimi merr formë të prerë vetëm pas shqyrtimit në gjykatën e apelit (në rastet kur ndaj vendimit të shkallës së parë ushtrohet ankimi).

Gjithashtu, përvec këtij indikatorit matës për sistemin e prokurorisë në tërësi, vlerësohet se plani i masave duhet të përmbante një indikator më vete për punën e SPAK. Kjo për arsye se ndikimi i SPAK në Shqipëri përgjatë, të paktën këtij 4 vjecari, pritet të jetë i lartë. Një matje hap pas hapi, me një frekuencë 1 vjecare e punës së SPAK, do të ishte një tregues shumë i mirë i luftës kundër korrupsionit, vecanërisht atij të veshur me pushtet, që është edhe ndër arsyet kryesore të reformës në drejtësi, të ndërmarrë në Shqipëri. Raporti ndërmjet çështjeve që SPAK dërgon në gjykatë, me ato që merren në konsideratë nga GJKKO dhe ka vendim dënimi, është tregues i rëndësishëm i eficiencës së SPAK dhe shmang paragjykimet lidhur me këtë organ, nëse realisht po heton sipas standardeve, apo po dërgon dosje “të zbraza” në gjykatë.

**Konkluzion:** Sugjerohet të shtohet një indikator me këtë përmbajtje: “përqindja e çështjeve që shkojnë në GJKKO në të cilat është marrë një vendim dënimi nga gjykata”.

## Indikatori 24

*“Numri i akteve ligjore të BE-së të harmonizuara siç duhet me *acquis* (kapitulli 23)”*

Indikatori 24ka të bëjë me numrin e akteve ligjore të BE-së të harmonizuara siç duhet me *acquis* (kapitulli 23). Ky indikator është përfshirë rishtazi dhe nuk ka qenë i parashikuar në pasaportën e indikatorëve të SND I.

Së pari, ky indikator duhet riformular nga pikëpamja gjuhësore duke saktësuar/qartësuar termin ‘*harmonizim siç duhet*’. Indikatorët duhet të formulohen në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për institucionet përgjegjëse në mënyrë që të jenë realisht të matshme dhe të mos lënë vend për keqinterpretim.

Ky indikator vlerësohet se është vendosur duke pasur parasysh detyrimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të anëtarësimit dhe afrimit të procesit të çeljes së negociatave për kapitullin 23. Ky kapitull tradicionalisht ‘hapet i pari dhe mbyllet i fundit’.

Në nën-pikën ‘*Institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave*’, teknën-ndarja ‘*institucione pjesëmarrëse*’ përcaktohen MD si dhe ‘*disa relevante*’. Terminologjia ‘*disa relevante*’ është shumë evasive dhe duhet saktësuar në mënyrë që procesi raportues të jetë sa më transparent dhe të kryhet me përgjegjshmëri.

Sërisht, vlera bazë mbetet një element që duhet saktësuar në vlerë të qartë. Për rrjedhojë duhet të qartësohet niveli i harmonizimit deri në 2020, i përcaktuar në përqindje. Kjo përqindje do të krijojë bazën e qartë të ‘pikënisjes’ për arritjet në lidhjen me harmonizimin në vitet në vijim të vlefshmërisë së Strategjisë. Ndërkohë targeti jepet në shifra 2 akte për vitin 2021 dhe 5 akte për vitet në vijim. Mendojmë se ka nevojë për një saktësim në metodologji se cila akteve i referohet Pasaporta, pasi gjykojmë se është shifër shumë e ulët aktesh në raport me aktet ligjore që harmonizohen çdo vit nga vendi ynë. Nëse bëhet fjalë për akte ligjore në fushën e drejtësisë kjo duhet të shprehet qartë.

**Konkluzion:** Sugjerojmë që ky indikator të riformulohet në funksion të qartësisë. Gjithashtu metodologjia duhet të ri-shihet në raport me objektivat e vendosura për t'u realizuar gjatë kohëzgjatjes së SNDII dhe tësaktësojë aktet për të cilat bëhet fjalë.

## Indikator 25

*"% e gjykatave/prokurorive për të cilat sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve është ngritur dhe funksionon me kapacitet të plotë"*

Indikator 25 llogarit në përqindje gjykatat/prokuroritë për të cilat sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve është ngritur dhe funksionon me kapacitet të plotë. Funksionaliteti i Sistemit të menaxhimit të çështjeve është premisë për koordinim më të mirë brenda sistemit gjyqësor/prokurorisë, rritje të efektivitetit dhe rritje të transparencës.

Ai lidhet me Objektivin Specifik 4.1 "Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare", pjesë e Politikës 4.

Indikator 25 ka si qëllim të vlerësojë funksionimin e plotë të sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe prokurori. Ai do të matet duke llogaritur raportin midis numrit të gjykatave dhe prokurorive për të cilat sistemi i ri është funksional dhe numrit të gjykatave/prokurorie në shkallë vendi. Për këtë formula e llogaritjes së indikatorit: numri i gjykatave/prokurorive për të cilat sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve është funksional/ nr. total të gjykatave/prokurorive \*100. Metodologjia dhe formula e matjes mendojmë se është e saktë.

Ndërkohë që sistemi nuk është ende funksional, vlera bazë referuar vitit 2020 është zero. Për dy vitet e para 2021 dhe 2022 nuk parashikohen rezultate për sistemin, as në prokurori ashtu dhe as në gjykata. Ndërkohë objektivi i synuar është 5% vitin e tretë, 33 % vitin e katërt dhe 100 % vitin e pestë pra vitin 2025 do të jetë viti kur sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve do të jetë funksional.

**Konkluzion:** Ky indikator është shprehur në mënyrë të qartë. Për dy vitet e para 2021 dhe 2022 nuk parashikohen rezultate për sistemin, as në prokurori ashtu dhe as në gjykata. Ndërkohë objektivi i synuar është 5% vitin e tretë, 33 % vitin e katërt dhe 100 % vitin e pestë pra vitin 2025.

## Indikator 26

*"% e trupës gjyqësore/prokurorë/inspektorë dhe i stafit administrativ të trajnuar mbi përdorimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve"*

Treguesi 26 mat përqindjen e gjyqtarëve/prokurorëve/inspektorëve dhe stafit administrativ të trajnuar në lidhje me përdorimin me efikasitet të sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve. Sa më të trajnuar përdoruesit e sistemit aq më efektive është puna me sistemin, si dhe koordinimi mes institucioneve të drejtësisë. Kuptohet që faza e trajnimit të stafit ecën paralelisht me atë të ngritjes së sistemit.

Ai lidhet me Objektivin 4.1 "Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare", pjesë e Politikës 4.

Indikatori do të matet çdo vit. Ndërkohë që sistemi nuk është ende funksional, vlera bazë referuar vitit 2020 është zero. Targetii synuar lidhur me këtë tregues është në varësi të synimeve të vendosura në Indikatorin paraardhës. Për këtë arsye edhe lidhur me këtë tregues, në dy vitet e para 2021 dhe 2022 nuk parashikohen rezultate për trajnimin e stafeve, sa kohë nuk pritet të jetë funksional sistemi. Ndërkohë objektivi i synuar është 5% vitin e tretë, 33 % vitin e katërt dhe 100 % vitin e pestë, kur jo vetëm sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve do të jetë funksional, por edhe trupa gjyqësore/prokurorë/inspektorë dhe i stafit administrative do të jenë plotësisht të trajnuar.

**Konkluzion:** Ky indikator është shprehur në mënyrë të qartë. Në dy vitet e para 2021 dhe 2022 nuk parashikohen rezultate për trajnimin e stafeve, sa kohë nuk pritet të jetë funksional sistemi. Ndërkohë objektivi i synuar është 5% vitin e tretë, 33 % vitin e katërt dhe 100 % vitin e pestë

## LISTA E REFERENCAVE

### Ligje dhe akte

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Kodi i familjes i Republikës së Shqipërisë;
3. Ligj 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
4. Ligj 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
5. Ligj 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
6. Ligj 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
7. Ligj 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
8. OECD (2018), Ex-post assessment of regulation: Practices and lessons from OECD countries, OECD Publishing, Paris;
9. Vendim i KLGj nr.316, datë 14.09.2020, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”;
10. Vendim i KLP nr. 171, datë 27.09.2019, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”;
11. Rregullore e brendshme e Shkollës së Magjistraturës të Republikës të Shqipërisë;
12. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2016-2020;
13. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025;
14. Vendim i KLGj nr.264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”;
15. Vendim i KLGj nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”;
16. Vendim i KLGj nr. 622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”;
17. Vendim i KLGj nr. 171, date 22.04.2021, “Për miratimin e Kodi i etikës gjyqësore”;
18. Vendim i KLGj nr. 47, datë 11.02.2021 “Për miratimin e “Udhëzuesi “Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave”;
19. Vendim i KLGj, nr. 78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”;
20. Vendim i KLP, nr.183, date 30.07.2020.

21. VKM nr.409, datë 19.06.2019 “Për miratimin e planit të veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë”.
22. Raporti Vjetor i Monitorimit Janar-Dhjetor 2020 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe të Planit të veprimit.

Faqe zyrtare

1. [www.klgj.al](http://www.klgj.al)
2. [www.klp.al](http://www.klp.al)
3. [www.ild.al](http://www.ild.al)
4. [www.spak.al](http://www.spak.al)
5. [www.bkh.al](http://www.bkh.al)
6. [www.magjistratura.al](http://www.magjistratura.al)
7. [www.gjykataelarte.al](http://www.gjykataelarte.al)
8. [www.drejtesia.gov.al](http://www.drejtesia.gov.al)
9. [www.coe.int](http://www.coe.int)
10. [www.undp.org](http://www.undp.org)
11. [www.unodc.org](http://www.unodc.org)